



Lulëzon pazari **Berisha-Rama**, Lindita Nikolla konfirmon të paprekshëm mandatin e deputetit të kreut të PD, dopio standard me rastin e Arben Ahmetajt

Faqe 5

Idajet Beqiri nxjerr informacionet e forta, ja lajmi shokues që mësoi Ilir Meta kur e thirrën në SPAK, ish-presidenti u alarmua kur pa mesazhet e Monika Kryemadhit në duart e prokurorëve specialë

Faqe 3



Avokati: ILDKPI duhet të hetojë pasurinë e çiftit Meta-Kryemadhi

Ndarja e Metës me Kryemadhin: Divorci është serioz, martesë ishte lojë



Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit që i dha Sali Berishës vulën e PD në telashe, KPA çel hetimin administrativ, prokurori i ONM e "gozhdon" me pyetje

Faqe 6

Ja detajet nga marrëveshja e "nëndheshme" që çon Monika Kryemadhin në burg, Kreshnik Spahiu zbardh të fshehtat e divorcit dhe tregon taktikën që po ndjek çifti në përballjen me SPAK

Faqe 2

Gazment Bardhi i zë vendin Luan Baçit në Fier si drejtues qarku, fillon sherri në partinë e Sali Berishës midis besnikëve të tij dhe renegatëve të Lulzim Bashës

Faqe 4

Nga mësuesit, te mjekët, infermierët, ushtarakët, zjarrfikësit dhe policët e burgjeve, miratohet rritja e pagave, ja nivelet e reja të rrogave dhe të gjitha kategoritë e administratës me 135 mijë punonjës që përfitojnë

Faqe 10

Hungaria merr "frenat" e BE, Serbia përgatitet për një "epokë e artë", ndryshime të mëdha priten gjatë presidencës gjashtëmujore, ja çfarë fshihet mes lidhjeve të ngushta të Beogradit me Budapestin

Faqe 11

Si dështoi operacioni i SPAK me 19 fletë-arreste për inceneratorin e Tiranës, a u trembën prokurorët specialë nga emrat "VIP" të përfshirë në aferë?

Faqe 9

Kryeministri Edi Rama ul tonet me mediat dhe merr në mbrojtje gazetarët nga sulmet e prokurorisë, thirrje SPAK të hetojë administratën e korruptuar

Faqe 7

Tre institucionet në varësi të Belinda Ballukut abuzime dhe luks të financuar nga tarifat në kurriz të qytetarëve, zbardhen skandalet e rënda

Faqe 8

KOMENT & ANALIZË

Faqe 15-17

Nga Namir LAPARDHAJA

I vetmi peng i Ramës paska qenë Berisha

Nga Ramazan SHERJA

Ka, apo s'ka akuza për Berishën

Nga Bardhyl BEJKO

Protestë të madhe në korrik për nderin e humbur para bashkisë për mos hiç!

RAJON & BOTË

Sondazhet "tmerrojnë" Macronin, rreziku kryesor nuk është më e djathta, një kthesë drastike pritet në raundin e dytë të zgjedhjeve, ja aleanca që po kërcënon karrigen e presidentit

Faqe 14

Tensionet kapin majën, SHBA i dha leje Ukrainës të përdorte armët e saj, Rusia aktivizon planin e hakmarrjes, shkatërron raketa-hedhësit amerikanë, ja vendimi i Biden që e nxori situatën jashtë kontrollit

Faqe 13

Merr fund saga ligjore 14-vjeçare, Julian Assange lirohet nga burgju, si u kthye themeluesi i Wikileaks nga tradhtar në hero, ja historia e pabesueshme e njeriut që tronditi SHBA-në me zbulimin e sekreteve

Faqe 12

Ndarja e Metës me Kryemadhin: Divorci është serioz, martesë ishte lojë, Monika merr përsipër çdo gjë sepse Kodi Penal lehtëson gratë

Ja detajet nga marrëveshja e “nëndheshme” që çon Monika Kryemadhin në burg, Kreshnik Spahiu zbardh të fshehtat e divorcit dhe tregon taktikën që po ndjek çifti në përballjen me SPAK

Rigels SELIMAN

Juristi i njohur, Kreshnik Spahiu në një intervistë televizive ka folur rreth vendimit të ish-presidentit Ilir Meta për t'u divorcuar nga Monika Kryemadhi në një kohë që SPAK po kryen hetim të thellë pasuror ndaj tyre. Juristi Kreshnik Spahiu cilëson më shumë si lojë martesën e çiftit Meta-Kryemadhi se sa divorcin. Megjithatë Spahiu e cilësoi lëvizjen e tyre si një strategji për tu mbrojtur. Sipas tij, Kryemadhi do të marrë përgjegjësinë ligjore dhe politike për të mbrojtur partinë dhe për të ruajtur mos të shkatërrohet çdo gjë. Më poshtë po pasqyrojmë një pjesë të intervistës së zotit Spahiu.

Divorci Meta-Kryemadhi

Divorci nuk amnistion krimet gjatë martesës, për të gjithë opinionin publik të cilët pretendojnë që divorci i Metës me Kryemadhin është lojë, ligjërish dhe juridikisht në të drejtën penale, divorci nuk amnistion krimet gjatë martesë e nëse Ilir Meta dhe nëse bën lojë nuk arrin dot t'i shpëtojë përgjegjësisë penale për çështje që lidhen me pasurinë e zhvilluar gjatë martesë. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë e të gjithë konspiracionit të përgjithshëm. Askush nga ne nuk ka të drejtë të hyjë në jetën private të tjetrit por kur bëhet fjalë për ish-Presidentin, ish-Kryeministrin, ish-kryetarin e Parlamentit, ish-Ministrin apo



ish-deputetin e Parlamentit dhe nga ana tjetër bashkëshorten e tij e cila ka qenë një nga liderët e opozitës apo 10 herë deputete e Parlamentit të Shqipërisë nuk bëhet fjalë për një akt i cili i takon thjeshtë dhe vetëm jetës private. Por aq më tepër ish-Presidenti e ka pjesë të mbrojtjes këtë divorc të strategjisë ligjore, përpara prokurorisë speciale. E them këtë sepse të gjithë deklaratat dhe atë çfarë ai deklaroi lidhen drejtpërdrejtë me veprimet e tija politike, të bashkëshortes së tij dhe me qëndrimet antagonistike politike apo qëndrimet që kanë me SPAK-un. Motivi zyrtar i divorcit sipas pretendimit të Metës është se ajo tradhtonte partinë dhe flirtonte e dridhte me SPAK-un.

Ndarja mes çiftit të PL, lojë

A është kjo një lojë teatër apo një divorc serioz, këtu ka dy aspekte ai i motivit privat nga

motivi juridik dhe politik janë dy gjëra të ndryshme. Për çështjen private mund të them se ajo mund të jetë një divorc serioz dhe e gjithë martesë e tyre ka qenë një lojë. Në aspektin politik dhe juridik të çështjes, Meta po hetohet për fshehjen e pasurisë së tij, për mos deklarim të pasurisë dhe për disa vepra të tjera që lidhen me korrupsionin pasiv, si çështje të lidhura me njëra-tjetrën si çështja e CEZ-DIA e me radhë e deri te financat e partisë apo transaksionet që lidhen me lobimin në SHBA, ku ka dyshime që mund të jenë transaksione ruse. Sipas informacioneve, SPAK ka kërkuar letër porosi në disa shtete për të investiguar në lidhje me burimet financiare, transaksione, llogaritë bankare apo veprimet që mund të jenë kryer. Loja politike mund të jetë një lloj divorci që ndan përgjegjësitë,

që d.t.th se Monika Kryemadhi merr përgjegjësinë ligjore dhe juridike a penale e ndërsa Ilir Meta merr përgjegjësinë politike për të mbrojtur partinë dhe për të ruajtur të mos shkatërrohet çdo gjë ku të mbroj krahët në një lloj imuniteti politik. Kjo gjë bëhet se në të gjithë praktikën penale, një person merr përsipër mbrojtjen dhe dikush tjetër, kryesisht më i dobëti merr përsipër krimin, si gruaja apo më i moshuari pasi ka lehtësira në aplikimin e dënimit, që nga masa e sigurimit si arrest shtëpie e deri në masën e dënimit ku mund të jetë një masë më e lehtë e duke e marr personi më i dobët në familje. Kjo është një taktikë nga më të thjeshtat e më të lexuarat nga ne penalistët që jemi marrë me këtë profesion. Kjo mund të jetë një strategji e mbrojtjes e nga ana tjetër duhet të kuptojë publiku një problem të dyfishtë në këtë histori pasi nuk bëhet fjalë vetëm për pasurinë bashkëshortore. Bëhet fjalë për pasurinë e biznesit, bëhet fjalë për pasurinë e partisë, bëhet fjalë për llogari bankare që janë jashtë asaj që konsiderohet si pasuri bashkëshortore. E me të drejtë Meta ka ngritur një strategji, për të thënë me llogaritë, financat, shpenzimet është marrë Monika Kryemadhi, Ilir Meta ka qenë President. Kjo është taktika e mbrojtjes dhe nuk ka dijeni se çfarë ka bërë Monika Kryemadhi, kur drejtonte parti, nuk ka informacion se çfarë

bënte për lobime, llogari, hapje kompani offshore me element të ndryshëm që do të dalin ditët në vijim sepse kanë ardhur letër porositë nga disa shtete. Në këtë mënyrë, ka një lloj distancimi viziv e publik, gjë që e bën të besueshëm gradualisht të gjithë këtë tragjikomedi. Duan të bëjnë një film sa më të besueshëm, i cili mund të ndodhë që t'ju rezultojë i suksesshëm. Në këtë mes ka një lloj marrëveshje, taktike ligjore të konsultuar të cilën ditët dhe javët në vijim, do vërtetojnë këtë që është një strategji e ndërtuar mirë. A do të rezultojë e suksesshme për disa copëza të dosjes penale, kjo mbetet për t'u parë.

Amnistia

Këtë e thotë ligji, kodi i familjes, kodi penal, procedura penale ku kodi nuk ka efekt prapaveprues. E gjithë pasuria që është ndërtuar, të gjitha veprimet juridike që janë kryer gjatë martesë të cilat janë kryer në bashkëpunim, ato nuk i shmangen dot. Nëse është një pasuri e përbashkët, sepse Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi, janë subjekte të Inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe çdo vit si zyrtarë të lartë të shtetit, janë të detyruar të deklarojnë pasurinë e përbashkët që e kanë si familjar. Çdokush prej tyre mban përgjegjësi nëse ka fshehje të pasurisë. Unë nuk mendoj se ka diferenca në deklaratimet sa i përket pasurisë por korrespondon pasuria e Ilir Metës me të Monika Kryemadhit.

Protesta e opozitës më 11 korrik, Shehi: Manovër për të mbyllur hesapet e fundit brenda PD

Operacion për të mbyllur hesapet e fundit brenda PD dhe për të lançuar lidhshmëri e ri, e ka konsideruar kreu i LZHK-së, Dashamir Shehu, protestën e PD-së të thirrur për më 11 korrik. Në një studio televizive, ai tha se kjo bëhet me qëllim që të spostohet vëmendja nga tema kryesore e opozitës që sipas tij është ndryshimi i Kodit Zgjedhor. “Protesta s’ka asgjë të keqe, por unë e shoh si manovër përfundimtare që brenda PD-së po mbyllin hesapet e veta që i kishin tepruar. Tani u mor dhe vula. Ti marrim edhe ato që mendojnë ndryshe ti futim këtu brenda grupit ton. Është vazhdim i së njëjtës politikë që jemi grupi më i madh opozitar dhe do ta bëjmë ne ligjin brenda opozitës. Është i njëjti grup me drejtues Berishën

dhe unë nuk shikoj asgjë të re. Shikoj spostim nga temat që kemi ne si opozitë sot. Tema më e rëndësishme sot është ndryshimi i kodit zgjedhor”, tha ai. Sipas tij fokusi kryesor i opozitës duhet të jetë ndryshimi i kodit, për të fituar kundër Ramës, por Shehi thekson se asnjë nga palët nuk ka dëshirë për ta ndryshuar. Ndërkohë deklaratat e PD-së për qeveri teknike për zgjedhjet, Shehi i sheh si gjetje për të mbajtur njerëzit me shpresë. Sakaq për Shehin gabimi më i madh që po bën opozita sot është edhe delegimi i shpresës Sali Berishës, më të cilin sipas tij mund të fitojë vetëm përballë Bashës, por jo përballë Ramës. Por duke qenë jashtë Federatës së Opozitës, Shehi thotë se bashkohet për qark një projekti politik dhe jo rreth individëve.

Meta nuk ndal sulmet ndaj SPAK: Izoloi Berishën, Ramaforma e drejtësisë së ‘Dum-Dumanëve’ tub oksigjeni për narkoshtetin

Presidenti i Partisë së Lirisë, Ilir Meta ka vijuar sulmet ndaj SPAK, teksa ka folur dje në konferencën organizative të partisë në Tiranë. Meta tha se SPAK ka izoluar politikisht kreun e PD Sali Berisha, ndërsa theksoi se SPAK nuk merr provat lidhur me korrupsionin në vend pasi kjo do të sillte ndëshkim të Ramës dhe Veliajt. “SPAK afërmendsh bën ‘shejtan-budallain’ dhe nuk shikon narkoshtetin, provat ulëritëse të korrupsionit skozfrenik dhe inkriminimin në nivele të larta, me të vetmin qëllim që të

mos ndëshkohet Edi Rama dhe Erion Veliaj, të cilët i kanë kthyer zyrat e shtetit në stofulla më të sigurta të krimin të organizuar, të mafias ndërkombëtare, të Sinaloas, Ndranghetas dhe karteleve më të rrezikshme të trafikut të drogës. Ndërkohë është po ky SPAK që izoloi politikisht Sali Berishën dhe rrëmben dy ditë para zgjedhjeve Fredi Belerin, shantazhon drejtues të tjerë të opozitës, tenton të marrë peng parti politike e të shërbejë si ‘vrasës me pagesë’ i pluralizmit politik”, deklaroi ai. Më tej Meta hodhi akuza se drejtësia në vend

funksionon nën regjinë e kryeministrin Rama. “Në çdo shtet ka mafia, por në Shqipëri mafia ka shtetin e vet, i cili tani po ndihmon edhe mafian italiane dhe rumune për t'u fuqizuar, kur skandali Rama-Coldea sapo ka nisur të zbardhet. Ramaforma e drejtësisë së Dum-Dumanëve është tubi i oksigjenit për narkoshtetin sepse i garanton pandëshkueshmërinë, imunitetin politik dhe goditjen e kundërshtarëve sipas axhendës dhe interesave elektorale të Kryeministrin”, nënvizoi Meta.

Avokati: ILDKPI duhet të hetojë pasurinë e çiftit Meta-Kryemadhi

Idajet Beqiri nxjerr informacionet e forta, ja lajmi shokues që mësoi Ilir Meta kur e thirrën në SPAK, ish-presidenti u alarmua kur pa mesazhet e Monika Kryemadhit në duart e prokurorëve

Avokat i njohur, Idajet Beqiri ka zbërthyer lëvizjet e fundit të presidentit të Partisë së Lirisë, Ilir Meta dhe Monika Kryemadhit. Kjo e fundit dhe zoti Meta po shkojnë drejt divorcit, ndërkohë që Prokuroria e Posaçme (SPAK) ka nisur hetime për ta. Por çfarë fshihet pas këtij vendimi të çiftit më të lakuar të politikës dhe pse ata vendosën të divorcohen tani. Gazeta "SOT", bisedoi me avokat Beqirin, i cili nxjerr informacione të forta. Gjatë një interviste me kryeredaktorin e gazetës "SOT", zoti Beqiri zbulon lajmin shokues që mësoi Ilir Meta kur e thirrën në SPAK, teksa thekson se ish-presidenti u alarmua kur pa mesazhet e Monika Kryemadhit në duart e prokurorëve.



-Avokat Beqiri, në çfarë fazë është SPAK në lidhje me hetimin pasuror të çiftit Meta-Kryemadhi, çfarë pritjet të ndodh së afërmi?

Janë disa çështje që janë thelluar dhe tashmë që jemi para verifikimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, ky është një fakt pasi e pranojnë vetë të dy, edhe Meta pasi ka dalë nga SPAK, madje dhe me deklaratat që ka bërë ndaj SPAK aspak morale dhe etike e madje komente nga më të egrat e me të drejtë komentet e Metës i kemi quajtur të dalë faze e të pahijshme për një ish-kryetar shteti, ish-Kryeministër, etj.

-Është një strategji e Metës kjo apo jo?

Pikërisht, Meta tashmë po luan me të gjitha kartat. Ai thotë se nuk kam çfarë të humbas më pasi të gjitha i kam humbur. Por nëse futet një organ siç është SPAK-u për të kontrolluar pasuritë e tua, atëherë Ilir Meta duke e ditur që ato pasuri nuk i ka të vëna me punë por me korrupsion, i ka të vënë vetëm në saj të shpërdorimit të punës që ka bërë që kur ishte deputet dhe pastaj dhe me të gjithë funksionet që ka, kudo ku ka qenë. I ka futur duart në pasurinë kombëtare dhe pasuritë e tija i ka bërë mbi bazën e futjes së duarve të pista në buxhetin e shtetit dhe në taksapaguesit shqiptar por edhe pasuritë e shqiptarëve, ai tashmë luan me të gjithë ato që i jepet mundësia. Luan me të qenit kryetar i Partisë së Lirisë, luan me të qenurit ish-President, luan edhe me bashkëshorten e vetë të cilën e ka deputete dhe politikane. Madje duke bërë edhe ndarjen, ku thotë se unë merresha me politikën e Monika merrej me administrimin e pasurisë dhe problemet e fëmijëve, të shtëpisë, etj, me qëllim që ta largojë e ta distancojë sa më shumë Monikën. Por po luan edhe me gjëra

të cilat janë në kufirin e asaj që njerëzit mendojnë në është normal apo jo pasi është çfazim të hipësh nëpër hekura apo të hidhesh nga bordi i një varke e të ulesh me njerëz që nuk janë të nivelit tënd. Përkundrazi ti je i akuzuar, sepse atyre iu ke dhënë pasurinë e nëpërmjet tyre e ke bërë tjetërsimin e pasurive të tua në Angli dhe gjithandëj. Këto pasuri kanë ardhur si pasojë e floririt të vjedhur të Kërrabës e janë futur në emrin e atyre që ha darka me ta apo i merr në shtëpitë të gjitha. Të tëra këto lloje e deri dhe te padia që bën për shkurorëzim, janë për ta çuar vëmendjen e opinionit publik në Shqipëri por edhe të mediave të ndryshme, ne gjëra të tilla dytësore e gjëra të tilla të cilat janë për shou dhe të largohet nga problemi themelor që janë korrupsioni dhe krimi që ai ka bërë, vjedhjet e mëdha që ai ka bërë dhe shqiptarët për këtë janë të interesuar më shumë se çfarë ka vjedhur dhe ku i ka çuar këto që ka vjedhur. Kurse ai 80% po i dërgon në këto.

-Edhe padia për zgjidhjen e martesës mendoni se është një strategji për të devijuar vëmendjen në këtë situatë?

Është një lojë edhe ajo por nga ana tjetër ka dhe diçka të vërtetë brenda se ndonjëherë lojërat janë lojëra por pastaj bëhen nga lojë kalojnë në seriozitet pastaj. Marrin dhe seriozitetin e duhur se ai e filloi faktikisht si lojë këtë punën e divorcit por e bëri de fakto kur nuk e zgjodhi në forumet e PL, por kur Monika shkoi në SPAK, atëherë ai e harroi atë divorc që bëri duke thënë që e kanë lënë selinë pa roje dhe lanë selinë në duart e Byrosë Kombëtare të Hetimit që vajtën morën serverat dhe nuk i ruajtën mirë, e harroi çështjen e dorëzimit të mandateve dhe pastaj vajti në SPAK. Nga ana tjetër tha se qëndrimet e saj në SPAK, janë aq të rënda sa e konsideronte dhe më të

rënda se të një baxhelle. Kjo do të thotë se diçka në SPAK ndodhi, por çfarë ndodhi në SPAK që ai tani nga lojë po e kthen në një seriozitet këtë çështje sepse në SPAK.

-A është qëndrimi ndryshe zotja Kryemadhi dhe Meta sa i përket qasjes që kanë, ku njëri e sulmon dhe tjetra e vlerëson?

Pikërisht, jo vetëm te qëndrimi që mban që i thotë SPAK-ut bëj të vetëm se unë shkova dhe dhashë shpjegimet e mia. Është në rregull dhe një qëndrim normal e ndryshe nga ai që e quan SPAK-un Dum Duman e organizatë politike e në duart e Ramës që bën goditje për të shkatërruar opozitën, etj, akuza të dala mendsh. Janë shumë ndryshe me njëri-tjetrin në qëndrime por problemi është se këtu ka dhe një lloj të vërtete te Meta dhe shqetësimi i tij është i natyrshëm pasi pas marrjes së telefonit të nënës së Monikës dhe pas marrjes së telefonit të Monikës vetë, d.m.th diçka ka ndryshuar, diçka ka parë Meta brenda tyre dhe që ka rënë në duart e SPAK dhe e bën përgjegjëse Monikën se pse nuk është treguar vigjilente që ai të zhdukte gjurmët. Kjo sipas Metës paska lënë gjurmë dhe nga ana tjetër edhe ajo nuk është thashethem por Meta ka patur bindjen që Dumani duke qenë nga Dibra dhe duke patur njohje familjare me njerëzit e Monikës, ai nuk do të tregojë kaq i ashpër, siç po tregohet me Ilir Metën e ta toleronte. E për këtë bën përgjegjëse Monika Kryemadhin. Kështu që nga lojë, kjo çështje po merr përmasat e një të vërtete por Dumani nuk është nga ata që shikon krahinaizmin apo kushërinjtë e tij. Ndërsa, sa i përket problemit të verifikimit të pasurive, këtu qëndron edhe te studimi i fëmijëve në Angli të Ilir Metës ku paga vjetore i arrin 24 mijë paund e ndërsa fëmijëve të tij vetëm shkollimi iu arrin në 60 mijë paund secilit. Ka tre fëmijë dhe çdo vit nevojiten 180 mijë paund, por sa

vjet ishin ata fëmijë me studime. Ti si President i vendit, rrogën tënde e ke 24 mijë paund në vit, e si e tillë nuk dalin llogaritë, pasi vetëm për fëmijët të shkojnë shpenzimet 180 mijë paund. Këtu ka diçka që nuk shkon, pasi ILDKP-ja duhet të verifikojë pasurinë e këtyre, por ky është institucion formal pasi ajo deklaron se çfarë deklarojnë e çfarë kanë në kadastrë këto.

-Avokat, si do të ndahet përgjegjësia penale?

Ka dy lloj përgjegjësish, është ajo penale e individualizuar. Në rast se njëri nga bashkëshortët merret përgjegjësi penale për korrupsion apo shpërdorim detyre apo për mos deklarim të pasurisë, atëherë do të shikohet se për çfarë pasurish bëhet fjalë. Dhe nëse bëhet fjalë për një pasuri që është vendosur gjatë kohës së rregjimit martesor, ajo prezumohet që është bashkësi ligjore ku gjysmën e ka njëri dhe gjysmën tjetri por nëse ka ardhur në rrugë ligjore, kjo gjë ka ardhur për të dy. Ajo është rrugë kriminale por këta i gënjen mendja se bie fjala, Ilir Meta një ndër arsye që kërkon shkurorëzimin është se ka disa pasuri e ardhur si trashëgimi Monikës. Dhe me atë pasuri te toka ka blerë apartamente, e me apartamentet që ka blerë atje, janë të sajat e nuk kanë lidhje me korrupsionin tim. Në këtë aspekt, kur të vij problemi nesër, kjo veçohet dhe trashëgimia nuk të merret pasi e mban ti. Në rastin konkret i kemi të dy në hetim për problemet e pasurisë. Nga ana tjetër, SPAK-u e ka thelluar hetimin se çfarë është kjo tokë që është blerë aty e janë fituar

mbi atë apartamente të mëdha e dyqane. Kjo tokë ka qenë shtetërore dhe Ilir Meta duke shpërdoruar detyrën e Kryeministrit, këtë pronë ia ka dhënë një polici e nda ana tjetër si polici ia ka shitur në noteri nënës së Monikës. Kjo e fundit e ka blerë këtë apartament. Baza e korrupsionit i këtij kryeministri. Për rrjedhojë nuk mund të flitet për pasuri trashëgimore se kjo është rrjedhojë e krimit. E ndaj do të hetohet edhe për këtë. Po të shikojmë në hetimin që po i bëhet Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit dhe pushtetarëve të tjerë po shkohet edhe te njerëz të tjerë të dyshuar që mund t'i kenë të përbashkëta ose që andej i kanë marrë dhe burime këta të ardhura dhe u kanë mbulluar korrupsionin. Fakti që edhe ndaj disa biznesmenëve të tjerë të fuqishëm po bëhet në kuadrin e hetimit pasuror të Ilir Metës dhe Monika Kryemadhit po preken edhe disa prej tyre, do të thotë që kjo strukturë dhe BKH-ja, ka dijeni dhe se ku mund të jenë tjetërsuar këto pasuri. Kjo nuk do të jetë vetëm në ato pasuri se çfarë kanë hetuar ato po edhe në ato që përbëjnë indicie të ndryshme, goftë edhe në formën e thashethemeve i kanë mjetet SPAK-u dhe BKH-ja për të shkuar. Se në rast se ne përmendim një emër konkret e themi 51 pasuri Ilir Meta i ka vetëm në Londër dhe i ka në emër të filanit, e kjo thuhet si thashethem, atëherë është e detyruar SPAK-u që atje do vejë e do ta shikojë në është e saktë apo jo.

Intervistoi: Rigels SELIMAN

Padia e Ilir Metës për divorc me Monika Kryemadhin, caktohet gjyqtarja e dosjes, ja kush është

Gjyqtarja e Gjykatës së Tiranës, Fahrie Budo u caktua me short për të shqyrtuar padinë e divorcit të ish-presidentit Ilir Meta me bashkëshorten Monika Kryemadhi. Shorti është hedhur dje në Gjykatën Civile të kryeqytetit ndërsa padia kishte mbërritur në sekretarinë e gjykatës dy ditë më parë. Sipas procedurës pritet që gjyqtarja Budo të caktojë datën për seancën e parë të shqyrtimit të padisë, e cila do të jetë një seancë ku dy bashkëshortët ftohen fillimisht për pajtim. Në rast se çifti nuk bie dakord nisin procedurat e divorcit, i cili do të pasohet edhe me ndarjen e pasurisë së përbashkët të vënë gjatë bashkëjetesës. Kreu i PL

Ilir Meta, njoftoi më 20 qershor 2024 se kishte nisur procedurat e divorcit nga bashkëshortja e tij Monika Kryemadhi, pas 26 vitesh martesë. Ai ka sjelle si shkak kryesor që e çoi drejt vendimit për t'u ndarë deklaratat që dha Kryemadhi në SPAK. Ndërsa vetë Kryemadhi bëri të ditur se nuk i dinte arsyet e kërkesës për divorc. Ish presidenti Meta prej disa muajsh ishte larguar edhe nga banesa e përbashkët, ndërsa në dokumentin e padisë kishte vendosur si adresë banimi atë të Partisë së Lirisë. Ishte Monika Kryemadhi e cila në muajin prill të këtij viti e cilësoi raportin me Metën si një raport të ngrirë për të shkak të konfliktit në parti.

politikë

Deputetët e PD kërkojnë ta shkarkojnë nga Komisioni i Medias, reagon Flutura Aça: Një tufë interesaxhinjsh pa moral

Me kalimin e vulës në dorë të Rithemelimit, drejtimi i disa komisioneve nga mbështetës të Lulzim Bashës po shihet si një pengesë për të bërë opozitë nga deputetët e PD. Në mbledhjen e djeshme të grupit, është kërkuar shkarkimi i Kryetares së Komisionit të Arsimit dhe Medias Flutura Aça, për shkak se nuk përfaqëson grupin parlamentar të kësaj partie dhe po pengon punën e deputetëve të opozitës. E njëjta kërkesë është

bërë edhe për stafin administrativ ndihmës të grupit, ku është kërkuar shkarkimin i disa këshilltarëve të grupit. "Nuk po përmbush rolin e opozitës. Ai është pozicioni i dedikuar për Grupin Parlamentar të PD. Kryetarja e Komisionit nuk vepron në përputhje me vendimet e grupit parlamentar. Pengon çdo nismë opozitare në Komision. Nuk reagon për sulmet e Edi Ramës ndaj medias, nuk ka pranuar asnjë kërkesë për të

thirrur në dëgjese Ministrinë e Arsimit për gjendjen skandaloze në arsim, nuk bashkëpunon për të mbajtur përgjegjëse ministrinë e kulturës për gjendjen e kulturës dhe shkatërrimin e institucioneve të trashëgimisë kulturore. Pengoi votimin e kërkesës së opozitës për trajtimin në Komision të sjelljes intimiduese të Edi Ramës ndaj drejtuesve të emisionit Rai 3 dhe s'ka asnjë qëndrim për atë çështje. Është aty me votat tona, por punon

kundër nesh dhe kundër opozitës. 80 % të mbledhjeve nuk është në Komision, nuk vjen, duke ia lënë drejtimin Evis Kushit. Asnjë denoncim dhe asnjë reagim për fushat që mbulon", janë shprehur në shumicë deputetët demokratë. Kryetari i Grupit Parlamentar të PD Gazment Bardhi ka dalë kundër propozimit për shkarkim. Bardhi është shprehur se "e mirëkupton shqetësimin që ngrihet, por, me veprimin që ju propozoni ne do

të jepnim mesazhin e gabuar, sepse ne na duhet bashkimi dhe jo përjashtimi". Për këto zhvillime reagoi vetë Flutura Aça. "Ata që e kanë kërkuar kanë kohë që e vuajnë vendin tim. Por e dinë edhe vetë, nuk kanë bërë opozitë më shumë se unë. Në kemi një matës për performancën tonë politike: shqiptarët. Ata gjykojnë më drejt se një tufë interesaxhinjsh pa moral", u shpreh ajo gjatë një prononcimi për mediat.

Ja prapaskenat e forta

Gazment Bardhi i zë vendin Luan Baçit në Fier si drejtues qarku, fillon sherri në partinë e Sali Berishës midis besnikëve të tij dhe renegatëve të Lulzim Bashës

Elmas BOGDANI

Pasi mori zyrtarisht vulën dhe logon e Partisë Demokratike, ish-kryeministri Sali Berisha ka bërë disa lëvizje që kanë ndezur sherrin në Partinë Demokratike. Burime të gazetës "SOT" bëjnë me dije se kreu i PD ka çuar Gazment Bardhin në vend të Luan Baçit si drejtues qarku në Fier. Ky vendim i Berishës është pritur shumë keq nga Z.Baçi, i cili ndryshe nga Bardhi me disa deputetë që i solli nga tradhtia që i bënë Lulzim Bashës i ka qëndruar besnik ish-kryeministrit që nga shpallja e tij "non grata" nga amerikanët. Berisha nga ana tjetër është vendosur me "shpatulla pas muri", pasi ishte Bardhi me grupin e tij që i dhanë një dorë për të marrë partinë. Bardhi me deputetët e tij, madje punuan në prapaskenë për koalicionin e "non gratave" gjatë zgjedhjeve të 14 majit. Ata hoqën dorë nga bindjet e nga qëndrimet e mëparshme, duke u larguar nga ana kundërshtarë, duke u shndërruar në një bandë renegatësh, por që tashmë po përballen me



kundërshti nga besnikët e Sali Berishës, të cilët duan postet më të mira si shpërblim i besnikërisë së tyre. Gazeta e ka thënë shpesh herë se Bardhi dhe grupi i tij kanë kërkuar pazar për zgjedhjet e 2025, që të jenë ata të parët në listat fituese të PD. Por sherri që ka shpërthyer nga kjo lëvizje mes Bardhit dhe Baçit tregon se lufta për poste në PD pritet të shpërthejë në sipërfaqe shumë shpejt. "Ëndërr" në sitar Bardhi ka dhe marrjen e kreut të PD. Gjithçka varet nga vendimi i SPAK, pasi nëse Berisha dënohet, drejtimin e

PD duhet ta marrë dikush tjetër. Sherri është ndezur që tani, pasi Berisha po kërkon që të vendosë vazhën e tij në krye të selisë blu.

Prapaskenat

Por kjo po kundërshtohet nga grupet rivale që janë krijuar në PD. Mësohet se grupet dhe klanet brenda kësaj partie vijojnë me të njëjtin intensitet përballjen e nëndheshme me njëri-tjetrin. Janë 4 grupe të fuqishme që dominojnë jetën politike të PD, ndërsa grupi i pesti është në gjendje latente më shumë e shërben si "enë komunikimi" me grupet e tjera në

funksion të një ekuilibri të brishtë në PD, çka në një moment delikat ai mund ta shfrytëzojë situatën për të marrë kontrollin e partisë. Kjo do të thotë se në kushtet kur Londra dhe Uashingtoni i mbyllën Sali Berishës derën e bashkëpunimit, në lojë kanë hyrë klanet, veçanërisht katër prej tyre. Pra si grupi Bardhit, i cili duhet theksuar se iu bashkua Berishës me synimin për t'i marrë partinë, ashtu edhe tre klanet e tjera Noka, Boçi dhe Këlliçi, që ndonëse bëjnë sikur janë besnikë të kreut të PD, në thelb kanë mision për t'i "ngrënë kokën" ish-kryeministrit. Kështu që nisur nga situata aspak premtues dhe e ardhmja e zymtë që e pret Sali Berishën, madje edhe vazhën e tij, Argitën, pasi janë të dy të sanksionuar nga SHBA-ja dhe Anglia, emrat e sipërpërmendur po presin t'i japin goditjen finale kreut të Partisë Demokratike.

Çfarë e pret PD nëse i var shpresat tek Berisha?

Situata nuk duket e mirë dhe këtë e tregoi edhe ambasada e SHBA. Amerikanët i dhanë një "shuplakë" të fortë Berishës pak

javë më parë dhe gjithë atyre që i shkojnë pas "non-gratës" se duhet ta mendojnë edhe një herë hapin që po hedhin dhe të kenë kujdes marrëdhëniet me të sanksionuarit nga SHBA, ku në këtë rast përfshihet edhe Argita Malltezi. "Pozicioni ynë në lidhje me individët e shpallur non-grata mbetet i pandryshuar: ne nuk angazhohemi me persona të shpallur sipas autoritetit të sanksioneve të SHBA dhe të gjithë duhet të shqyrtojnë me kujdes se si punojnë me individët të shpallur nga SHBA", deklaroi Ambasada. Ky reagim "bombastik" paralajmëron PD se nëse mbështesin Sali Berishën dhe Argita Malltezin do të përballen me sanksione. PD e gjitha "non-grata" Por nënteksti i reagimit të ambasadës amerikane për gazetën "SOT" është i qartë si për Sali Berishën edhe për grupimin e tij: Mjaft luajtët me dy porta, ose me ne ose me atë që ne e kemi shpallur simbol të korrupsionit dhe minimin të demokracisë shqiptare! Qëndrimi për Berishën u përforcua, pasi fati i tij i zi është vulosur me kohë në SHBA.

Berisha: Sot na del se shëndetësia falas është vrasje me pagesë e qytetarëve shqiptarë nga qeveria e Edi Ramës

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje skandalin e Spitalit të Onkologjikut, duke akuzuar qeverinë se kjo është një "vrasje me pagesë e qytetarëve shqiptarë". Sipas tij, Edi Rama është bajlozi i zi i administratës së sistemit korruptiv sepse akoma pa u bërë kryeministër, hyri në saraje krimi "Të dashur qytetarë dhe qytetare, në këtë vend ku skandalet me pasoja herë-herë dhe vdekjeprurëse për qytetarët vendosen kat mbi kat, nuk di njeriu, hetohet se çfarë ndodh në këtë vend. Sot, Edi Rama deklaroi se në administratën e tij ka pjesë të zeza. Më lejoni t'i them

këtu para jush se në administratë sot kryebajlozi i zi i saj e ka emrin Edi Rama. Edi Rama është njeriu që ndërtoi me moralin e tij pervers, çnjerëzor, sistemin e korrupsionit në çdo segment të administratës. Edi Rama erdhi si bastion i zi i vjedhjes së shqiptarëve. U instalua kryeministër me akuzën e OSBE-së se gjatë kohës si kryetar bashkie, vodhi dhe depozitoi në kontot offshore 200 milionë euro. Edi Rama është bajlozi i zi i administratës së sistemit korruptiv sepse akoma pa u bërë kryeministër, hyri në saraje krimi me oborr 5 mijë metër katrorë dhe themele 720

metra të gjata, në një kohë kur bajlozi i zi kishte të deklaruar në ILDKP gjithsej 3800 euro. Kishte të deklaruar 400 mijë lekë. Edi Rama është bajlozi i zi që ndërtoi në këto vite sistemin barbar të vjedhjes së qytetarëve sepse erdhi në pushtet me pallat në pajë të zonjës së tij pesëkatësh, pa asnjë faturë tatimore, doganore, bankare, ndërtime, etj. Miqtë e mi, Edi Rama erdhi në pushtet me premtimin e shëndetësisë falas, kurse sot na del se shëndetësia falas është vrasje me pagesë e qytetarëve shqiptarë nga qeveria", tha Berisha.

Drejtoresha e SHISH nuk u paraqit për të dëshmuar në Komisionin e TIMS, Salianji: Të njoftohet policia, nuk jemi në dasmë këtu

Teksa dje duhej të ishte e pranishme për të dëshmuar si dëshmitare, drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni, nuk është paraqitur në mbledhjen e Komisionit Hetime për sistemin TIMS. Që në nisje të fjalës së tij kryetari i këtij komisioni, Ervin Salianji nuk i kurseu ironitë ndaj mazhorancës dhe faktit që Hyseni nuk ishte e pranishme, ndërsa tha se do të njoftohej policia. "Në 11:00 ishte lajmëruar për të dhënë dëshminë drejtori i SHISH, na ka sjellë një shkresë ku thuhet se

drejtori do të jetë në një aktivitet, duke i dhënë. Ç'a e tund kokën kot, se nuk është dasmë këtu. Ta shoqërojmë me polici, do të lajmërojmë policinë, do e vëmë në dijeni dhe drejtoresha, që ka punë më të rëndësishme se sa të shkosh në Beograd. Të vijë të japë dëshmi, siç e përcakton ligji. Jeni si lakuriqët e natës. Keni frikë. Keni bërë dëshmitë me dyer të mbyllura, se keni frikë nga ato që do të dalin. Keni bërë gati dhe nja 2 deputetë të tjerë, se ju duhet ndihma e të tjerëve", tha Salianji.

Lulzim Basha akuza Edi Ramës: Po tenton të kapë SPAK, të gjitha fijet e korrupsionit lidhen pas karriges së tij

Kreu i demokratëve Euroatlantik, Lulzim Basha, ka hedhur dje akuza të forta ndaj kryeministrit Edi Rama, pas fjalës që ky i fundit mbajti ditën e djeshme në mbledhjen e grupit të Partisë Socialiste, ku në fokus ishte komisioni antikorrupsion. Me një postim në rrjetet sociale, Basha shkruan se kryeministri del jep deklarata sa herë plas

një skandal korrupsioni. Basha shkruan se drejtësia po bllokohet përmes propagandës. “Sa herë i plasin skandalet e korrupsionit, si rasti i tmerrshëm i onkologjikut, pushton ekranet duke u përbetuar se tani do të luftojë korrupsionin. E sa herë ndërmerr nisma gjoja kundër korrupsionit, më shumë para vidhen nga xhepat e shqiptarëve.

Përmes propagandës synon të bllokojë drejtësinë, që ajo të mos të trokasë në derën e tij dhe t’u shesë shqiptarëve sapunin për djathë, sikur të gjithë janë të korrumpuar veç ai jo. A ka shqiptar që beson se kur janë kapur me presh në duar zëvendës kryeministri i korrumpuar, ministra të korrumpuar, kryebashkiak të korrumpuar, drejtorët e përgjith-

shëm të korrumpuar, drejtorët e bashkive të korrumpuar, të gjithë të korrumpuar, vetëm Edi Rama është i pakorrumpuar? Të gjitha fijet e korrupsionit lidhen pas karriges së tij, prandaj atij i duhet dëshpërimisht të kontrollojë SPAK, e për këtë përdor aleatët që ndajnë të njëjtin hall me të”, deklaroi ai. Ndërkohë rruga e vetme për të

luftuar korrupsionin në vend për Bashën është duke fuqizuar Prokurorinë e Posaçme (SPAK). “Sot ka një rrugë për të luftuar korrupsionin, të mbështetet dhe fuqizohet SPAK. Të tjerat janë shfaqje elektorale, për të pastruar imazhin e nxirë nga gjëmat që kanë shpopulluar vendin. Shqipëria meriton më shumë!”, nënvizoi Basha.

Nikolla nuk i dogji mandatin e deputetit, Gjykondi: Berisha nuk duhet të ishte pjesë e Kuvendit

Lulëzon pazari Berisha-Rama, Lindita Nikolla konfirmon të paprekshëm mandatin e deputetit të kreut të PD, dopio standard me rastin e Arben Ahmetajt

Rigels SELIMAN

Pavarësisht se janë bërë 6 muaj që kur Sali Berisha shkeli për herë të fundit në Parlament, përpara se Gjykata e Posaçme (GJKKO) të vendoste masën “arrest shtëpie”, atij nuk do t’i hiqet mandati i deputetit. Në Konferencën e Kryetarëve të mbajtur sot me dyer të mbyllura ku diskutua mundësia e heqjes së mandatit të Berishës, Partia Socialiste ka vendosur të mos marrë asnjë vendim. Ka qenë kryetarja e Kuvendit, Lindita Nikolla, ajo e cila ka thënë se pas këshillimit me njohësit e Kushtetutës, masa e arrestit në shtëpi nuk konsiderohet mungesë pa arsye në Kuvend. “Dua t’i japim fund spekulimeve. Qenia e një personi nën këtë masë nuk mund të konsiderohet si mungesë pa arsye në Kuvend. Jemi konsultuar me njohës të ligjit dhe Kushtetutës”, mësohet të ketë thënë Nikolla në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve. Por ky vendim i kryeparlamentares Lindita Nikolla duket se është një dopjo standard. Javën që shkoi u bënë fiks 6 muaj që Berisha nuk shkel në Kuvend dhe Kushtetuta përcaktonte fare qartë se një deputet humbet mandatin kur mungon për 6 muaj rresht pa arsye. Berisha është në “arrest shtëpie” dhe nuk i është lejuar të marrë pjesë në seancat plenare. Ndërkohë mbi të njëjtin përcaktim Lindita Nikolla nxitoi t’i hiqte mandatin Arben Ahmetajt. Kjo do të thotë se jemi përpara një pazari Rama-Berisha, pasi ndryshe nga rasti i ish-zv/kryeministrit Arben Ahmetaj, Nikolla konfirmoi të paprekshëm mandatin e deputetit të kreut të Partisë Demokratike.

Bardhi mbron Berishën

Ndërkohë të njëjtën gjë, e konfirmoi edhe kreu i grupit të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi. “Sot Kryetarja e Kuvendit, lexoi drejt Kushtetutën sa i përket mandatit të kreut të opozitës, Sali Berisha.



Strukturat ligjore te kuvendit argumentuan se Sali Berishës nuk i ndërpritet mandati pasi mungesa e tij në Kuvend nuk është pa arsye”, deklaroi ai para mediave dje pas mbledhjes së Mini-fitoren, Bardhi e shoqëroi edhe me një kërkesë. “Ne kërkuam që zotit Berisha, ne përputhje me kushtetutën t’i krijohet mundësia që të ushtrojë të plotë mandatin e deputetit duke marrë pjesë me seancat parlamentare dhe aktivitetet e tjera parlamentare. Në mënyrë arbitrare i pengohet ushtrimi i mandatit të deputetit”, nënvizoi Bardhi. Kujtojmë se Sali Berisha preku Kuvendin për herë të fundit më 21 dhjetor të vitit të shkuar, ditë kur Kuvendi vendosi heqjen e imunitetit për t’i hapur rrugë vendosjes së tij në arrest shtëpie, ndërsa i pezulloi edhe rrogën e deputetit e dietat. Berisha ndodhet në “arrest shtëpie” prej 30 dhjetorit, nën hetim për aferën e privatizimit të ish-kompleksit “Partizani”.

Reagon Gjykondi

Nga ana tjetër, për juristen e njohur, Brizida Gjykondi, është e shëmtuar dhe e pamoralshme që Sali Berisha të vazhdojë të ushtrojë mandatin e deputetit edhe pse ndod-

het në “arrest shtëpie”. Teksa ishte e ftuara dje në një studio televizive, zonja Gjykondi u shpreh se vetëm nga ligji i dekriminalizimit, Berisha nuk duhet të ishte pjesë e Kuvendit. Sipas saj, Berisha nuk ofron gjë tjetër veç se modelin e mosbindjes ndaj shtetit të së drejtës. “E shëmtuar dhe pa moral. Të shikosh ligjin për dekriminalizimin, që në nenet e para të tij, ai si personazh nuk duhet të ishte më pjesë e parlamentit të Shqipërisë. Që në momentin që ai është në arrest shtëpie, për shkak të mosbindjes së tij progresive ndaj strukturave të drejtësisë shqiptare, mund të ishte në gjendje të lirë, por çdo gjë ka qenë pasojë e injorimit dhe poshtërimit që i ka bërë institucioneve të drejtësisë shqiptare, dhe me ligjërime, me sjellje, duke ofruar model kriminal për të gjithë qytetarët shqiptarë, modelin e mosbindjes ndaj shtetit të së drejtës. Berisha merr rrogën, merr rrogën çdo muaj. T’i jepnin edhe dietat. Reforma në drejtësi, ka qenë një domosdoshmëri jetike dhe nuk mund të mburret, nëse duan ta vazhdojnë udhëtimin që kanë nisur, ta vazhdojnë siç e nisën”, deklaroi dje Gjykondi.

Tabaku: Onkologjiku, produkt i korrupsionit të kthyer në sistem, skandali i hoqi maskën qeverisë

Deputetja e Partisë Demokratike, Jorida Tabaku ka reaguar dje mbi ngjarjen tek Spitali Onkologjik i Tiranës, duke e cilësuar si një produkt të korrupsionit të kthyer në sistem. Reagimi vjen përmes një postimi në “Facebook”, tekta shprehet se ky rast tregon qartë se sa thellë ka shkuar sistemi korruptiv në vendin tonë. Për Tabakun, korrupsioni endemik ka prekur çdo sektor të jetës dhe është kthyer në standard apo normë. Ndër të tjera, Tabaku, ngre pyetjen nëse mundet që një qeveri që e ka korrupsionin në çdo qelizë të sajën mundet të ngrejë komisione apo programe pune në luftën kundër korrupsionit? Më pas ajo analizon se si nuk ka ende një beteje reale të qeverisë shqiptare kundër korrupsionit përdërisa nga policia tek rrugët, nga menaxhimi mbetjeve tek spitalet gjithçka është brenda një skeme që mbetet korruptive me kosto jetën e njerëzve. “Ajo që ka ndodhur tek Onkologjiku. Bisedat që kemi parë. Ajo që është ekspozuar në sytë e të gjithëve. Na ka lënë pa fjalë. Na ka tronditur. Pasi korrupsioni që bëhej nga polici tek rrugët apo dhe me mbetjet. Sot, ka shkuar tek jeta! Dhe biznesi me vdekjen. Biznesi me jetën sigurisht që të lë pa fjalë. Ky korrupsion endemik. Në çdo sektor, në çdo sistem që është kthyer në standard dhe normë nuk është ndërtuar brenda ditës. Është një sistem i cili me kohë është ngritur, është mbështetur dhe kushdo ka folur për të është sulmuar dhe sot çdo fjalë e propagandë edhe për reforma antikorrupsion edhe për komisione antikorrupsion sigurisht që është i pavlerë. Sepse ajo është fytyra e vërtetë e qeverisjes. Aty tek onkologji është çjerrë maska e qeverisë. Duke ngritur dhe shumë pikëpyetje se si sot funksionon sistemi i shëndetësisë, se si dhe sa përdoren fondet publike, koncesionet në shëndetësi. Për rolin që kanë spitalet private. Për mjekët e dypunësuar, për rolin e distributorëve. Për një sistem të tërë në shëndetësi që fatkeqësisht është abuziv. Është abuziv dhe i korrumpuar njësoj si sistemet e tjera. Ashtu si ai i rrugëve, ashtu si ai i mbetjeve dhe si shumë sektorë të tjerë që sot po ekspozohen përditë. Këtë sistem që në këto dhjetë vite fatkeqësisht ka zënë vend”, shkroi Tabaku.

politikë

Kolegji vendosi të shtyjë seancën për në datën 11 korrik

Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit që i dha Sali Berishës vulën e PD në telashe, KPA çel hetimin administrativ, prokurori i ONM e “gozhdon” me pyetje

Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit, Iliba Bezati që i dha Sali Berishës vulën e PD duket se është në telashe. Kolegji i Posaçëm i Apelit dëgjoi të mërkurën qëndrimet e palëve në çështjen ndaj gjyqtarës së Apelit, Iliba Bezati, e cila është një nga gjyqtaret që ishte pjesë e trupës gjyqësore që vendosi t'i kalojë Sali Berishës vulën e Partisë Demokratike. Bezati që është konfirmuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit u ankimua në Kolegjin në vitin 2021 nga Komisioneri Publik. Gjatë seancës në fjalën e tij Komisioneri Florian Ballhysa u qëndroi parashtrimeve të bëra në ankim, ndërsa kërkoi nga Kolegji të hetonte burimin e një huaje 30 mijë euro dhe po ashtu një analizë të re financiare për gjyqtaren. Ballhysa kërkoi po ashtu hetim sa i përket profesionalizmit të gjyqtarës. Bezati, e cila u mbrojti vetë në seancë, po ashtu mbajti të njëjtat qëndrime si në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ajo i tha trupës, së kryesuar nga Rezarta Schuetz, me anëtare Albana Shtylla, Natasha Mulaj, Ina Rama dhe Sokol Çomo, se pasuritë e saj dhe bashkëshortit ishin me të ardhura të ligjshme. Bezati foli në detaje mbi mundësitë financiare të një huadhënësi dhe kompanisë së tij. Ajo po ashtu dha shpjegime edhe mbi çështjet e sjella në Kolegjin nga Komisioneri.

Vëzhgues i ONM pyet gjyqtaren
Ndërkohë vëzhguesi Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, prokurori Stiven Kesler i bëri asaj një listë pyetjesh në lidhje me marrëdhënien me huadhënësin, mënyrën e marrjes së huas dhe arsyet e blerjes së një apartamenti në Tiranë në vitin 2005. Bezati tha se ajo vetë nuk kishte marrëdhënie miqësie me huadhënësin, por këto ishin



marrëdhëniet e bashkëshortit. Në fund të seancës KPA vendosi të pranojë si prova të reja tre dokumente, përfshi dy vendime gjyqësore dhe një shkresë nga drejtorja e tatimeve. KPA, me shumicë votash, vendosi t'i kërkojë Komisionerit Publik të bënte të qartë pjesë të analizës financiare të bëra në KPK me të cilat nuk binte dakord dhe t'ia vinte në dispozicion trupës dhe subjektit deri në datën 3 korrik. Njëkohësisht Kolegji vendosi të shtyjë seancën për në datën 11 korrik.

Vula e PD i kaloi Berishës

Ndërkaq kujtojmë se Gjykata e Apelit ka vendosur këtë të martën e 11 qershorit që vula e Partisë Demokratike t'i kalojë ish-kryeministrit Sali Berisha. Pas më shumë se 2 orë seancë gjyqësore ku u dëgjuan përfaqësuesit ligjorë të Partisë Demokratike zyrtare të Lulzim Bashës dhe të grupit demokrat të Rithemelimit të Sali Berishës, trupi gjyqësor së Apelit u tërhoq për vendim. Çështja u shqyrtua nga relatorja Alma Ahmeti, ndërsa anëtarë do të jenë Iliba Bezati dhe Elona Toro. Në mbyllje të seancës gjyqësore,

deputeti i Rithemelimit, Flamur Noka komentoi vendimin duke thënë se “nuk është ditë për të festuar as për triumf, por është ditë për t'i ftuar që të jenë të gjithë bashkë kundër narkoregjimit”. “Demokratët sot janë të bashkuar. Sot vendimi i gëzon ata. Është ditë e keqe për regjimin. Një opozitë e përçarë ka marrë fund”. Nga PD zyrtare në gjykatë ndodheshin Indrit Sefa, Rezart Kthupi dhe Endri Hasa, ndërsa nga Rithemelimi krahas përfaqësuesve ligjorë janë dhe deputetët kryesorë mbështetës si Flamur Noka, Gazment Bardhi, Agron Gjekmarkaj. Ivi Kaso si përfaqësues i Rithemelimit i kërkoi gjykatës së Apelit të mos pranohet kërkesa e bërë në mars 2022 e Enkelejd Alibeajt si palë në proces. “Vlerësojmë që Gjykata e Lartë ka orientuar Apelin në argumentet e veta, me arsyen kryesore që Apeli s'ka kuptuar thelbin e çështjes, pra që kjo çështje bëhet pa praninë e palëve të tjera. Është shumë specifike sa i takon verifikimit të këtyre vendimmarrjeve, për aktet e një subjekti politik. Ligji thotë që

duhet të jenë të kujdesshme, ka vetëm një palë dhe ankimi bëhet po ashtu nga pala që ka vënë në lëvizje gjykatën”, deklaroi Kaso.

Beteja e dy viteve

Situata e krijuar tashmë prej më shumë se dy vitesh pati përditësimin e fundit në mars, kur Gjykata e Lartë zbardhi vendimin e plotë për çështjen e vulës së Partisë Demokratike, sa i takon rikthimit për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit. Në vendimin prej 36 faqesh, Kolegji i Gjykatës së Lartë vlerësoi se rekursi i paraqitur nga pala kërkuese në këtë gjykim, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit përmban shkaqe të cilat, e bëjnë të cenueshëm vendimin e dhënë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Gjykata e Lartë vendosi prishjen e vendimmarrjes së Apelit, që e riktheu çështjen në Shkallën e Parë dhe rrezoji vendimin e Agron Zhukrit që i dha vulën ish-kryeministrit, Sali Berisha. Ky vendim asokohe u pa u si në favor të askujt. “Gjykata ka vendosur që çështja në vend të kthehet në shkallë të parë, sikurse kishte vendosur Gjykata e Apelit, dhe të jetë kjo e fundit ajo që do të zgjidhë çështjen në themel. Në praktikë ka kursyer kohë për palët ndërgjyqëse”, tha për Albanian Post, avokati Rezart Kthupi. Ndryshe, një jurist i një studioje të madhe ligjore në Tiranë – për të cilin do të ruajmë kushtet e anonimitetit – sqaroi se në lexim të vendimit “Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e Apelit dhe i ka kërkuar që të vendosë për vendimin e Agron Zhukrit dhe jo ta kthejë për rigjykim”. Zhukri pati njohur vendimet e Kuvendit të 11 dhjetorit të Rithemelimit. Pra, sqaron juristi tani mbeten dy alternativat. “Apeli do të vendosë të rrezojë vendimin e Zhukrit përfundimisht duke i dhënë të drejtë

palës kundërshtuese, në këtë rast palës së kryedemokratit, Lulzim Basha, ose ta lejë në fuqi, duke i dhënë të drejtë palës së Berishës”, theksoi ai. Ndërsa, sipas Kthupit në këto momente vulën e ka PD-ja zyrtare, sa kohë “jemi të regjistruar në Gjykatën e Tiranës dhe kryetar është Lulzim Basha sipas regjistrimit të partive politike”. Nga ana tjetër, ish-kandidati për kryetar i PD-së, Fatbardh Kadilli në një koment për AP, ravijëzon se “vendimi lë ende në dyert e gjykatës palët”. “Por, asnjë zgjidhje ligjore nuk zgjidh krizën politike. PD nuk ekziston më. Është ndarë në dy struktura, njëra me Berishën njëra me Bashën. Kemi deputetët që janë në një konflikt ligjor në Kuvend për të drejtat e grupit. Por, kemi dhe masën më të madhe të demokratëve që nuk janë anësuar dhe refuzojnë të gjitha këto forma që kanë shpërbërë PD”. E gjithë beteja nisi më 11 dhjetor të vitit 2021, ku Sali Berisha – pas përjashtimit nga grupi parlamentar të Partisë (kohë ku u shpall non grata) – mbajti një Kuvend Kombëtar. Në atë Kuvend u miratuan disa vendime, siç ishte shkarkimi i Lulzim Bashës si kryetar dhe ndryshimet statutore. Muaj më pas ishte gjyqtari Agron Zhukri – i shkarkuar nga Vettingu – i cili regjistroi statutin e Kuvendit të Partisë Demokratike të 11 Dhjetorit të mbajtur nga Komisioni i Rithemelimit. Vendimi u apeluar nga PD-ja e Bashës dhe në 2023-shin Apeli vendosi ta kthente në shkallë të parë, por sërish ky vendim u apeluar dhe Sali Berisha që çoi çështjen në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit theksoi se Apeli nuk kishte kryer një hetim të plotë të çështjes, nuk kishte kuptuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kishte interpretuar gabim normat dhe ligjin procedural.

Ambasadori i BE në Tiranë takim me kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Gonzato: KLSH luan rol vendimtar në luftën kundër korrupsionit

Ambasadori i Bashkimit Evropian në vendin tonë, Silvio Gonzato, ka zhvilluar një takim me kreun e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Arben Shehu. Njëpërmjet një postimi në “X”, Gonzato shkruan se KLSH luan një rol vendimtar në luftën kundër korrupsionit, përdorimit efikas të fondeve publike, si dhe në mbështetjen e Kuvendit në mbikëqyrjen e tij buxhetore. Më tej, Gonzato ka treguar se

gjatë takimit të sotëm me Shehun, u diskutua mbi forcimin e rolit të KLSH-së, ndërsa e ka inkurajuar për të vazhduar përpjekjet për përmirësimin e aksesit dhe përdorimit të raporteve të auditimit nga Parlamenti, OSHC-të dhe qytetarët. “Kontrolli i Lartë Shtetit luan një rol vendimtar në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e tij, në promovimin e qeverisjes së mirë

dhe përdorimit efikas të fondeve publike, si dhe në mbështetjen e Kuvendit në mbikëqyrjen e tij buxhetore. Gjatë takimit të sotëm me Kryetarin e tij, Arben Shehu, folëm për forcimin e rolit të KLSH-së. Gjithashtu e inkurajova atë që të vazhdojë përpjekjet për përmirësimin e aksesit dhe përdorimit të raporteve të auditimit nga Parlamenti, OSHC-të dhe qytetarët”, shkroi Gonzato.

I emëroi ambasadorë, Rama shkarkon dy zv/ministra, caktohet prefekti i ri i Elbasanit

Kryeministri Edi Rama ka firmosur dje dy ndryshime në ekzekutiv, duke liruar nga detyra Artemis Malo, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe Besart Kadia, zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme,

lirohet nga kjo detyrë. Malo është propozuar si ambasadorë e Shqipërisë në Kanada, ndërsa Kadia është propozuar si ambasador i Shqipërisë në Azerbajxhan. Ndërkohë po dje është vendosur Prefekti i ri i Elbasanit, i cili do të jetë Ali Musliu.

Rama: Puna për komisionin Antikorrupsion do të vijoj me ose pa opozitën

Kryeministri Rama ul tonet me mediat dhe merr në mbrojtje gazetarët nga sulmet e prokurorisë, thirrje SPAK të hetojë administratën e korruptuar

Elmas BOGDANI

Kryeministri Edi Rama ka dhënë ditën e djeshme disa mesazhe shumë të forta. Gjatë konferencës për të drejtën e Informimit, kreu i qeverisë u tregua kritik përsa i takon zbatimit të legjislacionit mbi transparencën në vend. Rama si rrallë herë uli tonet me mediat duke iu doli krah gazetarëve për pjesën nxjerrjen e dokumenteve të caktuara zyrtare. Rama tha se asnjë sekret hetimor nuk mund të bëhet publik nga gazetarët nëse prokurorët e ruajnë atë. Duke u ndalur te rasti i gazetari Elton Qyno, apo dhe disa raste të tjera në kohën e pandemisë së COVID-it, kryeministri Rama u shpreh se nëse një sekret hetimor i tillë iu bie në dorë gazetarëve, duhen hetuar ata që ua dhanë këto informacione, duke 'shigjetuar' kështu prokurorët. "Sekreti hetimor është diçka tjetër. Përfitoj nga rasti të falënderoj Avokaten e Popullit, me një rast të një gazetari i cili u akuzua dhe u keqtrajtua për nxjerrje të sekretit hetimor. Ka ndodhur edhe gjatë pandemisë së COVID kur prokuroria ju vu mbrapa ca gazetarëve dhe për mua gazetarët nuk nxjerrin sekrete hetimore. Pasi gazetarët nuk i deponojnë sekretet, i disponojnë prokurorët. Kur i bie në dorë sekreti gazetarit, nuk është më detyrimi i tij të ruajë sekretin. Dhe nuk shkon drejt tij hetimi, por drejt atyre që ia dhanë atij.



Kjo është elementare. Që në Kanun shkruhet e zeza në të bardhe 'Lajmësi nuk ka faj', kush e prodhoi ose kush ja dha që ta çoj diku tjetër, pra te burimi, me atë duhet të merresh. Informacioni, mbi gjithçka që institucionet publike bëjnë dhe mbi gjithçka që ekzistojnë në letër në vulë në firmë, dhe që nuk përfshihet në një hapësirë të ngushtë, është pronë publike që shteti nuk ka asnjë të drejtë t'ja mohojë qytetarëve", u shpreh Rama.

Rama thirrje SPAK të hetojë administratën e korruptuar

Mesazhet e Ramës nuk u ndalën vetëm në konferencën për të drejtën e Informimit. Kreu i qeverisë mbledhi pasditen e djeshme grupin e PS, ku shprehu mbështetjen për drejtësinë. Rama i bëri thirrje SPAK dhe prokurorive të zakonshme që t'i japin fund pjesë së zezë të administratës (korrupsionit)

që e cilësoi një turp kombëtar. "Progresi i bërë është shumë i rëndësishëm për të gjithë ata që janë të përfshirë. Nëse shohim diagnozën, ka një të vërtetë shumë të madhe, se sa nevojë ka akoma për të garantuar një shtet që është dhe mekanizëm i harmonizuar dhe që subjektiviteti njerëzor të gjejë shumë më pak hapësirë për të ndërhyrë dhe për ta ofruar korrupsionin si alternativë për ata që duan të marrin nga shteti shërbimin e etj. Për ata që tundin këmbën dhe dua mundësi të shfaqen, është puna e tyre. Puna jonë është për të shtyrë përpara këtë proces. Bëhet fjalë për të ndërhuar makinerinë shtet që Shqipëria s'e ka pasur kurrë, por mund ta ketë brenda këtij 10-vjeçari, nëse bashkohet me aftësi të gjithë agjendës së përcaktuar nga diagnoza. Nuk është rastësi emri që ne i kemi

vënë komisionit. Na ka dhënë shumë kuroja screening se na ka dhënë mundësi të shohim se sa potencial kemi. Shqipëria kë një administratë publike, që ka një pjesë të bardhë të rëndësishme ka dhe një pjesë të zezë, me të cilën sot shumë e shumë më tepër se dje, merret drejtësia. Falënderoj prokurorët e SPAK dhe të tjerë në prokuroritë e zakonshme, të bëjmë sa më shumë për ta zvogëluar atë pjesën e zezë që është një turp kombëtar. por ama pjesa e bardhë e administratës nuk është opinion", tha Rama.

Kapja e SPAK

Po ashtu Rama qartësoi sërish se Komisioni Anti-Korrupsion nuk është ngritur për të prekur Reformën në Drejtësi e as për të kapur Prokurorinë e Posaçme por për të koordinuar punën e një skuadre të tërë, me qëllimin e përbashkët të integritimit në Bashkimin Evropian. "Kush e garanton popullin shqiptar, kush e garanton shtetin shqiptar që gjithë kjo masë institucionesh që është detyrimisht pjesë e kësaj skuadre kombëtare, do të luajë si skuadër Kush ia jep garancinë Shqipërisë që në tryezën e negociatave nuk do të ketë disa lojtarë që do shkëlqojnë, disa lojtarë që do ia hedhin fajin shokëve dhe disa lojtarë që do paraqesin raport për mos paraqitje në ndeshje, sepse janë institucione e pavarura. Kush i kërkon llogari? Qeveria? E pamundur. Ka vetëm një in-

stitucion sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku mund të kërkohej llogari për këdo, kurdoherë; Kuvendi", tha Rama.

Thirrja për opozitën

Opozitës që e ka bojkotuar Komisionin Anti-Korrupsion, Rama i shtrin sërish dorën e bashkëpunimit, me një garanci të shtuar, atë të ndërkombëtarëve. "Në çdo moment që do duan të ulen në atë tavolinë dhe t'i sjellin aty të gjitha idetë që kanë për si luftohet korrupsioni, të gjitha idetë për si luftohet krimi i organizuar, të gjitha idetë që kanë për si luftohet për ta bërë Shqipërinë më të sigurt, më kompetitive, më europiane, t'i sjellin aty dhe pa asnjë paragjykim dhe pa asnjë diskutim çfarë është pozitive dhe çfarë është e dobishme dhe çfarë është e vlefshme do të qëndrojnë aty sepse gjëja e mirë e kësaj pune është që kjo punë është një punë që kur të shkruhet në çdo kapitull të vetin, në çdo faqe të vetën do duhet të certifikohet nga partnerët tanë, nga Bashkimi Europian dhe patjetër dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës", tha Rama. Por nëse Partia Demokratike sërish refuzon ftesën e tij, Rama urimin e ka gati. "Ata që nuk duan ta kuptojnë sepse duan ta kuptojnë, nuk i ndihmojmë dot dhe nuk i shqetësojmë në aktivitetin e tyre të padobishëm. Të vazhdojnë punën e tyre", tha Rama.

Tryeza e negociatave, Rama: Kuvendi ka rolin e mbikëqyrësit, garanton që çdo institucion të kryejë detyrën në procesin e anëtarësimit

Në fjalën e tij në mbledhjen e grupit parlamentar socialist, kryeministri Edi Rama parashtrroi dje punën e institucioneve të shtetit shqiptar drejt anëtarësimit të vendit tonë në BE. "Janë 761 rekomandime të KE, po ti shihni ndahen në rekomandime për shtetin e së drejtës, për mirëqeverisjen dhe pastaj ndahen në pjesë të tjera për kriterin ekonomik, tregun e brendshëm. Ajo që ne kemi bërë duke ngritur komisionin Antikorrupsion, duke parë institucionet që kanë pjesën e tyre të peshës për të mbajtur në zbatimin e rekomandimeve dhe masave. Po të shohim te pjesa e masave, institucionet zbatuese fillojnë nga Kuvendi, Kryeministrinë, departamentin e

administratës publike e me radhe dhe shkojnë me tutje të shkolla e Magjistraturës, avokati i popullit etj. Ndërsa po të vijmë tek drejtësia, meqë sa herë trajtohet çështja e kësaj nisme ngrihen antenat e atyre që s'dinë se ç'flasin, shikoni se sa pjesë zë drejtësia në këtë bllok. 59% të punës. Sot që flasim. Shikoni reformën në drejtësi, sa rekomandime në këtë proces nga BE, jo nga PS, për reformën në drejtësi 32 rekomandime. Nëse këtu lexohen si konsolidimi, dhënia e pavarësisë më tutje përkthehen në masa. Që do të thotë që ky proces është jo thjesht i nevojshëm por i domosdoshëm. Vetëm fakti që ne e morë përsipër dhe askush tjetër nuk e kupton

dhe prandaj e keqinterpretojnë. Ky fakt tregon sa i rëndësishëm është roli ynë dhe sa e domosdoshme që kjo punë të bëhet duke pasur në Kuvend një sy që është sot komisioni i posaçëm, nesër çfarëdo qoftë propozimi i cili me fuqinë që ka Kuvendi të mund të shoh këtë proces duke shfrytëzuar kapacitetin që i jep kushtetuta ta koordinojë këtë proces. Institucionet zbatuese këtu janë shumë qartë lidhen me ekzekutivin dhe një pjesë shumë e madhe janë të pavarura. Që nga KPK, KLGJ, SPAK, GJKKO, KLP, Gjykata e Lartë, ILD, Avokati i popullit, BSH, INSTAT, ERE, AMA, SHISH deri tek Universiteti Bujqësor", tha ndër të tjera Rama.

Integrimi në BE, Edi Rama: Po punojmë për të realizuar objektivin historik

Në mbledhjen e grupit të PS, kryeministri Edi Rama foli për integrimin e vendit në BE. Rama tha se PS është e vetmja forcë politike që mund ta çojë para këtë proces. "Procesi ka rezultuar befasues për KE, në aspektin e paraqitjes të Shqipërisë në të gjitha prezantimet dhe ka rezultuar i kënaqshëm në aspektin e stadi të zhvillimit dhe përgatitjes ku ne e kemi sjellë vendin. Çfarë duhet bërë akoma në mënyrë që vendi të plotësojë të gjitha kushtet në aspektin teknik për të

qenë një vend anëtar i BE, pastaj vendimmarrja politike është çështje që merremi dhe vazhdojmë të merremi në mënyrë që ky objektiv historik të realizohet. Kjo vlen për të gjithë ne dhe ata që janë të interesuar të kuptojnë këtë proces, që nuk ka forcë tjetër në këtë vend që të jetë në gjendje jo ti bëjë këto, po ti kuptojë këto. Të jetë në gjendje ti transmetojë këto, të jetë në gjendje ti transmetojë me forcën dhe me aftësinë që disponon kjo forcë politike", tha ai.

Ja investigimi

Tre institucionet në varësi të Belinda Ballukut abuzime dhe luks të financuar nga tarifat në kurriz të qytetarëve, zbardhen skandalet e rënda

“Investigative Network Albania”, e financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Tiranë ka nxjerrë disa skandale të institucioneve që janë në varësi të zv/kryeminstres Belinda Ballukut. Në artikull tregohen abuzimet dhe luksi i financuar nga tarifat në kurriz të qytetarëve.

Investigimi i marrë me shkurtime

Më 16 janar të këtij viti Këshilli Drejtues i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) rriti tarifat për shërbimet më të kërkuara nga qytetarët. Disa prej tyre i dyfishoi. Të ardhurat për këtë agjenci gjatë vitit 2023 ishin 35 milionë euro, duke e bërë DPSHTRR-në një nga institucionet publike me buxhetin më të madh në vend. Përveç tyre edhe tarifa e pajisjes me leje drejtimi u rrit me 1.000 lekë më shumë, ndërsa afati i vlefshmërisë së saj u zgjat nga 10 në 15 vjet. Leja e drejtimit ndërkomëtar nga 500 lekë, tashmë kushton 1.000 lekë, me afat vlefshmërie deri në 3 vjet.

Fitimi të larta dhe shpenzime luksi

Në vitin 2022 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor arriti një bilanc pozitiv me 5.6 milionë euro fitime nga 30.1 milionë euro të ardhura, të mbledhura nga tarifat. Fitimi i vitit 2021 ishte dhe më i lartë, 6.8 milionë euro. Me fitim 1.8 milionë euro rezultoi kjo agjenci edhe gjatë vitit të pandemisë, 2020, kur shumica e kompanive publike dhe private pësuan humbje të thella. Të ardhurat e agjencisë vetëm vitin e shkuar u shtuan me 5 milionë euro, ndërsa fondet e saj në bankë kapin vlerën 30 milionë euro. Statuti e lejon DPSHTRR që një pjesë të fitimit ta mbajë për rezervë të kapitalit dhe për zhvillim. Deri në 15% mund ta ndajë për shpërblym të punonjësve dhe një pjesë tjetër, për ndihma sociale. Mbështetur në këtë nen të statutit, Këshilli Drejtues i kësaj agjencie në korrik të vitit 2022 ka dhënë 67 mijë euro mbështetje financiare për televizionin Top Channel. Ky fakt është shënuar edhe në bilancin e audituar të kësaj agjencie, por që mohohet nga DPSHTRR. “DPSHTRR nuk e ka financiar televizionin Top Channel në asnjë lloj forme, as në formën e ndihmës sociale”, shprehet agjencia. Zyra e Marketingut të Top Channel-it nuk iu përgjigj interesimit të INA Medias lidhur me këtë fond. “Bamirësia” për televizionin më të madh në Shqipëri nuk është shpenzimi i vetëm, i pajustificuar i DPSHTRR. Vitet e fundit agjencia ka nisur një plan për të rikonstruktuar pjesën më të madhe të godinave të saj. Në vjeshtën e vitit të kaluar DPSHTRR zhvilloi tenderin për të rikonstruktuar ndërtesën qendrore në kryeqytet për 7 milionë euro. Projekti i hartuar nga arkitekti italian, Stefano Boeri, dhe firma Son Engineering, parashikon një ndërtesë 7-katëshe (5 mbi dhe dy nëntokë), me sipërfaqe 6.105 m², bashkë me 39 vende parkimi. Kostoja e rikonstruksionit për metër katror llogaritet 1.146 euro. Kjo shifër është gati dy herë më e lartë sesa kostoja e ndërtesave civile në kryeqytet, të cilat kanë shpenzime shtesë të truallit dhe të taksave dhe 3 herë më e lartë se çmimi që ndërton Enti Kombëtar i Banesave.

Evente, dieta, bileta, shpërblime dhe gjoba

Agjencia e Shërbimeve të Transportit Rrugor funksionon si agjent tatimor i qeverisë në dy raste: për mbledhjen e taksës së mjeteve të përdorura dhe në vjeljen e taksës së luksit të makinave. Çdo vit DPSHTRR merr 5% të këtyre të ardhurave si agjent tatimor, duke arkëtuar 4 milionë euro. Edhe nga gjobat në vonesën e pagesës së taksave DPSHTRR merr 60% dhe Drejtoria e Tatimeve,



40%. Sipas bilancit të dorëzuar për vitin 2022, përfitimet nga gjobat ishin 1.2 milionë euro. Për prodhimin e dokumentacioneve dhe kontrollit i duhen 5 milionë euro dhe 17.6 milionë euro të tjera për pagat e 1.097 punonjësve. Shpenzimet e tjera mund të konsiderohen luks. Çdo vit mijëra euro kanë financuar evente, pagesa për skena, konkurse, gara me makina, ekspozita retro dhe sponsorizime të ndryshme. Gjatë vitit 2023 janë shpenzuar 20 mijë euro për bileta avioni, 60 mijë euro për të zhvilluar materiale videosh promovuese dhe 156 mijë euro për evente, nga të cilat 80 mijë euro kanë shkuar për podiume dhe foni. Për Konkursin Ndërkombëtar të Projektit Auto Moto Park Albania janë paguar 9 mijë euro për akomodimin e të ftuarve dhe 4 mijë euro për sallën e eventit. “DPSHTRR organizon evente dhe panaire, që lidhen ngushtë me veprimtarinë e objektit të saj”, – sqaron agjencia, ndërsa ekspertët rekomandojnë që baza për tarifat dhe shpenzimet e këtyre institucioneve duhet të përcaktohet me ligj të veçantë. “Vendosja e tarifës duhet të kishte një bazë ligjore të përcaktuar qartë për të gjitha institucionet”, thotë Gjokutaj.

Porti i Durrësit me fitime të majme, por tenton të rritë tarifat

Që prej vitit 1992 Autoriteti Portual Durrës (APD) ka statusin e personit publik, që ka detyrimin për financimin e shpenzimeve dhe mbulimin e kostove të shërbimit. Dy aktivitetet kryesore të shërbimeve portuale, terminali i mallrave rifuxho dhe ai i trageteve për bizneset, ofrohen nga kompani private. Për mallrat rifuxho kompania EMS Shipping and Trading derdh 11% të tarifave për Autoritetin Portual, ndërsa Albania Ferry Terminal, 49% të tyre. Tarifa për terminalin e konteinerëve ka peshën më të madhe në buxhetin e APD. Për këtë shërbim Autoriteti Portual kontrakttoi disa vjet më parë firmën private Mariner Adriatic. Kompania paguhet 7.1 milionë euro në vit, ndërsa nga tarifa për konteinerët iu sigurohen mesatarisht 14.5 milionë euro në vit. 3.7 milionë euro janë vjelje nga terminali i mallrave rifuxho dhe 6 milionë euro nga koncesioni i trageteve. Autoriteti Portual i Durrësit arkëtoi 27.8 milionë euro vitin e shkuar, nga të cilat 1.1 milionë euro ishin fitim. Fitimet vitet e mëparshme kanë qenë dhe më të larta. 1.6 milionë euro në vitin 2022, 2.4 milionë për vitin 2021 dhe 4.1 milionë euro gjatë pandemisë së vitit 2020. 10 milionë euro nga fitimet e mbledhura ndër vite ishin investuar në fondin privat Credins Invest, portofoli i një banke tregtare, i cili investohet në bono thesari. Ky është një rast tipik se si agjencitë publike, në vend që t'i rishikojnë tarifat me ulje ose të derdhnin fitimin në buxhet, mbajnë fonde në bankë për t'i

dhënë borxh me interes shtetit. Pasi e mësoi këtë devijim, Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë kërkoi prishjen e investimit dhe drejtimi i portit e tërhoqi depozitën, duke e mbajtur në rezervë e kapitalit.

Detajet

Edhe pse rezultatet financiare janë pozitive, vitin e shkuar APD iu propozoi ministrive përgjegjëse (Ministritë së Infrastrukturës dhe Ministritë së Financave) rritjen e tarifave portuale. Vendimi hyri në fuqi në muajin shkurt, por u shfuqizua në korrik, pas ankesave të operatorëve tregtarë dhe kërcënimit për rritjen e çmimeve për konsumatorët fundorë. Operatorët shprehen se ka ende tarifa të fshehta, që janë rritur, ndërsa kostot janë shtrenjtuar edhe në portet e huaja, ku ata operojnë për të importuar mallra. “Tarifat portuale janë rritur, ishin të larta më parë me nisjen e konfliktit Rusi-Ukrainë dhe pas stabilizimit ranë çmimet, tashmë janë rritur sërish për shkak të mbylljes së kanalit të Suezit, që po e bombardojnë si pasojë e agresionit të Izraelit në Gaza. Autoriteti i Durrësit i ka rritur, por jo në shkallë të lartë. U rrit energjia elektrike përpara dy-tre vjetësh, për shembull...”, thotë Rodolf Xhillari, pronar i shoqërisë BalkanTrans Albania. Shpenzimet e Autoritetit Portual Durrës bashkë me vlerën e kapitalit të tij nuk do të preken as për projektin e portit të ri në Porto Romano. Investimi do të financohet i gjithi përmes huamarrjes nga qeveria qendrore me një vlerë totale 415 milionë euro. Gjatë vitit të shkuar APD prokuroi 3.1 milionë euro, pjesa më e madhe rikonstrukcion dhe godina të reja, edhe pse në një plan të afërt të gjitha ndërtesat do të prishen për t'i lënë vendin rezidencës Durrës Yacht Marina. Edhe këtë vit në bazë të regjistrimit të parashikimeve të prokurimit publik, 830 mijë euro do të shkojnë për mobilim dhe për rregullim të zyrave dhe një pjesë e këtij fondi do të përdoret për mirëmbajtjen e infrastrukturës së portit. Porti i Durrësit parashikon të bëjë restaurim të tualeteve, të blejë perde me mekanizëm, pajisje elektro-shtëpiake, dyer të reja dhe punime mermeri. 110 mijë euro do të kushtojë mirëmbajtja e gjelbërimit, edhe pse në ambientet e portit nuk ka asnjë bimë. Për argëtimin e stafit do të blihet një objektiv për poligon qitjeje me vlerë 5 mijë euro.

Port “inteligjent”, por mallrat shkarkohen në tokë

Manisë për digjitalizimin e shërbimeve nuk i kanë shpëtuar as agjencitë jo-buxhetore, ku shpenzimet në sistemet e IT-së kanë peshën kryesore në buxhet. Gjatë këtij viti APD parashikon 1.3 milionë euro për sisteme teknologjike, shumë që zë 40% të buxhetit të prokurimeve. Vetëm për sistemin Mail Cloud, i cili ble hapësirë për të ruajtur postën elektronike, do të shpenzohen 49 mijë euro, 250 mijë euro do të kushtojë sistemi elektronik i inteligjencës për mbrojtjen nga hakerimi. Për përmirësimin e shërbimeve do të investohen 730 mijë euro. Por, pavarësisht këtyre investimeve, numri i punonjësve është rritur, nga 455 në vitin 2022 në 460 për vitin 2023 dhe fondi i pagave është shtuar me 300 mijë euro, pa justifikuar thelbin e investimeve në teknologji. “Teknologjia është ajo që ka ndikimin kryesor për qytetarët dhe që ndikon tek ulja e kostos”, thotë eksperti Gjokutaj. Operatorët, që punojnë pranë Portit të Durrësit, nuk janë të shqetësuar për tarifat më shumë sesa për cilësinë e shërbimeve, që ofron ky institucion. Rodolf Xhillari thotë se investimet kryesore duhet të orientohen në pajisje për mirëmbajtjen e mallrave, që shkarkohen dhe që kontrollohen në ambientet e portit.

Autoriteti i Aviacionit Civil, arkëtime pa kontroll

Në vitin 2010 Shqipëria ngriti si institucion publik, jo-buxhetor Autoritetin e Aviacionit Civil (AAC). Detyra e tij është mbikëqyrja e veprimtarive të transportit ajror përmes vetë-financimit, që vilet nga tarifa e sigurisë, tarifa en route dhe nga licenca të operatorëve. Të ardhurat kryesore vijnë nga tarifa e sigurisë prej 4 eurosh, që paguan çdo pasagjer që udhëton jashtë vendit. Nga kjo, 1 euro i shkon AAC-së. Në vitin 2022 të ardhurat nga kjo tarifë ishin 1.95 milionë euro, ndërsa vitin e shkuar shuma arriti në 3.2 milionë euro. Rritja e numrit të pasagjerëve ka shtuar të ardhurat për AAC, duke i lejuar të krijojë fonde të mbartura në vlerën 780 mijë euro në fund të vitit 2022 dhe 1.7 milionë euro gjatë vitit të shkuar. Rritja e fitimit në shumën 1 milion euro për vitin 2023 nuk është transmetuar në rishikimin e tarifave, siç e sanksionon Kodi Ajror dhe Ligji për Autoritetin e Aviacionit Civil. Ky parim është nënvizuar edhe në pasqyrat financiare, të audituara nga grupi i ekspertëve kontabël në një letër drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. “Të ardhurat e realizuara, por të paspërndara në fund të vitit të parë, buxhetor mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave dhe të ardhurat e përcaktuara më pas derdhen në buxhetin e shtetit.” Të pyetur nga INA, zyrtarë të AAC thanë se tarifat en route janë ulur, nga 55.81 euro në vitin 2022, në 48.87 euro gjatë këtij viti, ndërsa ajo e sigurisë është vendosur të mbahet në fondin rezervë “për të kontrolluar rrezikun që vjen si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara, sikurse ishte rasti i COVID-19.”

AAC dyfishon të ardhurat, por edhe shpenzimet

Nëse dyfishimi i të ardhurave për Autoritetin e Aviacionit Civil, nga 3.1 milionë euro në vitin 2022, në 7.4 milionë euro për vitin që lamë pas, do të ulte tarifat për pasagjerët që udhëtojnë nga Shqipëria përmes dy aeroporteve, atij të Rinasit dhe atij të Kukësit, ndodhi e kundërta: agjencia vendosi që t'i shtojë shpenzimet, nga 2.8 milionë euro, që ishin më parë, në 6.4 milionë. Biletat e udhëtimeve, të cilat për vitin 2021 ishin 20 mijë euro, më pas u shtuan në 60 mijë euro në vitin 2022, për të kapur vlerën 100 mijë euro vitin e shkuar. Bashkë me shpenzimet për bileta, buxheti i AAC-së planifikoi që të finançojë edhe 45 mijë euro për dieta dhe hotele. Rritja e të ardhurave shërbeu gjithashtu që dhe Aviacioni Civil të niste rikonstruksionin e godinës, ku për punime rehabilituese, lyerje, mobilie, dyer, dritare, kondicionim dhe për vendosjen e një kuzhine ngrënieje janë shpenzuar 125 mijë euro. Autoriteti i Aviacionit Civil ka rritur me 56% edhe shpenzimet për 80 punonjësit e tij, nga 1.75 milionë euro në 3.08 milionë euro. Fondi i pagave në vitin 2023 u rrit në 2 milionë euro, nga 1.5 milionë që ishte në vitin 2022. Për vitin 2022 AAC nuk e dha fondin e shpërblimeve, që planifikoi në fillim të vitit, për të dhënë më pas një fond të dyfishuar gjatë vitit 2023, me vlerë 400 mijë euro. Punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil kanë të siguruar jetën dhe institucioni investon në fondin e pensionit privat, përveç sigurimeve shoqërore, që paguhen për skemën kombëtare. Në total këto dy zëra i kushtojnë Autoritetit 330 mijë euro në vit, ndërsa për trajnimin e tyre u shpenzuan 400 mijë euro të tjera. Për shtimin e shpenzimeve Aviacioni Civil tha për INA Median se kjo vjen si një detyrim i konventave ndërkombëtare, ku është pjesë. “Duke qenë anëtare e këtyre organizatave, Republika e Shqipërisë, nëpërmjet AAC-së, është subjekt auditimi nga këto organizata për të vlerësuar nivelin e implementimit të standardeve të tyre”.

■ Pushtetarët e lartë të korruptuar kërcënojnë SPAK

Si dështoi operacioni i SPAK me 19 fletë-arreste për inceneratorin e Tiranës, a u trembën prokurorët specialë nga emrat “VIP” të përfshirë në aferë?

Mbrëmjen e 25 qershorit, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar po përgatitej të bënte goditjen e madhe për dosjen e inceneratorit të Tiranës duke firmosur 19 masa sigurie. Në shënjestrën e SPAK bënin pjesë politikanë dhe njerëz të tjerë të rëndësishëm të medias, si edhe familjarë të tyre. Pra kishte masa për gazetarë, pronarë mediash por dhe ortakë të kompanisë së inceneratorëve, të Mirel Mërtirit dhe Klodian Zotos, po ashtu dhe për persona të tjerë publikë, por edhe të huaj. Gazeta “SOT” e raportoi pak ditë më parë se BKH u kontrolloi edhe shtëpitë e tyre. Por operacioni u bllokua dhe nuk pati finalizime. Vetë SPAK njoftoi dje në mëngjes (26 qershor), me shumë pak detaje se goditja nuk ka ndodhur gjatë natës. Por në reagimin e tyre për mediat theksohet se hetimet vijojnë. “SPAK po vijon një sërë hetimesh për të luftuar korrupsionin dhe mbrojtjen e publikut. Nuk ka pasur asnjë operacion brenda natës dhe ju kërkohet me mirësjellje të shmangin spekulimet që mund të dëmtojnë punën tonë. Në momentin që do të kemi njoftime për të ndarë me median padyshim do të viheni në dijeni”, thuhet në reagimin e SPAK. Por pse dështoi ky operacion? A ka patur dekonspirime, apo ndërhyrje nga pushtetarë të lartë? Fakti i sigurt është që kjo dosje, e cila përmban emra “peshash të rënda” është aq përvëluese sa po djeg dhe “duart” e prokurorëve specialë. Mjaftojmë të shohim emrat që kanë zbankuar në SPAK gjatë kësaj kohe. Është kupola e mazhorancës që ka dhënë llogari. Madje aty del dhe firma e kryeministrit Edi Rama. Presioni është shumë i madh. Këtë herë situata është më e nxehtë pasi është e përlyer edhe media. Ka



pagesa prej miliona eurosh në kompani ofshore.

Presionet ndaj SPAK

Nuk është vetëm dosja e inceneratorit të Tiranës që po alarmon politikën dhe median. Po shohim e dëgjojmë çdo ditë sulmet nga pushtetarët e lartë ndaj drejtësisë së re. Madje edhe policia që duhet të garantojë siguri, ka dekonspiruar shpesh operacionet e SPAK. Personat që kanë dosje shajnë dhe bëjnë presion hapur ndaj Altin Dumani dhe prokurorëve. Kemi Sali Berishën, Ilir Metën, Monika Kryemadhin dhe Flamur Nokën që vazhdojnë ditë-natë të sulmojnë drejtësinë për shkak të hetimeve. Ata flasin dhe me emra prokurorësh, të cilët i quajnë ushtarë të Ramës. Madje ka patur kërcënime dhe me jetë nga personazhe të botës së krimin për hetuesit e SPAK. Nga ana tjetër, institucionet ndërkombëtare kanë nisur një “fushatë” mbrojtjeje të institucioneve të reja të drejtësisë dhe veçanërisht Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Këtë fakt e tregoi dhe vizita e fundit në Tiranë e Koordinatorit për Anti-Korrupsionin Global në Departamentin Amerikan të Shtetit, Richard Nepheë, i cili shmangu çdo takim me politikën dhe

mbështeti fuqishëm SPAK. Nepheë, vendosi të shkonte personalisht brenda godinës së Prokurorisë së Posaçme. Aty ai pa dosje korrupsioni të përhapura në tokë, në dollapë, në sirtar dhe në tavolinë. Zyrtari i DASH nuk e fshehu habinë. Përveç Altin Dumanit, Nephew takoi dhe me Arben

Krajën, ish kreun e SPAK i cili ka në dorë dhe dosjen për aferën e privatizimit të ish kompleksit “Partizani”, për të cilën ish kryeministri Sali Berisha dhe dhëndri i tij, Jamarbër Maltezi

po hetohen për akuzën e korrupsionit. Ndërkohë Altin Dumani ka në dorë dosjen ndaj Ilir Metës lidhur me aferën “CEZ-DIA”. Pritshmëritë dhe mesazhi i koduar me dosjet, paralajmërojnë që në ditët, javët dhe muajt në vijim SPAK pritet të ndërmarrë veprime konkrete ndaj disa politikanëve ministrave dhe ish-ministrave që kanë abuzuar me fondet publike. Pamjet janë shoqëruar dhe me paralajmërimet e forta nga amerikanët. SHBA do të vazhdojnë të mbështesin SPAK derisa pushtetarët e paprekshëm që i kanë shpëtuar gjithë këto vite, të dënohen nga drejtësia.

“Nëshënjestrën e SPAK bënin pjesë politikanë dhe njerëz të tjerë të rëndësishëm të medias, si edhe familjarë të tyre. Pra kishte masa për gazetarë, pronarë mediash por dhe ortakë të kompanisë së inceneratorëve, të Mirel Mërtirit dhe Klodian Zotos, po ashtu dhe për persona të tjerë publikë, por edhe të huaj.”

Leje legalizimi për të votuar PS në 2019, ish kreu i Kadastrës Artan Lame 2 orë e gjysmë në SPAK: Isha si person në dijeni

■ Ish-drejtori i Kadastrës, Artan Lame u thirr dje në SPAK. Për dy orë e gjysmë, Lame u pyet si person që ka dijeni për një dosje që po heton SPAK për korrupsion zgjedhor në zgjedhjet vendore të 2019. Pasi doli nga SPAK, Lame nuk preferoi të flasë për mediat, ndërsa tha shkurt se “u pyeta si person në dijeni për një çështje të Kadastrës”. Lame e ka drejtuar Kadastrën nga viti 2019 deri në mars 2023. Burime për Shqiptarja.com bëjnë me dije se Lame është pyetur mbi një dosje të SPAK sa i takon legalizimeve në këmbim të votës për zgjedhjet lokale të vitit 2019. Për këtë çështje kanë rënë në pranga më 26 prill 2024, zyrtari i Kadastrës, Dritan Stoka dhe kryeplaku i Saukut në Tiranë, Agim Osmani. Të dy, gjatë kohës që Kadastra drejtohej nga Lame, kundrejt përfitimeve të paligjshme, kanë kërkuar votën për PS në këmbim të lejeve të legalizimit për ndërtime informale të votuesve në zonën e Saukut, Tiranë.

Tjetërsimi i pronave në Himarë, Apeli i Posaçëm rrëzon kërkesën e Jorgo Goros për lirim nga qelia

■ Gjykata e Posaçme rrëzoi dje kërkesën e ish-kryebashkiakut të Himarës Jorgo Goro për ndryshim mase sigurie. Jorgo Goro u arrestua me urdhër të SPAK në muajin mars të këtij viti, nën dyshimin se ka shpërdoruar detyrën, duke tjetërsuar dy prona në Dhërmi, ku përfitues fundor i këtyre pronave ishte Artan Gaçi, bashkëshorti i ish ministres Olta Xhaçka. Hetimet e SPAK treguan se Goro në bashkëpunim me Jerasimo Bushin, përcollën pranë organeve kompetente dokumenta të falsifikuara duke bërë të mundur regjistrimin e një sipërfaqe prej 5512 m2 tokë bujqësore, në pronësi të shtetit, në favor të subjektit privat, në pronësi të Foto Mëhillit, i ati i Stavri Mëhillit. Pas kësaj procedure, të dy ata kanë vijuar me transaksionet për të regjistruar sipërfaqen e tokës në emër të një shoqërie private me përfaqësues Artan Gaçin. Në total janë dy sipërfaqe toke të tjetërsuara, të dyja rreth 10 mijë metra katrorë. Lidhur me këtë çështje kreu i kadastrës Vlorë, Bilbil Aliaju u la në masën “detyrim paraqitje”, ndërsa ish juristi Vezir Gjikota si dhe ish drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Menaxhimit të tokës në Bashkinë Himarë në masën “arrest në shtëpi”. Nga ana tjetër, Stavri Mëhilli pronari i tokës, që dyshohet se ka kryer 2 vepra penale, është lënë në “arrest me burg”, në mungesë, për shkak se nuk është gjetur për t’u arrestuar.

N J O F T I M

Njoftohen aksionerët e shoqërisë “Përpunim Pesticide” SHA, se do të zhvillohet Mbledhja Asamblesë së Përgjithshme e shoqërisë më datë 19.07.2024, ora 11:00, në adresën: “Rruga e Elbasanit”, Vila Nr.71 (ish-Vila e MJAFT-it), Tiranë, me rend dite si më poshtë:

- Diskutimi dhe miratimi i Pasqyrave Financiare për periudhën ushtrimore 01.01.2023 – 31.12.2023 të shoqërisë “Përpunim Pesticide” sha;
- Diskutimi dhe emërimi i audituesve ligjor Z. Ilia Çeçe dhe Znj. Fatime Alliu për të kryer auditimin dhe për të hartuar Raportin e Pasqyrave Financiare të vitit 2023 të shoqërisë “Përpunim Pesticide” sha;

Administratori
Juglerd IBRAHIMI

Rritja e pagës hyn në fuqi nga 1 korriku

Nga mësuesit, te mjekët, infermierët, ushtarakët, zjarrfikësit dhe policët e burgjeve, miratohet rritja e pagave, ja nivelet e reja të rrogave dhe të gjitha kategoritë e administratës me 135 mijë punonjës që përfitojnë

Xhoana VRANIÇI

Punonjësit e sektorit publik përfitojnë një tjetër rritje page. Vendimi u miratua dje në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Rritja e pagës, që hyn në fuqi nga 1 korriku, do të jetë për 135 mijë punonjës të administratës shtetërore, konkretisht punonjësit e sistemit arsimor parauniversitar, punonjësit e sistemit shëndetësor, punonjësit e sistemit të sigurisë së vendit (Policia e Shtetit, Policia e Burgjeve, Garda e Republikës, Forcat e Armatosura, Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi) si edhe punonjësit e nivelit zbatues dhe mbështetës të administratës shtetërore. Ministri i Financave, Ervin Mete, në komunikimin me mediat pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave tha se me zbatimin e kësaj politike paga mesatare në sektorin publik synohet të arrijë në 105 mijë Lekë. "Pagat e rritura fillojnë të aplikohen në 6 mujorin e dytë të vitit, pra duke filluar nga 1 korriku, me një kosto të përlogaritur prej afro 11 miliardë lekësh për këtë 6 mujor të dytë të vitit dhe me një kosto totale buxhetore prej afro 40 miliardë lekësh", deklaroi ai. Po ashtu, ministri Mete informoi se, me ndryshimet ligjore të miratuara, parashikohet të realizohet indeksimi i të gjitha pagave në administratën publike me normën e inflacionit në fuqi, indeksim që do të realizohet në vazhdimësi çdo dy vjet, duke filluar nga viti 2026. Më poshtë është lista e



sektorëve që përfitojnë nga rritja e pagave dhe sa shkon ajo:

Ushtria

-Për ushtarin bazë, me rritjen e sotme paga e tij shkon në 71 mijë Lekë
-Rreshteri, 80 mijë Lekë
-Majori, 107 mijë Lekë
-Koloneli, 158 mijë e 500 Lekë
-Gjenerali, 190 mijë Lekë.
-Të gjitha këtyre pagave u shtohet një trajtim ushqimor, prej 16 mijë Lekësh

Zjarrfikësit

-Asistent Zjarri (grada më e ulët) 60 mijë Lekë
-Zjarrfikës 65 mijë Lekë
-Kryezjarrfikës 70 mijë Lekë
-Kryeinspektor zjarrfikës 85 mijë Lekë
-Inspektor zjarrfikës 75 mijë Lekë
-Komisar zjarrfikës 105 mijë Lekë
-Drejtues zjarrfikës 155 mijë Lekë
-Drejtues i parë zjarrfikës 140 mijë Lekë

-Drejtues i lartë zjarrfikës 160 mijë Lekë

Sistemi arsimor

-Paga e mësuesit në arsimin e mesëm të lartë që ka kualifikimin dhe që ka vjetërsi mbi 15 vite pune eksperiencë do shkojë 98 500 Lekë.
-Paga mesatare e mësuesit në arsimin e mesëm të ulët me mbi 15 vite vjetërsi shkon nga 75 800 në 96 000 Lekë.
-Mësuesit e ciklit fillor me mbi 15 vite eksperiencë nga 72 mijë Lekë paga shkon në 95 200

Lekë.

-Punonjësit e shërbimit psiko-social, paga mesatare shkon 910 Euro.

-Për oficerët e sigurisë 800 Euro në muaj si pagë mesatare.

Sistemi shëndetësor

-Të gjithë mjekëve të përgjithshëm u rritet paga me 20 mijë Lekë mbi pagën ekzistuese.
-Të gjithë infermierëve u rritet paga me 15 mijë Lekë mbi pagën ekzistuese.
-Përfitojnë edhe punonjësit e administratës së sistemit shëndetësor, 15 deri në 20 përqind të pagës së tyre aktuale.

Sektori i burgjeve

-Rritja e pagave varion nga 13 deri në 27 përqind.
-Rritja shkon nga 6 mijë Lekë, deri në 33 mijë e 600 Lekë e përshkallëzuar sipas gradave.
-Aspirantët, pjesë e strukturës së Policisë së Burgjeve dhe do paguhet me 80 përqind të pagave të inspektorit.

Mete: Indeksim çdo dy vjet i pagave në administratë me normën e inflacionit në fuqi

Ministri i Financave, Ervin Mete deklaroi dje pas mbledhjes së qeverisë se duke filluar nga viti 2026 do të ketë indeksim të pagave në masën e inflacionit. Në një deklaratë për mediet pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave ministri informoi se me ndryshimet ligjore të miratuara, parashikohet të realizohet indeksimi i të gjitha pagave në administratën publike me normën e inflacionit në fuqi. "Ky indeksim do të realizohet në vazhdimësi çdo dy vjet, duke filluar nga viti 2026", deklaroi Mete.

Manja: Rritje e pagave të Policisë së Burgjeve nga 13-27 %, përfitojnë 3430 punonjës

Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja deklaroi dje për mediat pas mbledhjes së qeverisë se pagat në sektorin e burgjeve do të kenë një rritje që shkon nga 13-27 % dhe se përfitues do të jenë 3430 punonjës. "Nga politika për rritje page ka përfituar edhe sektori i burgjeve ku përfshihen Policia e Burgjeve, stafet mjekësore dhe ato civile. Nga kjo rritje do të përfitojnë 3430 punonjës të policisë së burgjeve. Rritja e pagave varion nga 13-27 % mesatarisht 15.12 %", deklaroi ai, në një prononcim për mediat pas mbledhjes së qeverisë. Sipas Manjës, nga vendimi i sotëm i qeverisë përfitues janë edhe kandidatët për t'u bërë pjesë e policisë së burgjeve, të cilët do të bëhen pjesë e strukturës dhe organikës dhe do të paguhet nga data 1 korrik me 80 % të pagës së inspektorit. "Rritja prej 15.12 % mesatarisht përfshin vetëm njërin nga elementët e pagës, atë bruto, pasi vendimi parashikon rritje tek të gjithë elementët e tjerë të pagës si vjetërsia, shtesa për natyrë të veçantë të punës dhe kompensimin e normës ushqimore. Kjo rritje në vlerë e pagës bruto do të variojë nga 6 mijë në 33 mijë e 600 lekë. Kjo nuk do të jetë rritja e fundit e pagave", tha ai.

Nga Emergjencat, te Teatri Kombëtar, ja punonjësit që përfitojnë rritje page

Këshilli i Ministrave miratoi dje një ndryshim të vendimit "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike". Sipas këtij vendimi për natyrë të veçantë pune disa kategorive do t'u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse. Nga ky vendim do të përfitojnë: punonjësit e sektorit të teknikës së shtypshkrimit në Qendrën e Botimeve Zyrtare, në masën 14 000 lekë në muaj; punonjësit shpëtuës të sektorit të emergjencave dhe shpëtim të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në masën 9 000 lekë në muaj; punonjësit e Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në masën 9 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionin "shofer-mekanik" në Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit, në masën 9 000 lekë në muaj. Po ashtu do të përfitojnë edhe punonjësit, të cilët punojnë në shërbimet e shëndetit mendor e që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientët me probleme të shëndetit mendor, në masën 9 000 lekë në muaj. Ministri përgjegjës për çështjet e shëndetësisë përcaktonte vendet e

punës, që përfitojnë këtë shtesë me miratimin e strukturave të institucioneve shëndetësore përkatëse. Nga vendimi përfitojnë po ashtu punonjësit, të cilët punojnë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me të dënuarit, në masën 9 000 lekë në muaj. Kjo shtesë aplikohet pas miratimit të strukturave të institucioneve të ekzekutimit të veprave penale përkatëse, sipas propozimit të ministrit përgjegjës për çështjet e drejtësisë. Po ashtu nga vendimi do të përfitojnë: punonjësit në pozicionin "shofer" në urgjencë e spitaleve, në masën 14 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionin "rojë mjedisore" në administratat e zonave të mbrojtura, në masën 8 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionin "përgjegjës (shërbimi i ushqimit dhe restorantit)", "kuzhinier", "administrues hoteli" dhe "ndihmëskuzhinier" në Shtëpinë e Pushimit të Ministrisë së Brendshme, Durrës, në masën 9 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionet "laborant" dhe "teknik i mesëm aparaturash" në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, në masën 19 000 lekë në muaj. Ndërsa punonjësit në pozicionin

"punëtor mirëmbajtjeje (krematoriumi)" në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë do të përfitojnë në masën 14 000 lekë në muaj. Po ashtu vendimi parashikon që punonjësit në pozicionet "mjeshër ndriçimi/fonie" dhe "mjeshër rrobaqepës" në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor përfitojnë në masën 24 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionet "mjeshër skene", "mjeshër parukier-grimier", "mjeshër garderobier", "mjeshër marangoz", "mjeshër këpucar", "ndihmësmjeshër grimier", "mjeshër dekorori", "mjeshër rekuizite" "ndihmësmjeshër rrobaqepës", "ndihmësmjeshër rekuizitier", "ndihmësmjeshër dekorator", "ndihmësmjeshër këpucar", "ndihmësmjeshër marangoz", "ndihmësmjeshër i mekanikës skenike", "ndihmësmjeshër parukier-grimier" dhe "ndihmësmjeshër gardërobier", në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, në masën 14 000 lekë në muaj. Ndërsa punonjësit në pozicionet "mjeshër ndriçimi/fonie" në Teatrin Kombëtar, do të përfitojnë në masën 24 000 lekë në muaj; punonjësit në pozicionet "mjeshër skene", "mjeshër parukier-grimier", "mjeshër garderobier", "mjeshër

marangoz", "mjeshër këpucar", "mjeshër dekorori", "mjeshër rekuizite" "ndihmësmjeshër grimier", "ndihmësmjeshër ndriçimi/fonie", "ndihmësmjeshër rekuizitier", "ndihmësmjeshër dekorator", "ndihmësmjeshër këpucar", "ndihmësmjeshër marangoz", "ndihmësmjeshër i mekanikës skenike", në Teatrin Kombëtar, në masën 14 000 lekë në muaj. Vendimi parashikon që punonjësit në pozicionin "magaziner", në Kryeministri, përfitojnë në masën 23 000 lekë në muaj; punonjësit e tjerë mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës dhe në institucionet e pavarura në nivel qendror, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, në masën 8 000 lekë në muaj; punonjësit mbështetës dhe punonjësit e tjerë të specialiteteve të ndryshme, pjesë e fushës së veprimit të këtij vendimi, në masën 4 000 lekë në muaj. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2024, përballohen nga buxheti i miratuar dhe fondi i kontingjencës për rritjen e pagave. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i shtrihet efektet nga data 1 korrik 2024.

Ministrja Denaj: Mbështesim sipërmarrjen e të rinjve që ruajnë trashëgiminë familjare

Të rinjtë po orientohen gjithnjë e më shumë drejt aktivitetit në agroturizëm, si segment i rëndësishëm i turizmit, që ka marrë një rritje të shpejtë vitet e fundit. Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj solli shembullin e një kantine në Kopluk, ku kultivohen vreshta e prodhohet verë cilësore. Luan Hysa nga Kopluku, kujdeset për kantinën familjare të ngritur që në vitin 2004, ku kultivon vreshta për prodhimin e verërave të ndryshme që ofrohen si shërbim degustimi që vizitorët vendas e të huaj

të kenë një eksperiencë unike dhe sa më pranë produkteve Made in Albania. "Agroturizëm Kantina Kopluku ofron dhe një eksperiencë agroturizmi autentike, ku prodhojnë 90% të produkteve që ofrojnë si mishi, djathi etj", tha Denaj. "Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mbështet të rinjtë e angazhuar në sipërmarrje të tilla që ruajnë trashëgiminë familjare duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit bujqësor dhe rritjen e rendimentit në këtë sektor", u shpreh ministrja.

Denaj: Kredi me zero interes për 30 punonjës të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se 30 punonjës të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioneve të varësisë do të përfitojnë kredi me interes zero për blerje banese. Denaj e cilësoi një hap pozitiv për mbështetjen e profesionistëve të bujqësisë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së punonjësve. Sipas Denajt, kredia u siguron atyre mundësinë për të jetuar në kushte më të

mira dhe më të sigurta, pa u shpenzuar për interesat e kredisë për banesën e tyre. Ministrja siguroi se përfituesit do të përzgjidhen sipas kritereve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Këtë vit 300 punonjës të administratës publike do të përfitojnë kredi me 0% interes për blerjen e një banese. Vëmendje të veçantë do të kenë arsimtarët, mjekët, infermierët, policët, ushtarakët, gardistët, veterinerët, artistët, etj.

rajon

Takimi në Bruksel, Borrell dhe Lajçak dështojnë të ulin Kurtin dhe Vuçiç në tavolinën e dialogut

Ka dështuar tentativa e Bashkimit Evropian për të ulur në takim të përbashkët, kryeministrin e Kosovës Albin Kurti dhe presidentin serb Aleksandër Vuçiç! Pas përfundimit të raundit të parë të takimeve dypalëshe, ishte paralajmëruar mbajtja e një takimi të përbashkët mes kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiç, por një takim i tillë nuk u zhvillua. Paraprakisht, përfaqësuesi i

lartë për politikë të jashtme dhe siguri të Bashkimit Evropian, Josep Borrell dhe i dërguari i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, kanë takuar veçmas Kurtin dhe më pas Vuçiçin. Në pamundësi për t'i ulur në tavolinën e bisedimeve, Lajçak dhe Borrell kanë nisur raundin e dytë të takimeve bilaterale me Kurtin dhe Vuçiçin. Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, tha për mediat në Bruksel se gjatë rundit të dialogut të

nivelit të lartë, ai nuk është takuar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, pavarësisht se një takim i tillë ishte paralajmëruar nga Bashkimi Evropian. "Nuk ka pasur takim me Kurtin sepse Kurti nuk ka dashur apo nuk ka guxuar, pyeteni atë të më takoj dhe të bisedojmë. Besoj se do të mësoni më shumë për këtë nga evropianët", tha presidenti serb gjatë një deklarimi për mediat. Ai shtoi se është kthyer tri herë në

takimin me Borrell dhe Lajçak, të cilët ia kanë përcjellë mesazhet e Kurtit, të cilave ai i është përgjigjur. Ai e vlerësoi korrekt takimin me ndërmjetësit evropianë. Vuçiç tha se gjatë takimeve dypalëshe është folur për gjithçka që ka të bëjë me Kosovën dhe zbatimin e marrëveshjeve, teksa i ka konsideruar "të suksesshme" takimet në Bruksel. Ai shtoi se kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë do të vazhdojnë bisedimet javën e ardhshme.

Orban prezanton prioritetet

Hungaria merr "frenat" e BE, Serbia përgatitet për një "epokë e artë", ndryshime të mëdha priten gjatë presidencës gjashtëmujore, ja çfarë fshihet mes lidhjeve të ngushta të Beogradit me Budapestin

Marsela SHYTIA

Nga 1 korriku deri më 31 dhjetor, Hungaria do të mbajë presidencën e rradhës të Këshillit të Bashkimit Evropian, përpara se cilës deklaroi se zgjerimi i BE-së në Ballkanin Perëndimor do të jetë një prioritet i madh i politikës. Megjithatë, me gjasë, ndikimi i agjendës së premtuar të Budapestit në qendër të zgjerimit do të kufizohet shumë jo vetëm nga pasojat administrative të zgjedhjeve të qershorit për BE - një periudhë tranzicioni institucional që mund të zgjasë deri në fund të vitit - por veçanërisht nga rezistenca politike e një shumice dërrmuese të shteteve anëtare që e shohin këtë presidencë me skepticizëm dhe shqetësim. Megjithatë, gjashtë muajt e Hungarisë në krye të Këshillit të BE-së së paku do të sjellin ende në plan të parë çështjen e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, për të cilën ajo do të mbështetet strategjikisht në strukturat e saj të edukuara mirë të pozicionimit diplomatik në Rajon.

Presidencë e Hungarisë

Në këtë kontekst, gjatë presidencës së BE-së, e cila fillon më 1 korrik, Hungaria do të hapë kapituj të rinj në negociatat e pranimit me Serbinë dhe do të zhvillojë negociata ndërqeveritare me të pesë kandidatët për anëtarësim nga Ballkani Perën-



dimor, tha të mërkurën në Paris kreu i diplomacisë hungareze Peter Szijjarto. Duke folur në konferencën e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Szijjarto tha se Hungaria, për të përshpejtuar zgjerimin e BE-së në Ballkanin Perëndimor, planifikon gjithashtu të mbyllë të paktën shtatë kapituj në negociatat me Malin e Zi. Ai planifikon gjithashtu të hapë kapitujt e parë me Shqipërinë dhe të miratojë kuadrin e negociatave me BiH, që është hapi i parë drejt hapjes së negociatave. Hungaria do të përpiqet të nisë "negociatat konkrete me qeverinë e re, fuqimisht pro-integruese të Maqedonisë së Veriut", tha ai. "Integrimi i këtyre vendeve në BE është një interes ekonomik, por edhe politik dhe i sigurisë i Hungarisë", tha ai.

Integrimi i Ballkanit

Investimet hungareze në

rajon kanë arritur në 2.5 miliardë euro dhe tregtia është katërfishuar në më shumë se 7 miliardë euro që nga viti 2010", tha ai. Hungaria po ndihmon gjithashtu duke dërguar ekspertë dhe zyrtarë të trajnimit për t'i ndihmuar ata të lundrojnë në procesin e ndërlikuar të pranimit, tha ai. Szijjarto tha se Evropa Qendrore dhe Ballkani Perëndimor mund të jenë një urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit, e cila është shumë e nevojshme për kthimin e bashkëpunimit Lindje-Perëndim të bazuar në respektin reciprok dhe mund të tregojë rrugën e daljes nga periudha aktuale e trazuar e krizës. Hungaria është e gatshme të marrë këtë rol dhe të mbështesë vendet e Ballkanit Perëndimor në këtë, tha ministri i Jashtëm hungarez.

Lidhjet me Orban

Në mesin e partnerëve dhe miqve të mëdhenj serbë në botë,

kohët e fundit, sipas anëtarëve të qeverisë, Hungaria është spikatur si një nga më të mëdhenjtë dhe miqësia mes Viktor Orban dhe Aleksandër Vuçiç vihet në plan të parë si çelësi i marrëdhënieve të mira mes dy vendet. SAleksandër Ivkoviç, gazetar i portalit European Western Balkans, thekson se ajo që po dëshmojmë vitet e fundit është në fakt afrimi i dy liderëve që kanë interesa të përbashkëta dhe se nuk ka të bëjë aq shumë me marrëdhëniet dypalëshe mes dy vendeve. Ai thekson se arsyeja për këtë është se politikë që ata udhëheqin i largojnë ata nga Evropa dhe ata e përdorin njëra-tjetër për hir të legjitimitetit si ndërkombëtarisht ashtu edhe brenda vendit. "Të dy përpiqen të ruajnë një hapësirë të caktuar manovrimi në politikën e jashtme, lidhje më të ngushta me Rusinë dhe Kinën, por jo aq të afërta sa të kërcënojnë ndjeshëm marrëdhëniet me Perëndimin, si dhe të amortizojnë kritikën që vijnë në kurriz të rrugës së tyre. të qeverisjes, kryesisht nga Brukseli. Meqenëse të dyja këto synime kërcënojnë t'i distancojnë politikisht nga kryeqytetet e tjera në Evropë, Orban dhe Vuçiç shërbejnë për legjitimitimin reciprok të njëri-tjetrit si ndërkombëtarisht ashtu edhe brenda vendit", thotë bashkëbiseduesi ynë.

Partitë kryesore spanjolle, kundër njohjes së Kosovës

Propozimi për ta futur në rend dite njohjen e Kosovës u bë nga partia seperatiste katalonjase "Junta". Deputeti i kësaj partie, Eduard Pujol Bonell, duke shpjeguar propozimin, ka thënë se Kosova është "shtet ligjor", pavarësia e së cilës është njohur edhe nga Haga. Carlos Flores Juberias nga partia VOX kundërshtoi ashpër njohjen e Kosovës, duke thënë se ka shumë arsye. Sipas tij, qëndrimi i Spanjës respektohet nga vendet e tjera dhe askush nuk po e detyron Spanjën ta njohë Kosovën. "Në kontekstin ndërkombëtar, gjysma e Kombeve të Bashkuara e ka njohur Kosovën, gjysma tjetër jo. Meqë ra fjala, a e dini sa vende të reja kanë njohur Pavarësinë e Kosovës në 10 vjetët e fundit? Do t'i emërtoj Tonga, Antigua dhe Barbuda, Singapori, Surinami, Bangladeshi dhe Barbados. Sa prej tyre mund t'i gjeni në hartë?", ka thënë Juberias. Si një nga arsyet për mosnjohjen e Kosovës, Juberias përmendi të drejtën ndërkombëtare dhe kujtoi rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. "Dhe asnjë rezolutë e mëvonshme, aq më pak rezoluta mashtruese e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e 22 korrikut 2010, nuk çon në të kundërtën", ka thënë deputeti i VOX-it, parti e ekstremit të djathtë.

Ministri kroat: Mbështetja jonë për Kosovën, njëqind përqind

Zëvendëskryeministri dhe ministri kroat i Mbrojtjes, Ivan Anušić e ka pritur dje në Zagreb ministrin kosovar të Mbrojtjes, Ejup Maqedonci. Ata diskutuan për bashkëpunimin dypalësh të mbrojtjes, situatën e sigurisë në Europën Juglindore dhe sfidat globale të sigurisë, raporton televizioni publik kroat, HRT. "Vazhdimi i mëturshëm i politikës sonë është përkrahje e plotë, mbështetje qind për qind për Kosovën në integrimet evropiano-atlantike, hyrjen e Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO", tha Anušić. "Rrënjët e miqësisë sonë shkojnë shumë larg. Ne ngrihem për gjithçka që nevojitet veçanërisht kur bëhet fjalë për vlerat universale njerëzore", tha ndërkaq Maqedonci. Në konferencën e përbashkët për media pas takimit, Anushiq foli për bashkëpunim ushtarak, politik e ekonomik me Kosovën, ndërsa njoftoi se me Maqedoncin nënshkruan një marrëveshje për trajnimin e kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Kolegjin Ushtarak "Dr. Franjo Tuxhman", duke shtuar se kjo "nuk është asgjë e re". "Mund të theksojmë se deri sot 70 pjesëtarë të Forcave të Sigurisë së Kosovës kanë përfunduar studimet pasuniversitare në Akademinë Ushtrake Kroate", tha Anushiq.

b o t ë

Rikthehet “makthi bërthamor”, të dhëna tronditëse vijnë nga Zaporizhzhia, ja çfarë po ndodh në termocentralin më të madh në Evropë

Ofensiva ruse në Ukrainë vazhdon pa ndërprerje. Dje herët në mëngjes, jehona të frikshme mbërritën nga Zaporizhzhia, ku ndodhet termocentrali bërthamor i pushtuar nga forcat ruse. Sipas raporteve nga Tass, një agjenci e Moskës, një sulm ajror nga forcat e Kievit shkatërroi stacionin e kontrollit të rrezatimit Zaporizhzhia (Znpp). “Stacioni i kontrollit të rrezatimit në Velikaya Znamenka u shkatërrua plotë-

sisht pas një sulmi të artilerisë ukrainase,” shkruhej në një mesazh të Znpp të postuar në Telegram. Stacioni Velikaya Znamenka ndodhet afërsisht 27 km në perëndim të termocentralit Zaporizhzhia, në fshatin Velyka Znamyanka. Lajmi u konfirmua më pas edhe nga kanali Telegram i menaxhimit rus të centralit bërthamor. “Specialistët – thonë njerëzit e Vladimir Putinit – të termocentralit bërthamor kanë kryer

një sërë masash kompensuese për të vendosur situatën e rrezatimit në zonën e centralit”, lexojmë në mesazh. Shkalla e rrezatimit thuhet se nuk i kalon nivelet e kërkuara me ligj. Por, për arsye të dukshme, frika nga një aksident bërthamor po rritet. Objekti i projektuar nga sovjetikët është më i madhi në Evropë dhe ndër 10 më të mëdhenjtë në botë, dhe përdoret për të gjeneruar gjysmën e fuqisë bërthamore të Ukrainës

para luftës. Impianti ka një kapacitet total prej rreth 6,000 megavat, i mjaftueshëm për rreth katër milionë shtëpi. Në rast të një rrjedhje rrezatimi ose një shpërthimi, i gjithë kontinenti evropian mund të kontaminohet, thanë së fundmi ekspertët për Al Jazeera. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelenskyy, ka akuzuar Rusinë për përdorimin e termocentralit në Zaporizhzhia për të nisur terrorin bërthamor.

Zbarkoi në Australi

Merr fund saga ligjore 14-vjeçare, Julian Assange lirohet nga burgu, si u kthye themeluesi i Wikileaks nga tradhtar në hero, ja historia e pabesueshme e njeriut që tronditi SHBA-në me zbulimin e sekreteve

Marsela SHYTIA

Për mbështetësit e tij, Julian Assange është një hero i së vërtetës. Për kritikët e tij, ai është një kërkues publiciteti që ka vënë jetë në rrezik duke vendosur një masë informacioni delikat në domenin publik. Fakti është se ata që kanë punuar me të e cilësojnë atë si “intensiv, të motivuar dhe shumë inteligjent, me një aftësi të jashtëzakonshme për të deshifruar kodet kompjuterike”, nënvizon “BBC”. I lindur në vitin 1971 në Townsville, në shtetin australian të Queensland, baba vetëm në moshën 18-vjeçare, Assange filloi të interesohej për kompjuterët që në moshë të re, duke shfrytëzuar potencialin e tij në matematikë. Në fillim të viteve 1990 ai konsiderohej si një nga hakerët më ekspertë australianë, siç kujton “The Guardian”, dhe në vitin 1995 Assange u akuzua, së bashku me një mik, për dhjetëra aktivitete hakerimi, thekson “BBC”. Ai u gjobit me disa mijëra dollarë australianë dhe arriti të shpëtojë nga burgu vetëm me kushtin që të mos kryente sërish veprë penale.

Jeta e Assange

Më pas ai vendosi të hynte në botën akademike, duke shkruar një libër që ishte bestseller në anën e shfaqur dhe subversive të internetit, përpara se të studionte fizikën dhe matematikën. Në vitin 2006, ai themeloi WikiLeaks, një organizatë që publikonte mate-



riale të zbuluara. “Për të mbajtur burimet tona të sigurta, ne duhej të angazhonim burime, të kodonim gjithçka dhe të lëvizim telekomunikacionet dhe njerëzit në mbarë botën për të aktivizuar ligjet mbrojtëse në juridiksione të ndryshme kombëtare,” shpjegoi ai për BBC. Në vitin 2010, Assange arriti një rëndësi globale pasi publikoi një seri të dhënash të Chelsea Manning, një ish-ushtar i Ushtrisë Amerikane transgjimore. Midis dosjeve ishte një video e një sulmi me helikopter Apache të vitit 2007 nga forcat amerikane në Bagdad që vrau 11 persona, duke përfshirë dy gazetarë të Reuters. Qeveria e SHBA-së nisi një hetim penal dhe Manning përfundimisht u dënua dhe u burgos për rrjedhjet, megjithëse dënimi i saj u zbut më vonë.

Nga tradhtar në hero

Në vitin 2016, Assange u bë sërish tituj pasi WikiLeaks pub-

likoi emaile nga operativët e Partisë Demokratike përpara zgjedhjeve presidenciale në SHBA. Prokurorët amerikanë thanë se emailet ishin vjedhur nga inteligjenca ruse dhe ishin pjesë e një operacioni për të ndërhyrë në zgjedhje në emër të Donald Trump. Assange është përshëndetur nga shumë në mbarë botën si një hero që nxori në dritë keqbërjet e ushtrisë amerikane në Irak dhe Afganistan, por reputacioni i tij është dëmtuar gjithashtu nga akuzat për përdhunim dhe sulme seksuale nga Suedia. Veçanërisht, autoritetet suedeze filluan ta persekutonin atë për përdhunimin e dyshuar të një gruaje dhe sulmin seksual të një tjetri në gusht të vitit 2010.

Fundi i sagës ligjore

Ardhja e Assange shënon fundin e një sage që e pa atë të kalojë më shumë se pesë vjet në

një burg britanik dhe shtatë vjet në azil në ambasadën e Ekuadorit në Londër, ku ai kundërshtoi ekstradimin në Suedi mbi akuzat për sulme seksuale dhe ekstradim në Shtetet e Bashkuara. ku është kërcënuar me 18 kallëzime penale. Ndërsa qeveria amerikane e konsideron Assange të pamatur për kërcënimin e agjentëve të saj, mbështetësit e përshëndesin atë si një hero për promovimin e fjalës së lirë dhe ekspozimin e krimeve të luftës. “Ne besojmë me vendosmëri se Assange nuk duhet të ishte akuzuar kurrë në bazë të Aktit të Spiunazhit për shkak të detyrave që gazetarët kryejnë çdo ditë,” tha avokati i tij Barry Pollack.

Zgjedhja e Australisë

Territori amerikan në Paqësorin Perëndimor u zgjodh për shkak të kundërshtimit të Assange për të shkuar në kontinentin e SHBA dhe për shkak të afërsisë së territorit me Australinë, thanë prokurorët. Politikanët në Australi që kërkuan lirim të tij shprehën shqetësimin për pranimin e fajësisë në tokën amerikane, duke thënë se Assange ishte një gazetar që u dënua për kryerjen e detyrës së tij. “Është një precedent vërtet alarmues. Është diçka që do të prisnim në një vend autoritar apo totalitar,” tha Andrew Wilkie, deputet i pavarur dhe udhëheqës i grupit parlamentar që mbrojti Assange.

Rusia dhe Ukraina këmbëjnë sërish të burgosur

Ukraina dhe Rusia kanë këmbëyer 90 të burgosur të luftës, thanë zyrtarët dje. Ky është këmbimi më i madh mes dy shteteve në pothuajse pesë muaj. Moska dhe Kiev kanë kryer mbi 50 këmbime të të burgosurve që kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës mbi dy vjet më parë, pavarësisht armiqësive që po vazhdojnë. Emiratet e Bashkuara Arabe kanë ndërmjetësuar marrëveshjen e fundit për këmbimin e të burgosurve. “Sot, 90 qytetarë tjerë tanë janë kthyer në shtëpitë e tyre nga robërimi rus”, tha presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, përmes një postimi në rrjetet sociale. “Ne nuk i harrojmë të gjithë njerëzit tanë që janë nën robërimin rus. Ne vazhdojmë të punojmë për lirin e secilit prej tyre”, shtoi ai. Rusia tha se 90 ushtarët e saj “që ishin në robëri, janë kthyer nga territori që kontrollohet nga regjimi i Kievit”. Të burgosurit e liruar rusë më pas do të dërgohen në Moskë “për trajtim dhe rehabilitim”, tha Ministria ruse e Mbrojtjes. Në këmbimin e fundit, që ndodhi në fund të majit, Moska dhe Kiev këmbëyen 75 të burgosur. Edhe ai këmbim u realizua me ndërmjetësimin e Emirateve të Bashkuara Arabe. Ndërkaq, në muajin shkurt të dyja palët thanë se kanë këmbëyer 100 të burgosur.

Sulmet në kisha dhe sinagoga në Rusi, identifikohen autorët

Një luftëtar i arteve marciale dhe të afërm të një zyrtari racional janë dy prej autorëve të identifikuar, pasi ishin në grupin e personave që kryen sulme në kisha dhe sinagoga në Dagestan të Rusisë të dielën. Agjencia shtetërore ruse e lajmeve TASS, duke cituar agjencitë e zbatimit të ligjit, raportoi se pesë nga sulmuesit që shënjestruan qytetet Derbent dhe Makhachkala ishin identifikuar. Persona të armatosur hapën zjarr në disa vende adhurimi dhe një ndalesë trafiku policor në dy qytetet në republikën me shumicë myslimane, duke vrarë të paktën 15 oficerë policie dhe të paktën 4 civilë, duke përfshirë një prift ortodoks. Disa nga sulmuesit ishin nga rrethi Sergokalinsky, i cili shtrihet midis dy qyteteve, dhe kishin lidhje me kreun e distriktit, raportoi TASS. Ish-luftëtar i arteve marciale të përziera Gadzhimurad Kagirow, rezultoi se ishte kushëri i kreut të komunës Sergokalinsky Magomed Omarov, dhe ishte në mesin e atyre që sulmuan vendet në Derbent. Një djalë dhe një nip i Omarov ishin gjithashtu në mesin e autorëve. Kreu i Dagestanit, Sergei Melikov, u tha gazetarëve se Omarov që atëherë ishte liruar nga postia e tij dhe ishte përjashtuar nga partia Rusia e Bashkuar.

b o t ë

www.sot.com.al

Izraeli nuk "i bindet" Amerikës, nis sulmet në Liban, ja pse lëvizja mund të jetë katastrofike

Luftëtarët e Forcave Ajrore izraelite goditën disa infrastrukturë ushtarake të Hezbollahit në zonat Matmoura dhe Chebaa të Libanit gjatë natës së djeshme. Kjo është bërë e ditur nga IDF. Tensionet përgjatë kufirit izraelito-libanez, shtimi i ndihmave humanitare për Gazën, Iranin dhe milicite e mbështetur nga Teherani. Këto ishin temat e diskutimit në takimin në Pentagon mes sekretarit amerikan të Mbrojtjes

Lloyd Austin dhe ministrit izraelit të Mbrojtjes Yoav Gallant. Siç raporton Pentagoni, Austin përsëriti "angazhimin e hekurt" të Shteteve të Bashkuara ndaj Izraelit dhe nënvizoi se "provokimet e Hezbollahit libanez kërcënojnë të tërheqin popullin izraelit dhe libanez në një luftë që asnjëri nuk e dëshiron". Një konflikt i këtij lloji, tha shefi i Pentagonit, "do të ishte katastrofik për Libanin dhe shkatërrues për civilët e pa-

fajshëm izraelitë dhe libanezë". Austin më pas nënvizoi prioritetin e garantimit të lirimt të sigurt të të gjithë pengjeve të Hamasit, ai përgëzoi Gallant për mbështetjen e Izraelit për armëpushimin dhe lirin e pengjeve të përshkuara nga Presidenti Biden dhe të miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së. Austin dhe Gallant "ranë dakord se i takon Hamasit të pranojë marrëveshjen". Austin i kërkoi gjithashtu Gallantit

të "dyfishojë përpjekjet për të mbrojtur civilët palestinezë dhe punëtorët humanitarë në Gaza" dhe diskutoi me ministrin izraelit se si të përmirësohet shpërndarjen e ndihmave humanitare për civilët palestinezë në nevojë të dëshpëruar dhe për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes për punonjësit humanitarë. Edhe BE ka paralajmëruar disa here se sulmet e reja në Liban vetëm sa do të përshkallëzonin situatën.

Ja vijat e kuqe

Tensionet kapin majën, SHBA i dha leje Ukrainës të përdorte armët e saj, Rusia aktivizon planin e hakmarrjes, shkatërron raketa-hedhësit amerikanë, ja vendimi i Biden që e nxori situatën jashtë kontrollit

Marsela SHYTIA

Tensionet është shumë i lartë mes Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara për furnizimet me armë në Ukrainë, ndërkohë që është ndezur edhe rasti i gazetarit të Wall Street Journal në gjyq në Moskë. Ushtria ruse njoftoi se kishte shkatërruar tre raketa-hedhës të shumëfishtë Himars të prodhimit amerikan dhe "specialistët e huaj" që i operuan ato. Kjo është bërë e ditur nga Ministria ruse e Mbrojtjes, siç raporton Tass. "Aviacioni operativ-taktik, mjetet ajrore pa pilot, trupat raketore dhe artileria e grupeve të trupave të Forcave të Armatosura të Federatës Ruse shkatërruan tre raketa-hedhës të shumëfishtë Himars të prodhimit amerikan, si dhe një mjet transporti, mallrash dhe specialistë të huaj që siguruan përdorimin e saj", tha ministria, duke shtuar se u goditën gjithashtu dyqani i montimit dhe vendet e përgatitjes për lëshimin e dronëve, si dhe ndërtesa për rigrupimin e trupave armike dhe depo për pajisje ushtarake në 109 rrethe.

Arrestimi i gazetarit

Ndërkohë, Evan Gershkovich, gazetari i Wall Street Journal, i cili prej pesëmbëdhjetë muajsh ndodhet në burg në Moskë, doli sot në gjykatë për fillimin e gjyqit të tij në Yekaterinburg, ku u arrestua me akuzën e spiunazhit teksa po bënte një reportazh për gazeta amerikane. Kjo u raportua nga



BBC, e cila ishte një nga botimet e pranuar shkurtime në sallën e gjyqit përpara se gjyqi të fillonte me dyer të mbyllura. Gazetarja 32-vjeçare amerikane u buzëqeshi fotografëve, pa u thënë asgjë, nga akuariumi, siç quhet në gjykatat ruse një kafaz xhami dhe metali në të cilin janë mbyllur të pandehurit. Gershkovich kishte veshur xhinse dhe një këmbishë të kontrolluar dhe kishte një kokë të rruar. Pas pak minutash gazetarëve iu kërkua të largoheshin. Prokuroria pretendon se gazetari amerikan po mblidhte informacione të klasifikuara për një fabrikë që prodhonte tanke dhe se punonte për CIA. Akuzat janë hedhur poshtë si të pabaza nga Gershkovich, gazeta e tij dhe qeveria amerikane e cila e konsideron atë të ndaluar ilegalisht nga Rusia. Nëse dënohet, rrezikon 20 vite burg.

Leja e SHBA

Duke folur për raketahedhës, më 22 qershor për herë të parë forcat e armatosura ukrainase përdorën këto sisteme për të sulmuar rajonin rus Kursk, duke shkatërruar një ndërtesë të FSB-së. Kyiv Post shkroi se Ukraina gjuajti dy raketa HIMARS në objektet ushtarake pranë Mirnyi në rrethin Suzhansky dhe pranë Dovgi Bumi në rrethin Belovsky. Të dy raketat thuhet se u rrëzuan, por mbeturinat shkatërruan pjesërisht ndërtesën e rojës kufitare të FSB-së në Suzha. Leja e SHBA për Ukrainën për të goditur territorin rus do të kishte prishur planet e Kremlinit për të përdorur më shumë se 90,000 trupa ruse që ishin vendosur për një ofensivë të re në Kharkiv, raportoi Associated Press. Me sa duket, përqendrimi i situatës në front do ta kishte detyruar

Uashingtonin të lejonte Kievin të përdorte artileri dhe sisteme raketore të furnizuara nga Perëndimi.

Vijat e kuqe

Ministri rus i Mbrojtjes Andrei Belousov paralajmëroi për "rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm "të lidhur me furnizimet me armë të SHBA në Ukrainë gjatë një telefonate më 25 qershor me homologun e tij amerikan, Lloyd Austin. "Gjatë bisedës telefonike, e cila u zhvillua me iniciativën e Shteteve të Bashkuara, ministri dhe sekretari patën një shkëmbim mendimesh për situatën në Ukrainë", thuhet në një deklaratë të Ministrisë së Mbrojtjes në Moskë. Belousov, vazhdon shënimi, paralajmëroi kundër "përkeqësimit të mëtejshëm të situatës" për shkak të furnizimit me armë Ukrainës nga Shtetet e Bashkuara. Ndërkohë, ministri i Jashtëm Sergei Lavrov tha se qëllimi i administratës së presidentit amerikan Joe Biden për t'i shkaktuar një "disfatë strategjike" Rusisë është i dënuar me dështim. "Në përgjithësi - shpjegoi Lavrov - të gjitha këto aspirata dhe tendenca që shohim në politikë praktike të administratës s'janë asgjë e re, qofshin ato ide të destinuara me vetëdije për dështimin e shkaktimit të një disfate strategjike ndaj Rusisë apo një dëshirë shumë naive për të frenuar. Moska dhe Pekini në të njëjtën kohë, përveç Iranit."

Shefi i Pentagonit flet në telefon me Ministrin e Mbrojtjes të Rusisë

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, zhvilloi të martën një bisedë telefonike me Ministrin e Mbrojtjes të Rusisë, Andrei Belousov, lidhur me rëndësinë e mbajtjes hapur të linjave të komunikimit, njoftoi Pentagoni. Ky është komunikimi i parë në më shumë se një vit. Palët ofruan vështrime të ndryshme lidhur me bisedën telefonike. Austin e nxiti bisedën telefonike, e para që nga marsi i vitit 2023, tha për shtypin zëdhënësi i Pentagonit, Gjenerali Patrick Ryder. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se zoti Belousov e paralajmëroi Sekretarin Austin për rrezikun e vazhdimt të furnizimit të Ukrainës me armë amerikane në konfliktin 28-mujor me Rusinë. "Belousov vuri në dukje rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm të situatës përmes furnizimit të vazhdueshëm të ushtrisë ukrainase me armë amerikane", thuhet në deklaratën e ministrisë ruse të postuar në aplikacionin e mesazheve Telegram. Agresioni i Rusisë ndaj Ukrainës, aneksimi i katër prej rajoneve të saj dhe përparimet e ngadalshme në pjesën lindore, i kanë dëmtuar marrëdhëniet e Moskës me Uashingtonin, duke bërë që ky të jetë niveli më i ulët që nga kriza e vendosjes së raketave ruse në Kubë në vitin 1962.

Seuli: Prova e Phenianit me raketa duket se ka dështuar

Lëshimi i një rakete balistike drejt detit në lindje të Gadishullit Korean duket se ka dështuar, tha të mërkurën ushtria e Koresë së Jugut. Raketa duket se e ka origjinën nga Pheniani, tha shefi i Koresë së Jugut. Japonia njoftoi se një rakete balistike, që besohet të jetë e Koresë së Veriut, duket se ka rënë në det. Në fillim të javës, Koreja e Veriut kritikoi dislokimin e një aeroplanmbajtëse amerikane që do t'u bashkohet stërvitjeve të përbashkëta me Korenë e Jugut dhe Japoninë dhe paralajmëroi për një "demonstrim të ri të pakalueshëm parandalimi". Aeroplanmbajtësja amerikane me energji bërthamore, Theodore Roosevelt, mbërriti ditën e shtunë, në portin e qytetit Busan të Koresë së Jugut, për të marrë pjesë në stërvitjet e përbashkëta ushtarake me vonë këtë muaj me vendin pritës dhe Japoninë, thanë zyrtarët e marinës. Lëshimi i raketës vjen një ditë pas shënimit të 74-vjetorit të fillimit të Luftës Koreane. Media shtetërore e Koresë së Veriut, KCNA, tha ditën e djeshme, se në Phenian ishte mbajtur një tubim masiv, për të përkujtuar përvjetorin, duke e quajtur atë një ditë "beteje kundër imperializmit amerikan" ndërsa i cilësoi Shtetet e Bashkuara të Amerikës si armikun kryesor.

b o t e

Mark Rutte emërohet zyrtarisht shef i NATO-s, ja sfidat që e presin kryeministrin holandez në postin e ri

32 vendet e NATO-s emëruan ditën e djeshme kryeministrin holandez Mark Rutte si kreun e ardhshëm të aleancës, duke ia dorëzuar detyrën në një moment vendimtar me Rusinë në marshimin në Ukrainë dhe zgjedhjet amerikane që priten. Rutte do të marrë detyrën nga Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg më 1 tetor pasi fuqitë e mëdha, të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara përfunduan nominimin e tij përpara një samiti të

liderëve të NATO-s në Uashington muajin e ardhshëm. "Unë mirëpres ngrohtësisht zgjedhjen e aleatëve të NATO-s për Mark Rutte si pasardhësin tim. Mark është një transatlantist i vërtetë, një udhëheqës i fortë dhe një ndërtues i konsensusit", tha Stoltenberg në mediat sociale pasi ambasadorët e NATO-s miratuan emërimin. "E di se po e lë NATO-n në duar të mira", shtoi ai. Ndërsa 57-vjeçari përballet

me fantazmën e një kthimi të mundshëm të ish-presidentit amerikan Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë, Rutte do të duhet gjithashtu të përballet me kërcënimin e paraqitur nga udhëheqësi rus, Vladimir Putin. Pasi ngriti një pretendim për postin e NATO-s pas rënies së koalicionit të tij vitin e kaluar, Rutte duhej të përdorte të gjitha aftësitë e tij diplomatike për të fituar mbi aleatët ngurrues Turqinë dhe Hungarinë. Ai më në

fund arriti në garën për postin e lartë javën e kaluar kur sfiduesi i vetëm i presidentit rumun Klaus Iohannis u largua. Rutte tani do të duhet të sigurojë që NATO po lufton në gjendje të përballet me kërcënimin që Moskë do të paraqesë për vitet në vijim, dhe gjithashtu të mbajë një "sy të mprehtë" në fuqinë në rritje të Kinës. Megjithatë, shumica e testeve mund të jenë sfida e mbajtjes së aleancës së bashku nëse Trump rimerr presidencën.

■ Votimet mbahen më 30 qershor

Sondazhet "tmerrojnë" Macronin, rreziku kryesor nuk është më e djathta, një kthesë drastike pritet në raundin e dytë të zgjedhjeve, ja aleanca që po kërcënon karrigen e presidentit

Marsela SHYTIA

Idėja e "rrezikut fashist" në Francë duket se nuk ka më vend. Sipas asaj që u theksua nga një sondazh i Odoxa për Public Sénat, sot rreziku kryesor për francezët përfaqësohet në fakt nga Fronti i Ri Popullor, aleanca e së majtës (Partia Socialiste, të Gjellërit, Partia Komuniste dhe Franca insoumise) dhe jo nga formacioni sovranist. 47% e votuesve të qendrës dhe të kraut të djathtë të intervistuar janë gati të ngrenë digën kundër përparimit të Jean-Luc Mélenchon, liderit të Francës insoumise, dhe partnerëve të tij të koalicionit, 44% janë gati të ndalojnë shumicën presidenciale dhe vetëm 41% të kërkuar, për të bllokuar Rn. Me pak fjalë, partia kryesore sovraniste franceze është sot formacioni politik më pak i ekspozuar ndaj strategjisë së bllokimit të votave. Një kthesë në krahasim me zgjedhjet e mëparshme.

Dueli i dytë

Ndoshta të dhënat më kurioze vijnë nga votuesit e Rilindjes, partia e Presidentit të Republikës Franceze, Emmanuel Macron. Në fakt, 71% e adhuruesve të Macron do të votojnë për kandidatin e Kuvendit Kombëtar në rast të një dueli në raundin e dytë kundër një kandidati të Frontit të Ri Popullor. Trendi është edhe më i theksuar në mesin e militantëve golistë: 77% thonë se duan të



bllokojnë frontin Goshist, vetëm 45% duan të ndalojnë përparimin e RN. Siç theksohet nga Senati Publik, popullariteti dhe karizma e Jordan Bardella shpjegojnë shembjen e të ashtuquajturës "digë republikane", ashtu si tonet e Jean-Luc Mélenchon dhe paqartësitë e tij mbi antisemitizmin, shpjegojnë frikën e shumica e francezëve.

Thyerja e "digës republikane"

Sigurisht, e famshmja "diga republikane" që supozohej të mbronte République nga ngritja e RN në nivel lokal dhe kombëtar nuk është më aq solidesa dikur. Në vitin 2002, "diga republikane" lejoji që presidenti aktual, Zhak Shirak, të rizgjidhej me më shumë se 82% të votave. Bogeiman i përfaqësuar nga Jean-Marie Le Pen, themeluesi i Frontit Kombëtar, inkurajoi votuesit e kraut të majtë dhe të

qendrës që të zgjedhin kandidatin e kraut të djathtë, me një rritje të qartë të pjesëmarrjes në votime në krahasim me raundin e parë. Në vitin 2022, Emmanuel Macron, përpara Marine Le Pen, fitoi "vetëm" 58.5% të votave. "Në vitin 2024, barriera republikane duket se është varrosur përfundimisht, duke konfirmuar suksesin e strategjisë së "dëbabilizimit" të partisë lepeniste", nënvizon Senati Publik.

Bashkëjetesa me Bardella-n

Më në detaje, vetëm 42% e votuesve e konsiderojnë si lajm të keq ardhjen e Bardellës në Matignon, pra në krye të qeverisë në rast bashkëjetese. Fundi i logjikës së "breshërisë republikane", krahas rritjes së pjesëmarrjes në votime, mund të favorizojë ndjeshëm deputetin e Kuvendit në zgjedhjet e ardhshme legjislativë dhe t'i lejojë

asaj t'i afrohet shumicës absolute në Asamblenë Kombëtare. 81% e të anketuarve thanë se ishin të interesuar për zgjedhjet legjislativë të 30 qershorit dhe 7 korrikut, një rritje prej 19% krahasuar me zgjedhjet evropiane në fillim të këtij muaji.

Sondazhet

Ky interes i rinovuar mund të çojë në një rritje të fortë të pjesëmarrjes në votime krahasuar me vitin 2022, kur votuan vetëm 47.5% e të regjistruarve në listat zgjedhore. Një nga pasojat kryesore të rritjes së pjesëmarrjes në zgjedhjet legjislativë mund të jetë shpërthimi i numrit të zgjedhjeve trekëndore, pra një raund i dytë me tre kandidatë: për t'u kualifikuar, një kandidat duhet të marrë të paktën 12.5% të votave të hedhura nga votuesit e regjistruar në zonën e tij zgjedhore. Përshkrimi i Partisë Kombëtare të Kuvendit si një kërcënim për demokracinë është një strategji e dënuar me dështim, pasi më pak se gjysma e francezëve pajtohen me këtë mendim. Është një strategji shmangieje, e cila vazhdon të maskojë mungesën e reflektimit mbi natyrën ideologjike, strukturën, tendencat dhe konstantet e fenomenit Rn", shpjegoi Camus, duke e cilësuar reduktimin e votës Rn në "një votë identiteti" si "të thjeshtuar". Sondazhi i Odoxa konfirmon reflektimin e tij.

Zelensky viziton vijën e frontit në Donetsk

Presidenti ukrainas Vladimir Zelensky prezantoi dje, në kuadër të një vizite pune në rajonin e Donetskut, komandantin e sa-poemëruar të Forcave të Bashkuara të Forcave të Armatosura të Ukrainës, Andrii Gnatov. "Unë e kuptoj se ky është një nga misionet më të përgjegjshme, ndoshta një nga pozicionet më të vështira në ushtri, veçanërisht gjatë kohës së luftës." Prandaj, dua t'ju uroj punë efikase, sukses dhe, në të vërtetë, fitore - si rezultat i veprimeve të duhura. Unë me të vërtetë dua që ju të mbani mend se gjëja më e rëndësishme janë njerëzit tanë dhe të bëni gjithçka për të kursyer numrin maksimal të personelit", tha Zelensky, sipas faqes së internetit të Presidentit të Ukrainës. Volodymyr Zelensky zhvilloi një takim dje lidhur me situatën e sigurisë në rajon dhe dëgjoji raportet e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Ukrainës, Alexander Sirsky, kreut të Administratës Ushtarake Rajonale të Donetskut, Vadim Filashkin dhe kreut të Administratës SBU në rajonet Donetsk dhe Lugansk, Alexander Nadoch. Alexander Sirski raportoi për situatën në vijën e frontit në rajonin Donetsk dhe në zona të veçanta në rajonin e Kharkiv, Oblast Luhansk, Zaporozhye dhe Kherson Oblast.

Gazetari amerikan Evan Gershkovich rrezikon 20 vjet burg

Gjyqi ndaj gazetarit amerikan të burgosur në Rusi, Evan Gershkovich, ka nisur dje teksa ndaj tij rëndon akuza për spiunazh. Gjyqi është zhvilluar me dyer të mbyllura në një gjykatë në Jekaterinburg, në qytetin Ural. Mediat, miqtë, anëtarët e familjes, e as pjesëtarët të Ambasadës amerikane nuk u lejuan të marrin pjesë në seancat gjyqësore. Gershkovich u arrestua më 29 mars 2023 gjatë një vizite për një reportazh që po kryente për "Wall Street Journal" dhe u akuza se tentoi të siguronte të dhëna të fshehta ushtarake. Redaksia e lajmeve dhe Qeveria amerikane i hedhin poshtë këto akuza si të motivuara politikisht. Të dyja institucionet kanë deklaruar disa herë që Gershkovich, 32-vjeçar, ka qenë duke e bërë punën e tij. Gazetari Gershkovich ka lindur në Amerikë, nga prindër emigrantë nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe është gazetari i parë amerikan që arrestohet për akuzat për spiunazh në Rusi, që prej Luftës së Ftohtë. Ai rrezikon të dënohet me burgim deri në 20 vjet, nëse shpallet fajtor, gjë që është pothuajse e sigurt, shkruajnë mediet ndërkombëtare. Një tjetër shtetase amerikane që aktualisht po mbahen prej autoriteteve është edhe Alsu Kurmasheva, gazetare e Radio Evropa e Lirë.

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

Prostati, legjendë shqiptare, luftohet me mashtrime
-Vështrim-

Nga Vladimir SHYTI

Sëmundja e prostatit dhe potencia te meshkujt ka një subjektivizëm të rrëmbyer nga qarqe të ndryshme të disa kompanive fantazëm. Pandeshmëria e entuziazmit, të kësaj sëmundje legjendë u shikua si përfitim nga mashtruesit e klinikave "të arrira" që me gjasme luftonin sëmundjen nga të rinjtë e deri në moshën e thyer. U mbushën rrjetet sociale me emra të njohur mjekësh, këshillime nga artiste të njohur dhe, së fundi deklarimin, duke paraqitur bindshëm koponentin e markës së tyre të panjohur nga shqiptarët. Të etur për fitime monetare, tregonin gjëndjen e rrezikshme të sëmundjes dhe shifra marramendëse vdekjesh në botë. Shqetësohen për jetën private të çdo individi, vendosin një shumë të madhe dhe, pastaj

e ulin deri në 50% të shumës. Shënojnë shumë komente nga të rinjtë, që reklamojnë anën seksuale, helbete ata janë aktiv, por u pëlqen stimulimi mashkullor. Ndërsa, moshë e thyer me shpresën e përmisimit, duke parë komentet dhe ato këshillime bajate, lajkat, fjalët e bukura plot magji të disa vajzave me zë lozanjar, mbeten të zhgënjyer në fund të muajit. Para dy ditësh tepër kuështarë kërkova dhe hetova se, një tregtarë po shpërndante kapsula prosta fix pothuajse falas. Të disponueshme kushtonin 2400L dhe jepeshin me 600 L për qytetarët në nevojë. Në fasadë ishte një foto e parlamentit shqiptarë në procedurë e sipër dhe, para kuvendit parlamentar qëndronte një moderator lajmesh, që jepte sihariqin e mirë për shpërndarjen pothuajse falas të medikamentit. Në celular u ndje një zë i ëmbël femre, që u interesua për sëmundjen time të prostratit, i kthej

përgjigje, por me sa kuptova, asaj nuk i interesonte përgjigjia ime, foli vetëm ajo. Dhe, së fundi më kërkoi 1100 L për kurën. Vazhdova lojën e saj të nesërmen, formoi numrin telefonik, nuk ekzistonte. E mora sërish, vetëm një tringëllim dhe asgjë nuk pipëtinte. Ditën tjetër një numër i panjohur më merë në celular, një zë femëror më godet me shigjeta mbrojtëse me fjalë jo bindëse. E mbyll celularin, i bëj bllokad dhe loja merë fund. Tashmë të kthehem te farmaceutika jonë dhe këtu vrehen shumë medikamente jo rezultative, sidomos për moshën e thyer. Mbjajnë mbishkrime në gjuhën gjermane. Komentohen si tepër të sigurta, por dikush përdor një medikament, Man Aktiv, me një çmim të lartë për vendin tonë, por rezultati një zhgënjim total. U interesova, por nuk mora përgjigje, gjithçka ishte e fshehtë, me sa mendoj ata ecin me mentalitetin shqiptar

krashi seksualitetit. Por, jo zotërinjë populli ynë e një tashmë botën më mirë se ju, ata janë besnik të metodës së ballafaqimëve, ku dhe e kanë kaluar tërësisht natyrën e shkuar të mentalitetit seksual. Ndaj, largoni strehën e demonit nga kjo humnerë, ku keni rënë ju, jo populli ynë i mençur. Tani, lind pyetja: Kush i kontrollon këto firma të "të padukshme"? Kush janë këta, që dalin jashtë reve të fatit dhe pasurohen me mjerimin e shqiptarëve? Ndërmjet tyre shtrihet një gjysmëdritë, që po i mban ende në muzgim fitimprurës. Ne refuzojmë kopromiset jo profesionale, apo marrëveshje me vulgaritetin e fitimit të shpejtë, çdo lloj shtërgese që i bëhet padinjitet këtij populli të shumë vuarjtur. I mbetet qeverisë në pushtet, ministrisë përkatëse që të sheshojë këto ç'rregullime në tregun e medikamentëve, që i kanë zgjatur tentakulat thellë në jetët tona.

Kur zgjedh mes Hipokratit dhe hipokritit

Nga Dhimitër SHTËMBARI

Sikur ta "ftonim" Hipokratit, mjekun e famshëm grek të shekullit IV para Krishtit, që të na thoshte ndonjë vlerësim, qoftë edhe fare të shkurtër, për mjekët që shërbyen në Lushnjë viteve 70 - të, 80 - të dhe 90 - të, besojmë, dhe besojmë fort, se do të na përgjigjej: të gjithë ishin mjekë të shkëlqyer. Humanistë. S'e njihnin korrupsionin. Dhe, duke cituar një pjesë nga "betimi" i vet, Hipokrati do të na "thoshte": mjekët e atyre viteve në Lushnjë "Në ushtrimin e profesionit ndaj të sëmurit tek ata asnjëherë s'ndikoi përkatësia e besimit, e nacionalitetit, e racës, e politikës, apo e përkatësisë klasore". Vërtet nuk kanë fotografi gjëkund, qoftë edhe emrin të shënuar në murin e ndonjë pavioni të spitalit, megjithatë ata kanë mbetur "buste" në kujtesën e mijëra qytetarëve myzeqarë e shumë më gjerë. E kush s'ruan respekt për të përkushtuarin Prrënjohëri e të papërtuarin Vasilika Ymeri; për duarartin Skënder Hoxha e zemërdhimbsurën Nyrten Hoxha; për humanistin Ilmi Deliallisi dhe zemërngrohtin Ismail Nova, për gojëëmbëlën Afërdita Turku e për të palodhurit Viktor Zegali e Kol Prihti, për ... Duke u kërkuar falje këtyre figurave dhe shumë mjekëve të mrekullueshëm të një brezi më të ri, le të merremi, shkurt, vetëm për tre nga emblemat e spitalit të Lushnjës.

Dr. Ihsan Çabej

Emri i mjekut Ihsan Çabej është më i lakuari në gojën e njerëzve të të tri brezave. Sepse ky u shërbeu myzeqarëve të Lushnjës nga viti 1953 e deri në vitin 1992, vit kur doli në pension.

- Doktor Çabej, kam një hall shumë të madh!...

Ky që i lutej ishte një mesoburrë, që i kishte zënë pritë mjekut tekta ky po kthehej prej spitalit atë ditë të ftohtë dimri.

- Çfarë halli ju ka zënë?! - iu drejtua doktori.

- Kam kumatën në Toshkëz, që është shumë e sëmurë. S'leviz dot nga vendi!

Mjeku e shikoi me një ndjenjë keqardhjeje, por nuk arriti t'i kthente ndonjë përgjigje, sepse ai që i kishte prerë rrugën, vazhdoi:

- Puna është se e sëmura ju kërkon pikërisht ju. "Mos më bini doktor tjetër, na thotë; vetëm doktor Çabej me sillni këtu...". Ka besim vetëm te ju.

I qetë prej natyre, doktori i hodhi sytë andej nga kishte ardhur dhe...

- Çështja është se ambulanca jonë s'dihet se kur kthehet nga Tirana...

- Për këtë, i kam marrë masat: ja ku është taksia.

Dhe të dy u drejtuan drejt mjetit që i priste.

- Po këto, çfarë i ke?! - i drejtohet doktori atij që e shoqëronte.

- Janë çisme. Mbase do t'ju duhen atje, se shtëpia e të sëmurës është pak larg qendrës së fshatit.

Mbas kësaj bisede, taksia u nis drejt shtëpisë së të sëmurës.

Doktor Çabej ta lexonte diagnozën në sy.

Dr. Ihsan Çabej, djali i Gjyrotkastres, student i Universitetit të Bolonjës, falë punës së tij të ndershme u bë deputet i Kuvendit të Shqipërisë. U bë dhe mbeti edhe Qytetar Nderi i Lushnjës.

Dr. Qirjako Lezho

Rasti e solli që kirurgun Arqile Andrea - Profesor doktor, ta kisha mysafir në shtëpi. Në bisedë e sipër, fjala shkoi edhe te kirurgu me emër i Lushnjës, Qirjako Lezho.

- Atë e hëngri provinca, se po ta kishin lënë

mjek këtu në Tiranë, ku pat qenë nëndrejtor spitali, do të kishim një Qirjako tjetër. Flas për nga profesioni.

Dhe Prof. Arqileja (ndjesë past!) vazhdoi: Dikur më thërresin në drejtorinë e spitalit këtu në Tiranë dhe më njoftojnë, se duhej të nisesh urgjent për në Lushnjë. Atje paraqitej një rast i veçantë: kërkohet të bëhej një ndërhyrje kirurgjikale në trupin e një djalë të ri, rreth të njëzetave. Mora detyrën dhe nuk u vonova të nisesh. Mendimi më i parë më shkoi te doktor Qirjakoja. E ç'mund të bëja unë më shumë se sa ai në një rast të tillë? Arrita në Lushnjë dhe... drejt e në spital. Doktor Qirjako më priste. Ma tregoi hollësisht rastin në fjalë dhe... Vepioni si ta gjykoni ju" më drejtohet. "Ju, së bashku me ekipin, a e merrni përsipër këtë operacion, që, të themi të drejtën, është pak i ndërlikuar?". I thash këtë dhe, të them të drejtën, më zuri një mëdyshje: një mjek i zakonshëm, në një rast të tillë do të pranonte të ishte larg ndonjë telashi të mundshëm dhe do të mund të thoshte: "Merreni dhe operojeni në Tiranë". Në çast dëgjova të më thotë: ekipi im kirurgjikal e merrë përsipër këtë operacion, veçse duhen bindur familjarët, që kërkojnë me çdo kusht që i sëmurit të nisët për në Tiranë. Folëm me familjarët, i bindëm ata dhe operacioni u krye siç dinte mjeshtri Qirjako. Biri i nderuar i Sheperit të Zagories, Qirjako Lezho rininë e kaloi në Peqin, ku i ati punonte gjykatës. Në po këtë qytet doli partizan, madje kuadër i rëndësishëm i batalionit partizan të këtij qyteti.

Dr. Vasil Kuli.

Mjeku Vasil Kuli, i specializuar për sëmundjet e zemrës, në pamje të parë të jepte përshtypjen e një aristokrati hijerëndë. Si edhe mjekët e tjerë, edhe doktor Kuli vihej në pozitë të vështirë në qytet: sapo shitëset shikonin një mjek në mesin e atyre që kishin përpara, men-

jëherë u drejtonin buzëqeshje dhe... "doktor, mos dëshironi të bleni diçka?" Edhe njerëzit e gjendur aty për rreth shprehnin të njëjtin respekt. Pranonin që ata të merrnin "pa radhë", sepse e kuptonin që edhe ata u shërbenin "pa radhë", ditën dhe natën. Erdhi një kohë, aty nga viti 1974, që disa mjekë specialistë të spitalit t'i qarkullonin nga qyteti në fshatra! Dr. Vasil Kuli e dërguan në Gradishtë. Një pasdite ktheheshim nga Remasi për në Lushnjë. Teksa bisedonim me kryetarin e kooperativës bujqësore të Gradishtës, na afrohet doktor Kuli.

- A keni ndonjë vend deri në Lushnjë?

- Posi, madje kemi dy vende.

Ndërkohë që shkon drejt makinës, dikush i afrohet pranë dhe...

- Doktor, e kam nënën shumë të sëmurë.

Dhe nisi t'i tregonte shënjat e sëmundjes.

- Mos vazhdo më tej! Po vij ta vizitoj në shtëpi.

Mori çantën që e kishte futur në makinë dhe i bëri shenjë tjetrit që ta shoqëronte.

- Doktor, po ju presim, - i drejtohem.

- Vazhdoni rrugën, se nuk i dihet punës sime...

Na përshëndeti dhe mori rrugën për në Fier - Seman.

Rrugës për në Lushnjë, shoku që kisha në makinë, më drejtohet:

- E po, do të kisha vdekur pa e njohur mirë këtë doktor...

- Përse flet kështu?!

- Duke e njohur nga larg, më ishte krijuar përshtypje se ishte moskokëçarës.

Dr. Vasil Kuli është babaj i Prof. Rexhinës, drejtoreshës së mirënjohur të Pediatrisë në Spitalin "Nënë Tereza" të Tiranës.

Për mjaft nga mjekët e ditëve të sotme nuk e kemi të lehtë t'i përgjigjemi pyetjes: kanë zgjedhur rrugën e Hipokratit, apo atë të hipokritit?!

I vetmi peng i Edi Ramës paska qenë Sali Berisha

Nga Namir LAPARDHAJA

Tashmë është e qartë se i vetmi peng i Edi Ramës paska qenë Sali Berisha. Pas shpalljes së tij "non grata" për korrupsion madhor, minim të demokracisë dhe shantazh të sistemit të drejtësisë, Berisha ka qenë "i detyruar" të jetë një gur shahu në lojën e pushtetit. Shkatërrimi që i bëri PD-së dhe opozitës, infrastruktura e ngritur në të gjithë Shqipërinë nga njerëz mbështetës së Edi Ramës, mbështetja e fuqishme ekonomike dhe mediatike nga oligarkët e pushtetit, jo vetëm që i kanë shkuar përshtat socialistëve dhe kësaj mazhorance, por kanë qenë një sintoni perfekte për vijimin e qeverisjes së tyre pa kurrfarë

shqetësimi, pavarësisht skandaleve të shumta korruptive. Njohja, së pari, e grupit parlamentar të mbështetësve të Berishës si PD, pavarësisht vendimit në atë kohë të gjykatës, dhënia e vulës më pas dhe mosdëgjia e mandatit të deputetit sipas parashikimeve kushtetuese, janë tregues i qartë se Berisha për Edi Ramën është një thesar i paçmuar, është një aset politik që, pavarësisht se ç'bën Amerika dhe SPAK, Rama bën gjithçka për ta mbajtur në lojë dhe për ta pasur përballë. Nëse dy njerëzve të afërt të tij, siç ishin S. Tahiri dhe A. Ahmetaj, kushtetuta iu lexua drejt, duke ia ndërprerë mandatin, për shkak të mungesës 6-mujore në Kuvend, për Berishën u bë një lexim tjetër, duke e justifikuar si mungesë me arsye. (Për një moment, imagjinoni sikur t'i ishte bërë në një situatë të ngjashme i njëjti lexim

për Lulzim Bashën! Thjesht mbyllni sytë dhe imagjinoni se çfarë do ishte thënë e çfarë do kishte këputur Berisha nga maja e Ballkonit të katit të 8-të!!!) Në fakt, e vetmja "arsye" e Berishës është nevoja e Edi Ramës për ta pasur përballë në lojën politike. Të mendosh që me Berishën nuk u ndoq as standardi i Tahirit dhe Ahmetajt, gjë që qartëson se kë do më shumë dhe kë ka më afër Edi Rama. Atyre ua dogji mandatin, Berishës jo. Të merremi vesh, për sa kohë kjo është një lojë e madhe, qoftë Rama, i cili kërkon ta ketë Berishën përballë, është në të "drejtën" e tij, por qoftë edhe Berisha, i cili, në një farë kuptimi, është i "detyruar" të luajë në vallen e qeverisë, për shkak të njohjes që i kanë bërë si lider i opozitës, është në të "drejtën" e tij. Problemi është manipulimi dhe mashtrimi i

opinionit publik, që i hidhet pluhur syve mëngjes e mbrëmje me pushtet që kacafytet për reforma të mëdha dhe opozitë të vërtetë që lufton korrupsionin e pushtetit të konsumuar. Për të mos folur për një aradhe militantësh të pa sy e pa veshë që i shohin dhe dëgjojnë udhëheqësit e tyre me gojë hapur, pavarësisht çfarë veprojnë dhe çfarë artikulojnë. Të gjitha janë mashtrime. Si pushteti ashtu edhe kjo opozitë, janë në shërbim të dy njerëzve, Ramës dhe Berishës, të cilët i luajnë të gjithë telat vetëm në funksion të vetes së tyre. Kanë lidhur një aleancë për të shpëtuar veten dhe për të luftuar SPAK-un. Se sa do t'ia dalin, ngelet për t'u parë. Por ajo që është parë qartë deri më sot, është se i vetmi peng i Edi Ramës paska qenë Sali Berisha. Askush tjetër!

k o m e n t e & a n a l i z ë

Pse nuk ka turizëm bashkëkohor në Prespë?

Nga Bardhyl BERBERI

Vetëm kur e viziton Prespën e ndien thellë mahnitjen nga peizazhet e shumta të saj, liqenet, malet që e rrethojnë zonën i japin asaj një pamje të rrallë. Me 9 fshatra të vendosur në gjoksin e maleve që përbëjnë komunën e Liqenasit: Me Kallamasin, Goricën e Madhe, Gorica e Vogël, Gollomboçin, Diellasin, Liqenasin, Lajthiza, Zaroshka dhe Cerja ku jetojnë afërsisht rreth 4 mijë e 500 banorë. Malet e lartë të bleruar që e kalojnë lartësinë mbi 2000 m lugina dhe shpate të vendosur mbi kaltërsinë e liqeneve me brigje të banuar krijojnë atë konfiguracion të papërsëritëshëm. Kështu, i mbushur me këto kontraste bukurish, me një kulturë të lashtë, me ushqim të mirë dhe një mikpritje dhe mbi të gjitha një shpirt njerëzor ndjehesh komod në Prespë. Këto kushte të favorshme klimatike, ujrat e pastra të burimeve përzemërsia e banorëve janë joshëse dhe të krijojnë relaks në çdo stinë të vitit. Por bukuria e vërtetë e Prespës

janë dy liqenet e tij katër ishujt në dy liqenet e Prespës. Në lartësinë mbi 850 m mbi nivelin e detit gjenden dy liqene të ndarë nga një brez i ngushtë toke. Më i madhi i quajtur Prespa e Madhe i cili ka një sipërfaqe prej 285 km² dhe thellësi maksimale 54 m. Ky liqen është i ndarë nga tre shtete ku pjesën më të madhe e ka Maqedonia, kurse Shqipëria dhe Greqia kanë nga 40 km² secila, ndërsa liqeni tjetër ai i Prespës së Vogël i cili ka një sipërfaqe prej 47 km² dhe një thellësi prej vetëm 12 m i takon pothuajse i gjithi Greqisë, me përjashtim të një pjese të vogël që ka Shqipëria.

– Në 2 shkurt të vitit 2000 kryeministrit e Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë e kanë shpallur parkun e Prespës si zona e parë e mbrojtur në Ballkan?

– Është e vërtetë që është shpallur zonë e mbrojtur, por kur kalon nëpër parkun e madh të Prespës shikon një masakër të vërtetë. Drurë të parkut të masakruara në mënyrën më të shëmtuar. Parku shfrytëzohet nga banorët për dru zjarri për ngrohje.

– Natyrshëm lind pyetja me çfarë merren

banorët e kësaj zone turistike?

– Banorët merren me bujqësi, blegtori dhe me peshkim. Nga zona e Prespës ka filluar një emigrim pas viteve të trazicionit duke e ulur ndjeshëm popullsinë e kësaj zone. Tashmë në peshkim marrin pjesë shumë persona, të cilët duan të nxjerrin të ardhura për mbijetesë, por shpesh prodhimi na dëmtohet nga mungesa e përpunimit sepse tregun deri në Korçë e kemi larg dhe mundësi përpunimi këtu tek ne ende nuk ekzistojnë. Një fakt i hidhur për Prespën është se ka ende banorë që nëpër shtëpitë e tyre mbajnë bagëti duke e ndotur ambientin përreth. Në Prespë, na thanë, që janë bërë rreth 50 shtëpi model që mund të presin turistë, por kjo shifër është shumë e vogël me mundësitë reale që ka kjo zonë e cila me bukuritë e pafund ka dhe liqenin në gji ka mundësi që të presi mijëra e mijëra pushues çdo verë. Zona e Prespës mes rrugëve të ngushta me erë, që ju çojnë pranë drunjëve të mollëve përreth liqenit, tek strofullat e zogjëve, më pas lart në Galicicë ku rruga kalon nëpër livadhet

e bukura, në majë të Malit të Thatë do të shikoni njëherazi të dy liqenet e Ohrit dhe të Prespës. Banorët e shumë të takuam na thanë se ka ardhur koha që edhe kjo zonë të ketë turizëm bashkëkohor. Zona turistike përreth liqenit të Prespës të presi vizitorë t'u tregojë atyre mitet, legjendat dhe historitë e saj të lashta të civilizimit, t'u tregojë atyre që ka qenë qendra e mbretërisë së Samuilut, degëzimet e rrugës Egnatia dhe kryqëzimet si dhe kullat mesjetare përgjatë rrugës kishat e shumta të shekullit të XII dhe XIV ku ndodhen themelet e qendrave të banuar nën ujrat e këtyre liqeneve. Nuk mund të largohesh nga Prespa pa shijuar tavën e krapit të shijshëm apo peshqit e vegjël që vendasit iu thonë 'tsironia'. Këtu nuk gjen shtëpi pa fuçinë e verës artizanale apo kazanet artizanale të rakisë që vendasit e ruajnë për miqtë... Kjo ishte Prespa mes bukurive të pafund një pritje bujare dhe një distance që ajo ka ende me mundësitë reale me turizmin bashkëkohor, madje edhe në dimër shumë turistë udhëtojnë drejt Prespës vetëm për tavën e rrallë të krapit.

110 milionë euro paga të shtuara në shtet

Nga Fatos ÇOÇOLI

Dje, Ministri i Financave Ervin Mete, pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave, mëtoi për opinionin publik se, me miratimin e vendimeve të djeshme, nisi faza e dytë e politikës së rritjes së pagave në administratën shtetërore. Duke filluar nga 1 korriku 2024, me një fond shtesë rreth 11 miliardë lekë, ose 110 milionë euro deri në fund të këtij viti, 135 mijë punonjës të administratës shtetërore do të shohin rrogat e tyre të rritura. Këto 110 milionë euro më shumë në duart e 135 mijë familjeve shqiptare këta gjashtë muaj të dytë të vitit, ndihmojnë ekonominë tonë të zhvillohet më mirë. Shumica e këtyre 110 milionë eurove do të shkojnë për konsum. Një javë më shumë pushime, blerje të një orendie apo elektroshtëpiakeje të re, lodra më shumë për fëmijët, etj. Një vit e një muaj më parë, më 25 maj 2023, Ministria e Financave dhe Ekonomisë prezantoi në Kuvendin e Shqipërisë projektligjin për rritjen e pagave për administratën shtetërore. I kthyer në ligj dy ditë më vonë, ai synoi një reformë të plotë dhe të thellë të pagave në shtet dhe po e realizon. Reforma kërkoi ta kthejë administratën publike në sa më profesionale dhe tërheqëse në tregun e punës, duke nxitur inovacionin

dhe konkurrueshmërinë. Qeveria mori përsipër brenda një viti e dy muajsh, deri në korrik 2024, një shtim deri pak vite më parë të pamenduar në këto nivele të larta, duke e çuar pagën mesatare të nëpunësit publik në nivelin e 90 mijë lekëve të reja në muaj. Një shtim, sipas planit të qeverisë, nga 100 mijë lekë të vjetra në muaj për ata me pagë minimale, në 250-320 mijë lekë të vjetra në muaj, për të gjithë punonjësit në shtet me pagë afër pagës mesatare. Qeveria u kujtua vonë për të rritur rrogat, por më mirë vonë se kurrë, thotë populli. Lind pyetja, çfarë e nxiti qeverinë të shikojë me ngulm rritjen e pagës mesatare bruto të 180 mijë punonjësve të saj? A është kjo paga që duam? Që të mos braktisim në masë vendin tonë? Duket se po. Në maj 2023, kur nisi reforma, paga mesatare në vend, sipas INSTAT, ishte 66 mijë lekë. Vendimi për të rritur pagën në administratën publike me 45 përqind nga niveli i atehershëm, brenda një viti, ishte një vendim sa kurajoz, aq edhe pozitiv. I pritur prej shumë kohësh, i domosdoshëm për të gjitha kategoritë e punës dhe strukturën e pagave në sektorin publik. Paketa qeveritare e reformës së pagave do të shërbejë edhe si nxitje për rritjen e mëtejshme të pagave edhe në sektorin privat. Administrata publike punëson sot rreth 135 mijë punonjës, në sektorë si arsim publik, shëndetësi publike, administratë

publike qendrore dhe vendore, në polici, ushtri, ndërmarrje shtetërore aksionere, etj. Sektori privat, i cili jep më shumë se 80 përqind të prodhimit të përgjithshëm bruto të vendit, punëson më shumë se një milion punonjës në Shqipëri. Një pjesë e mirë e punonjësve në sektorin privat, rreth 40 përqind, janë të vetëpunësuar në bujqësi. Niveli i pagave, më shumë se sa një politikë sociale, varet nga produktiviteti (sasia e mallrave dhe shërbimeve që prodhon në njësinë e kohës) i ekonomisë dhe mundësitë financiare që ka vendi, për të zbatuar një politikë të pagave më të larta, si ato minimale dhe mesatare. Shtimi i ndjeshëm i pagës mesatare në shtet do të shërbejë si presion pozitiv edhe për rritjen e pagës mesatare në ekonominë shqiptare. Tek ne, prej vitesh ka pasur një hendek lidhur me nivelin e pagave minimale dhe mesatare, krahasuar me vendet e rajonit, të afërta me nivelin e fuqisë blerëse të vendit tonë, si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi. Paga mesatare bruto (pa taksat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore), është rritur ngadalë gjatë nëntë viteve 2013-2021. Nga 45.5 mijë lekë që ishte në vitin 2014, viti i parë që INSTAT raporton pagën mesatare, ajo arriti në 66 mijë lekë pas 9 vitesh në 2022-in, me një rritje të paindeksuar me inflacionin. Gjatë vitit 2022, pagat u rritën me shtim dyshifror, nga presioni i inflacion-

it të lartë dhe nga presioni i mungesës së punonjësve, me pothuajse të gjitha bizneset që raportojnë vështirësi në gjetjen e fuqisë punëtore në të gjithë sektorët e ekonomisë, deri në nivele 55 mijë-60 mijë punonjës në mungesë dhe në kërkim për t'i gjetur. Reforma e pagave synoi dhe po e realizon të përmirësojë edhe hierarkinë e pagave, për të tërhequr e mbajtur në administratë punonjësit e kualifikuar. Ajo fut një lidhje të drejtpërdrejtë midis pozicionit të punës dhe përgjegjësisë përkatëse, me pagën që punonjësi do të marrë këtej e tutje në shtet. Reforma përbën një ndryshim thelbësor në politikën buxhetore dhe fiskale të Shqipërisë. Është ndryshim historik, pasi ajo e sjell politikën buxhetore më shumë pranë dhe në shërbim të qytetarëve. Për çdo dy lekë të ardhura të mbledhura nga taksat dhe tatimet, nëpërmjet reformës, një lek shkon për transferta direkte, paga, pensione dhe ndihmë ekonomike. Gjysma e parave të buxhetit të shtetit shkon drejtpërdrejtë të qytetarët, ndërsa gjysma tjetër për përmirësimin e shërbimeve, investime dhe të tjera aktivitete buxhetore. Me këtë reformë, paga në arsimin publik në korrik shtohet me 72 përqind dhe në shëndetësinë publike me 99 përqind, pra dyfishohet. Një tjetër vendim pozitiv është indeksimi i pagave në shtet çdo dy vjet. Nuk ka më pauza të gjata kohore, pa indeksuar pagat.

Nga Jak SIMONI

Ndonëse kombëtarja jonë mori vetëm një pikë në kampionatin evropian të futbollit, paraqitja e saj ishte ndoshta më e mira në historinë e saj. Ajo krijoi një atmosferë të këndshme që kaloi lojën e futbollit, duke përfshirë emocionalisht të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin e duke mbajtur me shpresë deri në minutën e fundit të ndeshjes së fundit. Shqiptarët anëmbanë Evropës mbushen rrugët dhe stadiumet e qyteteve gjermane, ku u zhvilluan ndeshjet. Kjo arritje bazohet tek fakti se luajnë së bashku futbollistët më të mirë të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. Atë që

Futbolli le t'i paraprijë historisë

nuk e arritëm kurrë të ndarë e me trajnerët tanë e arritëm të bashkuar dhe me trajnerë të huaj. Janë vërtetë për tu admiruar ato futbollistë që kanë zgjedhur kombëtaren e Shqipërisë, në vend të që të zgjidhnin atë të Kosovës, apo atë të Maqedonisë së Veriut. Ata entuziazmuan dhe frymëzuan shqiptarët kudo që ndodheshin e mbajnë gjallë shpresa që kalojnë futbollin. Ky bashkim i dha rezultatet. Le të jetë kjo arritje një metaforë për një arritje më të madhe të kombit tonë. Shqipëria dhe Kosova nuk e arrijnë kurrë të vetmuar atë që mund ta arrijnë bashkë. Në futboll u gjetën trajnerët,

jo vetëm nga kontinenti ynë, por në politikën ndërkombëtare nuk është e lehtë. Pas një historie të gjatë thuajse tragjike, patëm një periudhë me mbështetje pa kushte të ndërkombëtarëve që u finalizua me çlirimin e Kosovës, por me sa duket sikli i kësaj periudhe nuk është shumë i gjatë. Horizonti nuk duket shumë i kthjellët. Politika ndërkombëtare po ndryshon dhe aty ku pati fillimet parimi iluminist i lirisë, barazisë dhe vëllazërisë dhe internacionalizimi i këtij parimi. Ketë internacionalizëm e tregon fakti se në asamblenë e famshme franceze të periudhës iluministe, të fry-

mëzuar nga kjo rrymë, që shprehur mendimi i krijimit të një qeverie mbarë botërore që do zhdurte padrejtësitë në mbarë botën. Natyrisht, duke qenë asambleja franceze e famshme për debat, një tjetër parlamentar i përgjigjët: "unë propozoj të bashkojmë tokën me hënën". Me sa duket po bëhet më aktual ky i fundit, më pak i ndikuar nga iluminizmi. Secili shtet po rifillon të vendosë interesat e ngushta të tij në plan të parë. Por, gjithsesi, le të mbajmë gjallë shpresën që futbollit së fundmi zgjoi tek ne. Sporti duhet të jetë më tepër se një lojë, përndryshe nuk do ia vlente me tërë atë vulgaritet që prodhon në shumë raste, e më gjithë atë ndotje që prodhon duke u kthyer në një industri përfitimti.

k o m e n t e & a n a l i z ë

www.sot.com.al

Protestë të madhe në korrik për nderin e humbur para bashkisë për mos hiç!

Nga Bardhyl BEJKO

Strategjia ka ndryshuar. Pas trembëdhjetë protestave minore, të zhurmshme me molotovë e flakë, fjalime, deklarata, zhurmë, kërçitje dhëmbësh sikur të shkreheshin karikatorë automatiku dhe kërcënime pa fund, kryesia e madhe e PD-së, tanimë me vulë e sigël, dhuratë nga gjykata, vendosi të thërrasë në sheshin para kryeministrisë protestë kombëtare. Më shumë se ndryshim destinacioni, kjo protestë, e cila është e radhës dhe në vijim të atyre të organizuara më parë, synon të shmangë dështimin e miniprotestave para bashkisë së kryeqytetit. Si të kyçet protesta minore? Si të pushohet? Po të mbyllet pa asnjë alibi është dështim i turpshëm. Ske-



nari i vetëm mbetet të premtohet protesta madhështore më e madhja shekullore. Molotovët dhe zhurma pa fund në qendër të Tiranës dështuan në një grusht individësh, shumica të armatosur me goma makinash, lëndë djegëse dhe molotovë, të cilat në pikun e vapës ndezën Tiranën nga jo tiranas. Shumë pak qëndrestarë iu qasën protestave dhe po kaq pak ishin ata që u futën në këtë valle me pretendime të mëdha, po në fund u mbetën vetëm flakët dhe përcëllimi i duarve, zhuritja dhe djegia e vetullave nga flakët që ndezën duke djegur goma dhe hedhur molotovë. Qytetarët dhe turistët kalonin përbri flakëndezësve indiferentë dhe nuk është se u bënte shumë përshtypje. Këtë herë asnjë media prestigjioze nuk ua vari protestuesve, të cilët kishin të njëjtin skenar dhe të njëjtat mjete. Asgjë interesante, nëse nuk u referohemi bluzave me portretin e Berishës të stampuar e zeza në sfondin e bardhe, duke nxjerrë zbuluar, jo vetëm

kërkuesit e mbrojtjes së Teatrit Kombëtar si ambalazh për të maskuar të vërtetën, po edhe organizatorët realë të dy partive, asaj të Partisë së Lirisë dhe PD që nisi protestat anti-bashki pa vulë dhe e mbylli me vulë. Dështimi ishte epik. Asgjë e re nga fronti anti-bashki dhe kërkesave maksimale për lirinë e Berishës dhe dërgimin në qeli të Erjon Veliajt, i cili në të kundërt të protestuesve dhe organizatorëve vazhdoi punën e pastrimit të kryeqytetit dhe asfaltimin e blloqeve në periferi. Në këtë mënyrë qytetarët seriozë të Tiranës dhe zonave përreth ishin indiferentë ndaj molotovhedhësve dhe zjarrvënësve të gomave dhe vlerësues për rindërtimin dhe asfaltimin apo përmirësimin e jetesës përkundër tymosjes së qiellit të Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Trembëdhjetë herë e njëjta histori me të vetmin ndryshim se pjesëmarrësit çdo të martë ishin gjithnjë e më pak dhe jo më kot. Tek kauza e protestuesve nuk besoi qytetari dhe

lexoi mesazhin se nuk ishte në interes të tyre, po individëve dhe disa skifterëve, të cilët kërkojnë të bëhen faktorë përmes flakëve dhe shpërthimeve, mjafton që në ekranet e TV të duken sa revolucionarë dhe qëndrestarë janë. Tani kur dështimi është i provuar dhe i njohur nga tërë shoqëria shqiptare, organizatorët, si me vrapuesit me stafetë e dorëzuan pish-tarin tek kryesitë e partive opozitare për një skenar të ri. Zhvendosja e protestës nga bashkia në kryeministri. Nuk është thjesht ndërrimi i shesheve. Edhe thirrjet, Veliajt jashtë nga bashkia në qeli, do zëvendësohen, Rama jashtë nga kryeministria. Poshtë qeveria! Pastaj kuptohet do kërkohet qeveri teknike dhe zgjedhje pa këtë pushtet, duke i bërë zgjedhjet siç do opozita vet. Se këta të qeverisë janë hajdutë. Ata të opozitës engjëj që sa herë kanë patur pushtet zgjedhjet kanë qenë demokratike, të ndershme dhe pa asnjë incident.

Ka, apo s'ka akuza për Berishën

Nga Ramazan SHERJA

Jo vetëm berishistët, që tanimë kanë humbur çdo sens vlerësimi të së vërtetës, por edhe njerëz të zakonshëm, shprehen se Berisha është një i burgosur politik, pasi ndaj tij nuk ka asnjë akuzë! Në fakt pyetja që bëhet është: Ka, apo s'ka fakte për të ngritur akuza ndaj Berishës? Nëse s'ka, ai të lihet i lirë, në të kundërt të shkojë atje ku ka vendin. Brenda vendit për Berishën nuk ekziston asnjë akuzë, përkundrazi për disa ai është "lider" dhe kontribuues "i madh" për demokracinë shqiptare! Madhësinë e tij si "lider" e pranojnë jo vetëm ithtarët e tij, të cilët vetëm vdekja i ndan nga Berisha, por edhe media, edhe mazhoranca, madje edhe disa struktura të sistemit të drejtësisë. Është i njohur fakti që disa stacione televizive i fillonin lajmet me mburrje me "Kryetarin e PD" Sali Berisha, kur ai nuk ishte i tillë ligjërish. Pa përmendur këtu disa gazetarë të tjerë, "të paanshëm" që jepnin mend për demokracinë në studio televizive veshur me bluzën e stampuar me fytyrën "e vrerosur" të Berishës. Por, jo më pak e ka ledhatuar "liderin e madh" të demokracisë Berisha edhe mazhoranca. Ajo pasi deklaroi për t'u larguar vëmendjen e shqiptarëve nga e vërteta, se "nuk do të pranojmë asnjë shkresë me firmën e non gratës", dalëngadalë filluan të bëjnë lëshime antiligjore të njëpasnjëshme ndaj Rithemelimit me pronar Berishën. Pasi u nxit një kaos në parlament, i cili u shua si flakë kashte, lindën marrëveshjet e përbashkëta. Në fillim u shmang PD zyrtare nga Komisioni për Zgjedhjet dhe u pranuan përfaqësuesit e Berishës. Pastaj "për të mirën" e demokracisë u ngritën me pjesëmarrjen e të dyja palëve komi-



sionet hetimore parlamentare "për të zbuluar" korrupsionin në shëndetësi dhe për ndërhyrjet e paligjshme në sistemin TIMS. Më "rezultativ" që ngrit me entuziazëm të madhishte Komisioni për Amnistinë, i cili u shërbeu më së miri të dyja palëve. Kështu dalëngadalë firma e "non gradës", jo vetëm u njoh, por u bë shumë aktive për "funksionimin normal" të parlamentit! Bashkëpunimi e arriti kulmin, kur Kryesia e Parlamentit njohu të gjitha strukturat e Rithemelimit, duke shmangur qëllimisht PD ligjore të Lulzim Bashës. Kështu, në parlament për bëmat dhe krimet e Berishës, nuk fliste më askush! Qëndrime të tilla zbutëse të mazhorancës, patjetër që do të sillnin edhe vendimin e dhënies së vulës kreut "non grata" të Rithemelimit. Prova e fundit e raportit mazhorancë- "non grata" mbetet qëndrimi që do të mbahet ndaj mandatit të Berishës. Deklarata as mish e as peshk e një përfaqësuesi të mazhorancës se "si me mandat ashtu dhe pa mandat, Berisha një lloj është", janë aludime se Berishës mund t'i bëhet edhe një dhuratë tjetër, si ajo e vulës. Jo pak i përkrahur është Berisha dhe nga disa struktura të sistemit të drejtësisë. Njëra strukturë e kap dhe tjetra e lëshon, njëra e quan fajtor dhe nuk i heq masën arrestit, tjetra i dhuron vulën e partisë. Si shpjegohet fakti, që kur nuk janë të pranishëm përfaqësues të ambasadave të huaja në seancat gjyqësore, Berisha gjithmonë fiton, siç ishte "fitorja" e vulës. Disa ulurasin, se me Berishën është bërë hataja, duke iu dhënë masa e arrestit shtëpiak, masë e cila ndaj tij është si një gotë limonadë që i jepet një barkfryri nga ngrënia e babëzitur për 30 e ca vjet. Pra brenda vendit Berishës i japin të drejtë, jo vetëm të shajë e mallkojë mbarë prapë çdo aksham, por edhe të takojë miq e shokë e të japë konferenca shtypi! Në këto kushte ithtarët e sëmure të Berishës, kanë të drejtë të

ulërasin se "Berisha mbahet në arrest pa asnjë akuzë!" Mirëpo Berisha e ka keq punën me strukturat demokratike të kancelarive perëndimore, struktura të konsoliduara e funksionale prej shekujsh, të cilat nuk kanë nevojë tua mësojë ai shkollën e demokracisë. Ata, kur të ndëshkojnë argumentet i kanë të mbërthyer me gozhdë trari. Vendimet e tyre nuk janë si ato të komisioneve hetimore parlamentare, që pasi bëjnë një zhurmë shurdhuese, ku deputetët bëjnë akuza inatçore, por nuk ia nxjerrin asnjëherë lakrat në shesh njeri-tjetrit. Jashtë vendit Berishën nuk e beson njeri, kur ai fytyrësqukur çirret nga dritarja e katit të tetë, se "non gratën" e ka "dhuratë" nga Sorrosi, miku i tij i madh i dikurshëm, Rama që i pranoi të gjitha strukturat në mënyrën më antiligjore dhe Basha, që ai e ka zgjedhur me dorën e tij dhe e ka përdorur gjithmonë si vegël qorre. E vërteta është krejt ndryshe. Argument shumë bindës për Berishën "non-grata" është fakti që nuk ka patur qoftë edhe një deklaratë të vetme të organizmave ndërkombëtare që ta quaj atë "të burgosur politik." Pa iu shuar akoma gëzimi i dhurimit të vulës, erdhi e prerë deklarata e Ambasadës Amerikane: "Pozicioni ynë në lidhje me individët e shpallur non-grata mbetet i pandryshuar: ne nuk angazhohemi me persona të shpallur sipas autoritetit të sanksioneve të SHBA dhe të gjithë duhet të shqyrtojnë me kujdes, se si punojnë me individë të shpallur nga SHBA." Po kështu vendimi i Gjykatës së Londrës, ku ai ishte ankuar, nuk ia hoqi damkosjen, pavarësisht se sofistët berishistë luajnë me fjalët "nuk ishte gjykatë, por komision", duke u shprehur qartë: "Vendimi për ish-Kryeministrin Sali Berisha, është vendim i cili ka ardhur pas analizimit të shumë provave dhe fakteve, se çdo provë është e dokumentuar që nga viti 1996". Vendimi gjykatës së Londrës, ashtu si humbja pa

nishan e padisë në gjykatën franceze, hodhën poshtë çdo shpresë të atyre që përrallisnin çdo mbrëmje në televizione e tek rrugica e "shpresës" se "Berisha është i burgosur politik." Brenda damkosjes "non grata" qëndron i gjithë mali i akuzave ndaj Berishës. Ashtu siç është argument humbja e gjyqit të Zenit në SHBA për tragjedinë e Gërdecit, ashtu siç është shpallja non grata e së bijës Argitës, njëlloj si vajzën e Putinit, Katerinën, ashtu si gjithë të këqijat e tij që ky popull i ka provuar në kurriz. Duke u ngazëlluar nga dhurimi i vulës dhe duke mbuluar maskarallëkun e tyre me faktin se ndaj Berishës "nuk ka akuza", ndonjë deputet i Bashës si Çollaku e Bano vranoi e ul në sofrën e "non gratës". Të çudit arsyetimi sofist i Çollakut: "Të bashkohemi të gjithë bashkë, pavarësisht se kush është kryetari. Unë jam përherë me aleatët strategjikë, por nuk ndërrohet xhamia pavarësisht se ndërrohet hoxha?" Si nuk e paska kuptuar i ziu Çollak, se xhamia, ku ai shkoi të falet, ka patur gjithmonë një hoxhë, Sali Berishën, që tanimë e ka marrë peng PD dhe gjithë opozitën. Po na sqaroni o ideologë "të bashkimit në diversitet", pse u ndatë ju nga Berisha dhe berishizmi? Disa që e quajnë veten profesorë, intelektualë, shërbëtorë të demokracisë, të vjen çudi që i harrojnë të gjitha, parimet e moralin dhe turren në mbrojtje të një non grate 80 vjeçar me shpresën, se ai do t'i kthejë në pushtet, përrallë që në Shqipëri nuk e beson më askush. Bashkimi i vërtetë i të gjithë demokratëve bëhet vetëm nëpërmjet një rruge: tërheqja e Berishës përfundimisht nga PD, mbajtja e zgjedhjeve të ndershme në të gjitha strukturat, duke filluar nga baza, mbledhja e Kuvendin Kombëtar ku të zgjidhet krejtësisht një staf i ri drejtues. Ndryshe gjithçka tjetër është demagogji hipokrite dhe oksigjen vetëm për një njeri, Sali Berishën, që e ka marrë peng PD.

■ Filma shqiptarë dhe të huaj garojnë në festival

Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë në edicionin e 14-të sjell dhe aktivitetin “Serafin Fanku, Felini i teatrit shqiptar”

Nga Julia VRAPI

Kineastët e Ballkanit edhe këtë vit mbledhen në qytetin e Pogradecit. Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë në edicionin e 14-të sjell për të pranishmit prodhime kinematografike të huaja dhe shqiptare, por pjesë e tij është dhe takimi publik “Serafin Fanku, Felini i teatrit shqiptar”. Me drejtor artistik Eno Milkani, edicioni i 14 -të i Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë mbahet nga data 25 qershor - 29 qershor në qendrën kulturore “Lasgush Poradeci” dhe sheshi “Odeon” në qytetin e Pogradecit. Në festivalin që do të zgjasë deri më 29 qershor do të shfaqen rreth 50 filma me metrazh të shkurtër dhe të gjatë nga i gjithë Ballkani. Më herët drejtori artistik Eno Milkani ka shprehur se në këtë edicion filmat janë të zhanreve të ndryshëm për publikun. Filma komedi, dramë, filma që trajtojnë probleme të të rinjve, moshës së tretë, etj. “Në festival kemi filma të shkurtër të studentëve dhe jo të tyre, si dhe pesë filma të gjatë”, shpreh Eno Milkani drejtori artistik i festivalit, që ka nisur në Pogradec të martën. Por një nga momentet e veçanta në festival pritet të jetë dhe takimi publik më 28 qershor “Serafin Fanku, Felini i teatrit shqiptar”. Arkivi Qëndror Shtetëror i Filmit, i cili bashkëpunon për këtë festival bën me dije se takimi do të bëhet mbi punimin me të njëjtin titull të akad. asoc. Stefan Çapaliku në datën 28 qershor dhe do të moderohet nga dr. Anxhela Çikopano Hoxha. Serafin Fanko (Shkodër, 24 maj 1937 - 29 shtator 2007), aktor dhe regjisor i nderuar me titullin “Artist i Popullit”. Serafin Fanko studimet e larta i kreu në Akademinë e Arteve në Pragë dhe në Institutin e Lartë të Arteve në Tiranë. Filmi i tij i parë është “Fije që priten”. Më pas shkëlqeu në vitin 1977, me filmin “Gonat mbi tela” ku luante një nga rolet e mbretërisë së Savojës. Vitet e fundit spikati si regjisor dramash. Festivali Ballkanik i Filmit dhe Kulinarisë është dhe garues, ku ashtu si dhe në vitet më parë në fund të tij juria do të ndajë dhe çmimet për filmat në garë.

Filmat me metrazh të gjatë

Filmat me metrazh të gjatë në festival janë prodhimi kinematografik shqiptar “Sophia”, filmi “Horia” nga Rumania, “Okarina” nga Kosova, “Behind the haystacks” nga Greqia dhe “Warboy”



nga Rumania. Ceremonia e hapjes së Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë në Pogradec u bë me filmin “Sophia” të regjisorit Eduart Grishaj. Ky film është një produksion i vitit 2022 dhe trajton ngjarjen e një vajze të re serbe, që viziton Shqipërinë në kërkim të rrënjëve të një historie të vjetër të gjyshit të saj gjatë luftës së vitit 1941. Ajo bie në dashuri me një djalë shqiptar, duke filluar kështu një marrëdhënie “të pamundur” midis dy kombeve të ndarë nga lufta. Filmi “Sophia” nga Eduart Grishaj është bazuar në një histori të vërtetë e frymëzuar nga At Zef Pllumi. Në role në këtë film interpretojnë aktorja e madhe Tinka Kurti, Rita Gjeka, Alfred Trebicka, Çun Lajçi, Rozafa Çelaj, Adem Karaga, Antonio Kodrinaj. Drejtor fotografie Djordje Stojilkoviç. Ndërkaq që dhe Arkivi Qëndror Shtetëror i Filmit në kuadër të festivalit në Pogradec që po zhvillon edicionin e 14-të të tij këtë vit gjithashtu bashkëpunon me organizatorët për shfaqjen e katër filmave të restauruar shqiptarë në mbrëmjet nën yje, buzë liqerit. Një natë më parë nga filmat e restauruar u shfaq filmi “Përrallë nga e kaluara”.

Kalaja e Bashtovës dhe ndërhyrjet për restaurimin

Kalaja e Bashtovës ndodhet në fshatin Vilë-Bashtovë, i cili shtrihet midis qyteteve të Kavajës dhe Rrogozhinës. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore shprehet se shpallur monument kulture i kategorisë së parë (I) në vitet 1948, kalaja e Bashtovës është gjithashtu në listën tentative të UNESCO-s si vend i trashëgimisë botërore. Një herë e një kohë, zona ku ndodhet kalaja ishte qendër tregtimi e përdorur nga Venedikasit. Më pas, gjatë Perandorisë Osmane, kalaja u kthye në port me funksion mbrojtës e tregtisë bregdetare. Për këtë arsye, arkitektura veneciane dhe osmane ndërthuren bukur në strukturën e kalasë. Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) bën me dije se në kuadër të restaurimit të kalasë së Bashtovës, janë kryer këto ndërhyrje arkitekturore: Restaurimi dhe plotësimi i qemerëve të tullës; Restaurimi i bedenave të dëmtuar; Restaurimi i shkallëve të gurit; Ndriçim artistik i mureve të kalasë në pjesën e brendshme dhe të jashtme të tyre; Pajisja e një pjese të murit me parapet metalik, për të siguruar mbrojtjen e vizitorëve gjatë lëvizjes mbi mur; Plotësimi i njërës prej kullave me strukturë dekorative metalike; Mbyllja e aksesit në disa pjesë të murit ku ecja mund të jetë e rrezikshme. Kalaja e Bashtovës ka trajtë katërkëndore me përmasa 60 x 90 metra. Pjesa perëndimore e saj është rindërtuar në shekullin XVIII. Zona e Bashtovës është përmendur si një port lumor në Shkumbin, si dhe një qendër e eksportit të drithërave. E veçanta e kësaj kalaje ose kështjellë është se është e vetmja kështjellë në Ballkan e ndërtuar në fushë.



Ekspozita “Felice Beato dhe Adolfo Farsari. Dy italianë në Lindjen e Largët” te “Marubi”

■ Ekspozita “Felice Beato dhe Adolfo Farsari. Dy italianë në Lindjen e Largët” vijon deri më 7 korrik në muzeun “Marubi” në qytetin e Shkodrës. Projekti është rezultat i bashkëpunimit midis Fondacionit Alinari dhe muzeut “Marubi” dhe ekspozon punën e dy autorëve të rëndësishëm të historisë së fotografisë, si në Itali ashtu edhe në botë. Ekspozita është kuruar nga fondacioni me konsultën shkencore të Rossella Menegazzo. Felice Beato dhe Adolfo Farsari ishin ndër të parët që përshkruan Lindjen e largët, veçanërisht Japoninë, duke kontribuar në përhapjen në Evropë të fenomenit kulturor të japonizmit. Ekspozita në Shkodër u mundësua falë kontributit të Institutit Italian të Kulturës Tiranë dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të Shqipërisë.

Mbrëmja poetike “Dyert e mëdha shkodrane”

■ Mbrëmja poetike “Dyert e mëdha shkodrane” përmblodhi brenda saj traditë, kulturë, poezi të ndërthurura së bashku në një oborr, ku gjurmët e hershme ende frymojnë. Qendra për Hapje dhe Dialog -COD në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, shoqatën “M.I.R.A”, në kuadër të projektit “Të çelen Arkapijat” mbështetur nga MEKI, organizoi këtë mbrëmje poetike. “Mbrëmja në oborrin e familjes Jubani kulmoi me vargjet e poetit shkodran Migjeni, poezi të Martin Camaj, Anton Çetta, krijime të vetë poetëve e artistëve shkodranë, të cilët përcollën shumë emocione nën tingujt e kitarës”, thuhet nga DRTK. Zëri i aktores Merita Smaja përçoi emocion tek të pranishmit, por nuk mund t’i mungonin kësaj mbrëmjeje këngët shkodrane e tingujt muzikorë.

Një grup studentësh vizitojnë muzeun “Shtëpia me gjethe”

■ Një grup studentësh pjesëmarrës në shkollën verore “Dëshmitë gojore si burim shkencor në historinë bashkëkohore shqiptare”, organizuar nga Fakulteti Histori-Filologji, vizituan muzeun “Shtëpia me gjethe” në Tiranë. Herë pas here në këtë muze zhvillojnë vizita grupe të ndryshme studentësh dhe së fundmi ishin dhe ata të kësaj shkolle verore. Ndërtesa e njohur si “Shtëpia me gjethe” (e quajtur kështu për shkak të bimës kacavjerrëse që mbulonte fasadën e saj), është kthyer tashmë në muzeun kombëtar të përgjimeve. I hapur më 23 maj 2017, ky muze përpiqet t’u rrëfejë të rinjve dhe të huajve një nga periudhat më të errëta të historisë së vendit tonë. E konceptuar në 9 sekSIONE, “Shtëpia me gjethe” përbëhet nga 31 dhoma të lidhura me koherencë mes tyre dhe çdo dhomë ka një funksion të veçantë.

MEKI deklaron se për këto detyra kanë filluar nga puna për plotësimin e tyre

Raporti i UNESCO-s për Butrintin, MEKI: Në projekt-vendim lihen edhe një sërë detyrash që duhet të realizohen brenda fillimit të vitit 2025

Nga Julia VRAPI

Pas raportit të UNESCO-s për Butrintin, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) doli një ditë më parë me një qëndrim publik. UNESCO publikoi raportin e fundit mbi parkun kombëtar arkeologjik të Butrintit në vendin tonë, duke analizuar rreziqet, si edhe duke kërkuar sërish përcaktimin e kufijve të sitit. Në projektvendimin e fundit të Qendrës së Trashëgimisë Botërore (UNESCO) për Butrintin lihen edhe një sërë detyrash që MEKI do të duhet të realizojë brenda fillimit të vitit të ardhshëm, për të cilat ministria bën me dije se ka filluar puna për plotësimin e tyre. Por MEKI një ditë më parë shprehu se janë përhapur edhe disa të pavërteta. “Ata që prej shumë kohësh kanë përhapur në shqip dhe anglisht disa të pavërteta, ndonjë të vërtetë të nxjerrë jashtë konteksti dhe shumë gjysmë të vërteta, duke shpresuar kthimin e Butrintit në të kaluarën e vet të errët të Listës së Pasurive Botërore në rrezik, kanë plotësisht të drejtë të ndihen të zhgënjyer pas publikimit të projekt-vendimit të QTB në fillim të javës së shkuar. Dokumenti që do t’i përcillet Komitetit të Trashëgimisë Botërore për t’u kthyer në vendim zyrtar, bazohet në analizën e detajuar të UNESCO-s për punën e MEKI-t dhe partnerëve të saj në studimin, konservimin, administrimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Butrintit, si dhe plotësimin e rekomandimeve të ICOMOS-it. MEKI si përfaqësues i shtetit shqiptar në Konventën e Trashëgimisë Botërore e gjen projekt-vendimin dhe raportin analitik të tij si shumë objektiv dhe tërësisht korrekt”, thuhet nga MEKI. Më tej në qëndrimin publik të MEKI-t thuhet se aty, jo vetëm që nuk evokohet e shkuara problematike e Butrintit, por përkundrazi, shihet nga e ardhmja duke vlerësuar bashkëpunimin e shtetit shqiptar me QTB për diskutimin e propozimeve zhvillimore në pasurinë botërore



dhe peizazhin e saj të mbrojtur. “Mirëpriten studimet shkencore dhe ato të ndikimit mbi pasurinë kulturore që i paraprijnë projekteve zhvillimore, progresi i bërë drejt formulimit të instrumenteve të nevojshëm për konservimin dhe administrimin e Butrintit, progresi i bërë në përditësimin e planit të veprimit dhe mirëpërgatitjen e Fondacionit për Menaxhimin e Butrintit për zbatimin e tij”, thuhet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Një strukturë bashkë me ministrinë e Turizmit për administrimin

Në vijim të qëndrimit publik mbi raportin e UNESCO-s, MEKI thotë se gjithashtu, aty mbështeten përpjekjet e saj për krijimin e një strukture të përbashkët me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për administrimin e gjithë parkut kombëtar si një i tërë, si dhe punën e nisur për thjeshtëzimin e sistemeve mbrojtëse të nën-zonave përbërëse të tij. “Në projekt-vendim lihen edhe një sërë detyrash që MEKI do të duhet të realizojë brenda fillimit të vitit 2025. Ne ndajmë të njëjtin mendim me UNESCO-n për këto detyra dhe kemi filluar menjëherë nga puna për plotësimin e tyre, pasi i konsiderojmë si themelore për sigurimin e mbrojtjes, zhvillimit dhe përbalimit të sfidave të ardhshme mjedisore, klimatike, shoqërore dhe ekonomike të Butrintit”, thuhet nga MEKI. Gjithashtu, me qëllim shpeshimin e komunikimit dhe

forcimit të mëtejshëm të koordinimit me UNESCO, bëhet me dije se është formuar një ekip i posaçëm ekspertësh dhe specialistësh me përvojë nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore. “Fokusi i këtij ekipi është procesi i vazhdueshëm i informimit reciprok, dialogimit dhe koordinimit cilësor me UNESCO-n dhe me palët e tjera të interesit, si dhe përkthimin e rezultateve nga ky proces në linja pune të bashkërenduar me ministrinë e linjës, bashkitë, partnerët dhe komunitetin”, thuhet nga MEKI.

Takimi në Paris

Së fundmi, është përcaktuar dhe një agjendë takimesh për thellimin e bashkëpunimit, duke filluar nga takimi i radhës sot në Paris mes përfaqësuesve të lartë të UNESCO-s dhe ministrave të MEKI dhe MTM, së bashku me ekipet teknike përkatëse. MEKI shprehet se ky takim do t’i paraprijë sesionit nr. 46 të Komitetit të Trashëgimisë Botërore në New Delhi, Indi, që do të mbahet në datat 21-31 korrik 2024. UNESCO vëren se katër janë faktorët që mund të ndikojnë mbi Butrintin në vitin 2024: ndërtime, aktivitetet e jashtëligjshme, ndikimi i turizmit dhe plani i menaxhimit ose sistemet e menaxhimit. Më 4 tetor 2023, Qendra e Trashëgimisë Botërore ftoi shtetin palë, Shqipërinë të dorëzonte një raport mbi gjendjen e ruajtjes së Butrintit.

Projekti artistik “Një harabel mbi një fushë të minuar” në teatrin Metropol

“Një harabel mbi një fushë të minuar” është një projekt artistik që synon të sjellë një përvojë të thellë për publikun shqiptar, duke përdorur një kombinim të elementeve të poezisë slam me performancën teatrale për të shprehur historinë personale dhe emocionet e autores, Jonida Beqo (Gypsee Yo). Teatri i Metropolit shprehet se përzgjedhja e realizimeve artistike në shoqërinë tonë ka një ndikim të rëndësishëm në të bërit e artit, në njohjen dhe argëtimin e publikut, si dhe në promovimin e zhanreve të ndryshme artistike, duke përfshirë poezinë slam dhe performancën teatrale. Biografia e artistes ka një lidhje të ngushtë me projektin. me përvojë shumë të pasur në fushën e teatrit, aktrimit, regjisë, etj. “Nëpërmjet këtyre performancave, Jonida sjell për herë të parë në Shqipëri poezinë slam dhe performancën teatrale e bën një kontribut të rëndësishëm në diversifikimin dhe pasurimin e skenës kulturore në vend, duke e promovuar artin dhe kulturën në një mënyrë të re dhe inovative si dhe duke krijuar një platformë për shprehjen artistike dhe ndërgjegjësimin shoqëror nëpërmjet poezisë slam dhe performancës teatrale. Muzika live do të shoqërojë performancën, shtuar një dimension të shtuar emocional dhe kohor në përvojën e shikuesve”, thuhet nga teatri Metropol në Tiranë për këtë projekt. Projekti artistik “Një harabel mbi një fushë të minuar” që do të zhvillohet në këtë teatër vjen në vijim dhe të atyre aktiviteteve më parë, që janë zhvilluar për publikun gjatë kësaj kohe.



“Personazhe në fokus” i ftuar dirigjenti Pandi Bello

Në kuadër të Ditës Botërore të Muzikës, Qendra për Hapje dhe Dialog organizoi në mjediset e galerisë së arteve “Guri Madhi” në qytetin e Korçës takimin e radhës të ciklit të projektit “Personazhe në Fokus”, me të ftuar dirigjentin e mirënjohur, mjeshtrin Pandi Bello, me moderatore Gerta Bandilli. Një nga njohësit më të mirë të muzikës, më të mirë të muzikës, më të përfshirë edhe atë klasike,

një jetë që i është dedikuar muzikologjisë e prej vitesh po jep kontributin e tij në gjithë zhanret e muzikës, e në veçanti në dirigjim. Maestro Bello është njohës i mirë i historisë së muzikës dhe jo vetëm, si edhe me një kontribut të jashtëzakonshëm me korin “Lira” me të cilin ka dhënë dhjetra koncerte, sidomos me muzikë e këngë të zonës dhe jo vetëm.

Performanca teatrale nga Los Torreznos te “ArTurbina”

Një performancë teatrale me artistë nga Spanja vjen për publikun. Ambasada e Mbretërisë së Spanjës në Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Teatrin Kombëtar mirëpresin për performancën teatrale nga Los Torreznos. Kjo performancë do të shfaqet më 28 qershor te salla “Centrali 400”, te “ArTurbina”. Los Torreznos (Jaime Vallauré dhe Rafael

Lamata) janë një dyshe artistësh përfaqësues të artit performativ të lidhur me rrymat konceptuale që lidhen me punën e gjuhës dhe të jetës së përditshme. Ata kanë përfaqësuar Spanjën si artistë në Bienalen e Venecias 2007, si dhe në institucione të shumta ndërkombëtare si Palais de Tokyo në Paris, Fundação Serralves në Porto, CA2M, La Casa Encendida ose Muzeu Reina Sofia në Madrid.

Rritje e numrit të vizitorëve në parkun e Antigonesë

Parku Arkeologjik i Antigonesë ka pritur një numër të konsiderueshëm vizitorësh vendas dhe të huaj gjatë 6-mujorit të parë të 2024! Kjo bëhet me dije nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore që publikoi dhe të dhënat. “51 për qind më shumë krahasuar me vitin 2023!”, thuhet nga IKTK. Orari zyrtar i biletarisë së “Parkut arkeologjik të Antigonesë” për periudhën qershor-tetor 2024 është 09:00-19:00. Parku

arkeologjik i Antigonesë është një nga vendet më të rëndësishme dhe mahnitëse në Gjirokastrë. Këtë park e karakterizon historia e tij e pasur dhe trashëgimia e madhe arkeologjike që përfshin një varg monumentesh dhe strukturash të rëndësishme historike, duke përfshirë qytetin e vjetër, muret e qytetit, amfiteatrin, termat romake, tempujt e lashtë, dhe struktura të tjera arkitekturore dhe ushtarake.

FSHF ndjek strategjinë e zbulimit të talenteve në Europë edhe për vajzat

Prej disa vitesh Federata Shqiptare e Futbollit bën grumbullime e seleksionime në vende të ndryshme të Europës e madje dhe në SHBA, duke synuar zbulimin e sa më shumë talenteve shqiptare dhe angazhimin e tyre në radhët e skuadrave kombëtare të moshave. Duke qenë se kampionati shqiptar nuk prodhon shumë talente, kjo strategji e FSHF-së ka pasur sukses me djemtë, ndaj dhe federata duket se po ideon të njëjtën strategji edhe për vajzat, ku shpresohet të afrohen sa më shumë kualitete në radhët e

ekipeve kombëtare të moshave në këtë gjini. Ndërkohë, Federata Shqiptare e Futbollit përmblyli me sukses seleksionimin tre ditore me futbollistet vajza në Oslo të Norvegjisë. Ky seleksionim u organizua në bashkëpunim me Petrit Hasanaj, një skaut shqiptar i cili punon në Sektorin e Edukimit në Federatën Norvegjeze të Futbollit dhe u ndoq nga afër nga trajneri i Kombëtares së vajzave, Armir Grima dhe përgatitësi atletik Ylli Bakaj. Gjatë këtij seleksionimi tre ditore në Norvegji u testuan

79 vajza me origjinë shqiptare, të ndara në grupe. Në ditën e parë morën pjesë 42 vajza, të cilat u testuan nga stafi shqiptar me në krye teknikun e Kombëtares A, Armir Grima, ndërsa në ditën e dytë 37 vajza. Sakaq, në ditën e fundit u zhvilluan në total tre ndeshje miqësore me vajzat që spikatën gjatë dy ditëve të para të seleksionimit. Përshtypjet e stafit për vajzat që morën pjesë në këtë seleksionim kanë qenë mjaft pozitive dhe Departamenti i Ekipeve Kombëtare ka mbledhur tashmë



të gjitha të dhënat e nevojshme për disa nga vajzat që spikatën në këtë seleksionim, që në të ardhmen do të mbahen në vëzhgim të vazhdueshëm dhe mund të japin

kontributin në ekipet Kombëtare të vajzave. Në përgjithësi, futbollit i femrave në Shqipëri ka pasur progres në lojë e në rezultate, madje dhe në kampionatin vendas.

■ Mbrojtësi bëhet nga të paktët që luan në dy Europeanë, paraqitje e mirë e tij në Gjermani

Arlind Ajeti beson se do ta fitojë vendin e titullarit edhe në eliminatore të Botërorit

Adriatik BALLA

Berat Gjimeshi ishte si lider i mbrojtjes së Kombëtares kuqezi në Europeanin e Gjermanisë, por në krah të tij shumë syresh menduan se do të ishte Ardijan Ismajli e jo Arlind Ajeti, por këtë dilemë kush do të ishte në krah të Gjimeshitit e zgjidhi vetë trajneri Silvinjo më 15 qershor, në duelin e parë në grup, atë ndaj Italisë, duke aktivizuar Arlind Ajetin, lojtar që ishte titullar në të tre takimet e luajtura nga Shqipëria në këtë European. Dhe 30-vjeçari vlerësohet se e arsyetoi besimin e Silvinjos. Ai u çmua për paraqitjet stabile në ndeshjet kundër Italisë, Kroacisë dhe Spanjës. “Në radhë të parë kam qenë shumë i lumtur për ftesën që pranova nga trajneri i kombëtares pas lëndimeve që kam pasur në klub. Normalisht çdo lojtar ka dëshirë të luajë. Nga dita e parë e grumbullimit kam shkuar për të dhënë gjithçka për kombëtaren tonë. Për formacion nuk kam menduar, sepse dihet që trajneri është ai që vendos. E imja ishte ta jepja maksimumin dhe atë kam bërë në të gjitha ndeshjet. Do të vazhdoj ta bëj një gjë të tillë”, tha Ajeti.



Dy Europeanë për Ajetin

Mbrojtësi i Kluzhit rumun ishte prej pak lojtarëve që për herë të dytë ishte pjesë e Shqipërisë në Evropanin. Në Evropanin 2016, të cilin Shqipëria e mbylli e treta në grup me Francën, Zvicrën dhe Rumaninë, ishin edhe Etrit Berisha, Elseid Hysaj, Amir Abrashi dhe Naser Aliji. Berisha, Abrashi dhe Aliji nuk luajtën fare në Gjermani. Ajeti kishte luajtur dy ndeshje në “Euro 2016”. Në mungesë të ish-kapitenit të Shqipërisë, Lorik Cana, shkaku i suspendimit, Ajeti ishte paraqitur deri në minutën e 85-të përkrah Mërgim Mavrajt në qendër të mbrojtjes në ndeshjen ndaj Francës. Shqipëria e humbi 2:0 atë ndeshje. Luajti edhe në

fitoren 1:0 ndaj Rumanisë në ndeshjen e fundit në grup. Ajeti thotë se ndjeu emocione të forta në Gjermani. “Edhe pse ishte hera e dytë, emocionet që i kam përjetuar që nga dita e parë e grumbullimit deri në ndeshjen e fundit ndaj Spanjës kanë qenë të njëjta ashtu siç kanë qenë për herë të parë. Ishte speciale për mua. Për secilin lojtar paraqitja në ngjarje të mëdha është e veçantë. Jam shumë i lumtur që kisha rastin të luaja për herë të dytë në Evropanin. Jam shumë i lumtur që kam qenë pjesë e këtij Evropani. Befasi për mua kanë qenë tifozët tanë, të cilët në çdo ndeshje kanë qenë pranë nesh me atmosferë të mirë. Tifozët tanë kanë merituar shumë më tepër, por fatkeqësisht kemi

“Evropiani ka përfunduar, ndërsa tani na presin gara të tjera. Me cilësinë e skuadrës që e kemi dhe e cila është duke u bërë edhe më e fortë me talente të reja që vijnë, besoj fuqishëm se mund të marrim pjesë edhe në Botëror...”

qenë në grupin më të vështirë në Evropanin dhe nuk arritëm ta kalojmë grupin”, nënvizoi ai.

Objektiv Botërori 2026

Ajeti thotë se nga përvoja në Gjermani kuqezinjtë do të përfitojnë shumë për të ardhmen. Ai pret të paraqitet me Shqipërinë edhe në Botërorin e vitit 2026. “Evropiani ka përfunduar, ndërsa tani na presin gara të tjera. Është ëndërr të marr pjesë me Kombëtaren e Shqipërisë në ngjarje të tilla. Me cilësinë e skuadrës që e kemi dhe e cila është duke u bërë edhe më e fortë me talente të reja që vijnë, besoj fuqishëm se mund të marrim pjesë edhe në Botëror”, shtoi ai. Ai lë të kuptohet se nuk e mendon pensionimin nga Kombëtarja.

PIKËPYETJA

A ia mori Silvinjo maksimumin sulmit?

Tani që Evropani për Shqipërinë u mbyll kanë nisur të bëhen edhe llogaritë, ku u bë mirë e ku keq. Me sulmin duket se nuk pati stabilitet, ndryshe nga mesfusha e mbrojtja që pati qëndrueshmëri në emra. Në sulm u provuan Asani, Bajrami, Broja, Manaj, Hoxha e fare pak Muçi e Berisha, si dhe Daku. Por Broja, psh. luajti vetëm 1/3 e minutazhit, Manaj 2/3, kurse të tjerët shumë pak minuta si zëvendësues. Mos ndoshta Silvinjo duhet të punojë më shumë me sulmuesit tani e tutje? Në të kundërt ka probleme.

QËNDRIMI

Bajrami mesazh tifozëve: Nder të isha krah jush

Nedim Bajrami hyri në historinë e Evropanëve për golin më të shpejtë, teksa dje pati një mesazh për fansat. “Një nder i madh për mua të isha pjesë e këtij rrugëtimi ku përfaqësova Shqipërinë time. Dua të falënderoj nga zemra të gjithë shqiptarët për mbështetjen e palodhur. Brohoritjet tuaja në shkallët e stadiumit dhe jashtë saj na kanë bërë të japim maksimumin tonë. Nder dhe privilegj të jem pjesë e kësaj kombëtareje. Faleminderit shumë nga zemra për gjithçka”, shkruan Bajrami.

SUKSESI

Xherdan Shaqiri me rekorde të reja në European

Futbollisti i vetëm që ka shënuar në tri edicionet e fundit të Evropanit dhe të Botërorit, Xherdan Shaqiri, të mërkurën regjistroi një tjetër arritje në “Euro 2024”. Shaqiri të mërkurën fitoi çmimin për golin më të bukur të shënuar në raundin e dytë të fazës së grupeve. 32-vjeçari realizoi shkëlqyeshëm në portën e Skocisë, në ndeshjen që përfundoi 1:1. Vendi e dytë e zuri goli i Hjulmandit të Danimarkës, në barazimin 1:1 me Anglinë. Goli i Roman Jaremçuk i Ukrainës u renditi i treti.

Mirlind Daku tregon pse Europeani i Gjermanisë nuk i solli fat

“Kuqezinjtë” u gjendën në “Grupin e Vdekjes”, me kundërshtarë tejet të fortë si: Spanja, Italia dhe Kroacia, e për pasojë patën pak pritshmëri dhe në fund e mbyllën me një pikë, në vend të fundit në grupin B. Skuadra e Silvinjos arriti të marrë vetëm një pikë në përballjen me Kroacinë, që përfundoi 2:2, kurse u mposht nga Italia 2:1 dhe Spanja 1:0. Në

përgjithësi futbollistet shqiptarë treguan paraqitje dinjitoze duke mos u turpëruar nga kombëtares me klas botërore. E të martën ata veçse mbërritën në Aeroportin e Rinasit. Aty, një nga futbollistet më të përfolur të kombëtares Mirlind Daku, dha një intervistë për mediat shqiptare. Ai deklaroi se “EURO 2024, nuk ishte dhe aq eksperiencë e mirë për të”. “Ka qenë një eksperiencë e mirë

për gjithë grupin, por për mua jo shumë e mirë – duke e parë atë rastin që ndodhi. Por nuk kemi çfarë të bëjmë. Kombëtarja po rritet më shumë dhe jam i kënaqur që isha pjesë e saj në Euro 2024. Silvinjo u ndje krenar që e kemi përfaqësua shumë mirë. Ne dinim që ky ka qenë grup i vështirë”, tha Daku. Siç dihet, ai u dënua me dy ndeshje moslojë nga UEFA, si



shkak i pjesëmarrjes në thirrjet ofenduese nga megafoni ndaj serbëve dhe maqedonëve.

Mitaj dhe Berisha thyen rekordin e moshës më të re për Shqipërinë në European

Shqipëria u eliminua nga Europeani, por la gjurmë brenda mundësive të saj. Ndërkohë, nga performanca e lojtarëve tanë në një European po zbulohen edhe detaje të rralla, që janë domethënëse për futbollistët dhe të ardhmen e karrierës së tyre. Kështu, Mario Mitaj është pa dyshim një nga lojtarët që i ka surprizuar të gjithë. Mbrojtësi nga Malësia e Madhe spikati që në kualifikuese dhe u konfirmua dhe në Euro2024, duke luajtur tre ndeshje të plota. Ndonëse në një moshë të re, Mitaj ka treguar shumë personalitet në fushë e lojës, duke u përballur si i barabartë me kundërshtarë të një niveli

shumë të lartë. Mitaj arriti që të vendosë dhe një rekord në këtë European, duke u bërë lojtari më i ri i Shqipërisë në një European, në moshën 20 vjeç 10 muaj e 9 ditë. Por ky rekord u mbajt nga mbrojtësi nga Malësia e madhe për vetëm 9 ditë. Ndërkohë, Medon Berisha ishte surpriza e madhe e listës së Silvinjos në Euro2024. Mesfushori i Leçes, ndonëse nuk kishte luajtur asnjëherë më parë me skuadrën e parë, u bë pjesë e listës së brazilianit për në finale të Europeanit. Kapiteni i skuadrës U21-të Shqipërisë bëri dhe debutimin e tij me skuadrën e parë në ndeshjen me Spanjën, duke u bërë dhe lojtari më i ri i

Shqipërisë që luan në finale të një turneu madhor për kuqezinjtë. Berisha zbriti në fushë në moshën 20 vjeç 8 muaj e 3 ditë, duke u bërë lojtari më i ri që luan në një European për Shqipërinë. Të dy konsiderohen si ndër lojtarët më të ardhme të Shqipëria dhe aktivizimi i tyre që në këtë moshë në një event kaq madhor, është një shenjë e madhe besimi, që pritet të shpërblehet në të ardhmen. Të dy lojtarët kërkohen që tani nga klube të top-ligave europiane dhe kjo është pozitive për ta në këtë moment. Shpresohet që ata të luajnë me top-klube në Europë, në të mirë edhe të Kombëtares kuqezi.



Mbrojtësi kuqezi tregoi lidërsipin e tij në ekip dhe bëri si duhet detyrat e tij në European

Gjimshiti analizon Europeanin: Nder të udhëhiqja këtë skuadër në Gjermani-2024

Adriatik BALLA

Kombëtarja i mbylli angazhimet e saj në European, duke zënë vendin e fundit në grupin B, një pozicion krejtësisht i pamërituar për atë që Shqipëria tregoi në tri ndeshjet e Europeanit të Gjermanisë. Padyshim që ishte diçka e bukur e madhështore atmosfera që krijuan tifozët kuqezinj, të evidentuar nga mediat botërore si sensacioni i këtij Europeani, duke mbushur rrugët dhe stadiumet e Gjermanisë. Natyrisht, skuadra në fushë e pati të vështirë pasi u përball me kundërshtarë të nivelit më të lartë, e përveç Shqipërisë, në grup u dogj edhe Kroacia, e cila grumbulloi dy ikë, pamjaftueshëm për të shkuar më tej. Shqipëria e mbylli në fund me 1 pikë, por ajo fitoi emocionet dhe tifozerinë, fitoi edhe vëmendjen e shtypit botëror, fitoi lojtarë të rinj, fitoi përvojë që do ta ndihmojë në të ardhmen të arrijë më shumë. një nga lojtarët lider të skuadrës tonë, e ndoshta një nga pikat më të forta të ekipit, mbrojtësi Berat Gjimshiti, e quajti nder dhe privilegj të madh që mbajti shiritin e kapitenit dhe që udhëhoqi grupin në fushë përballë gjigantëve të futbollit european e botëror. Kjo, theksoi ai,



i ka dhënë një krenari të madhe

Qëndrimi i Gjimshitit

Kapiteni Berat Gjimshiti udhëhoqi denjësisht Kombëtaren kuqezi në European duke e bërë më së miri detyrën e tij. Pas përfundimit të kësaj aventure ai ka reaguar nëpërmjet një postimi në rrjetet sociale. "Një rrugëtim i jashtëzakonshëm që nga kualifikueset deri në Kampionatin Evropian. Treguam karakter si Kombëtare duke u paraqitur në fushë si të barabartë me gjigantë evropianë, por që na mungoi edhe fati për të arritur më shumë. Të jem kapiten i Kombëtares në një Evropian, është krenaria më e madhe për mua dhe t'i udhëheq këta bashkëlojtarë të mrekullueshëm ka qenë diçka unike. Dua t'i

falënderojë tifozët më të mirët në botë, tifozët Kuq e Zi që nuk na kanë lënë vetëm në asnjë moment duke na përkrahur me të gjitha mënyrat, por një falënderim edhe më i madh për ta është se treguan kulturë të lartë sportive, duke bërë që e gjithë Evropa të flasë mirë për ta dhe për kombin shqiptar. Kombëtarja ka të ardhme të ndritur dhe ky është vetëm një fillim i gjërave edhe më të mëdha që na presin. Përgjithmonë Kuq e Zi, Forca Shqipëria ime", shkruan Gjimshiti.

Performanca

Në të tria ndeshjet që Shqipëria luajti në grupin B, mbrojtja pati lojtarët më stabil, nisur dhe nga fakti se luanim ndaj rivalëve shumë të fortë.

"Duhet thënë se Gjimshiti është fitues i Ligës së Europës me Atalantën dhe një nga lojtarët më të mirë e më me shumë minuta në radhët e klubit italian, ndaj këtë edicion ai pati sezonin e tij më të mirë të karrierës...."

Tre lojtarë që luajtën pothuajse ndeshjet e plota ishin Gjimshiti, Ajeti dhe Mitaj, ndërsa Hysaj luajti 2 nga tri ndeshjet në grup. Gjimshiti, jo vetëm ishte lider i skuadrës, kapiteni i saj, por edhe lojtari me minutazhin më të madh, i padiskutueshëm dhe njëherësh më i qëndrueshëm e më i sakti. Berat Gjimshiti e fitoi Europeanin e tij, në mënyrën më të mirë të mundshme, pavarësisht se Shqipëria nuk ia doli ta kapërcejë grupin. Duhet thënë se Gjimshiti është fitues i Ligës së Europës me Atalantën dhe një nga lojtarët më të mirë e më me shumë minuta në radhët e klubit italian, ndaj këtë edicion ai pati sezonin e tij më të mirë të karrierës.

Granit Xhaka beson se Zvicra e thyen Italinë në 1/8 e finales

Tani që ndeshjet në grupe përfunduan dhe u përcaktuan 16 skuadrat që do të vazhdojnë më tej, duket se Italisë çdo ditë e më shumë po i vështirësohen gjërat. Përballë do të ketë Zvicrën, një skuadër që deri tani ka treguar futboll cilësor, skuadër që ka kualitete dhe entuziazëm dhe që shpreson ta kalojë edhe raundin e 1/8 të finales, pra të eliminojë Italinë e të shkojë më tej. Padyshim që helvetët janë të uritur për sukses. Kështu, Zvicra do të përballë me Italinë, të shtunën në orën 18:00, në sfidën e vlefshme

për 1/8-tat e Europeanit. Në një prononcim të bërë së fundmi për mediet, kapiteni i Zvicrës, Granit Xhaka deklaroi se ndeshja ndaj Gjermanisë tregon shumë për forcën e tyre. "Të them të drejtën, Zvicra ka fituar më shumë respekt falë ndeshjes me Gjermaninë dhe unë besoj se ngazëllimi i çmendur i gjermanëve pas barazimit është provë për këtë. Ne e mbyllëm fazën e grupeve me të fortë dhe me një lojë që ka nxjerrë në pah gjithë karakterin tonë. Nëse shohim se ku ishim 6 muaj më parë, sot shoh një skuadër



me një mentalitet krejtësisht të ndryshëm", deklaroi Xhaka. Në radhët e Zvicrës luan edhe ylli tjetër shqiptar, Xherdan Shaqiri, i cili ka teknikë të lartë.

MESFUSHORI

Qazim Laçi e ka peng që s'fituan me Kroacinë

Mesfushori kuqezi Qazim Laçi ishte nga më të mirët në këtë European për Shqipërinë. Ai e ka peng që skuadra nuk mori tri pikë ndaj Kroacisë. "Patjetër që është ndeshja me Kroacinë. Na ka mbetur pak në mendje, sepse kishim shumë raste për të shënuar. Nuk e arritëm dot, por u kënaqëm edhe për pikën e marrë në fund të ndeshjes, pasi siç shkoi loja, ajo pikë ishte shumë e rëndësishme. Tifozët? Shqiptarë kanë treguar këtë European një nivel të lartë, special", tha Laçi për "Panorama Sport".

MERKATO

Pas Brojës Evertoni ndjek edhe dy sulmues të Junajtidd

Merkato mund të sjellë surpriza për Armando Brojën që kërkohet nga Evertoni. Klubi po mendon seriozisht për sezonin e ri, me klubin nga Liverpool që është një prej klubeve më aktive në merkato. Pas interesimit maksimal për sulmuesin e kombëtares shqiptare, Armando Broja, Everton ka nisur punën për dyshen e Mançester Junajtidd, Viktor Lindelof dhe Aaron Van-Bisaka. Kështu raportojnë mediet britanike, teksa mbetet për t'u parë nëse drejtuesit do t'ia dalin të kompletojnë këto lëvizje.

LËVIZJA

Drita s'ndalet në merkato, afron lojtarin e PSG-së

Drita njoftoi dje për transferimin e Aleksandre Fresange, sulmuesit që ishte pjesë e ekipeve zinxhirë të gjigantit francez Paris San Zhermen. Sipas klubit gjilanas, sulmuesi 23-vjeçar ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër. Fresange ishte pjesë e ekipeve zinxhirë të PSG-së. Nga viti 2020 deri më 2022, luajti te skuadra e dytë e PSG-së, e së fundmi te ekipi i dytë i Paris FC. Për Dritën, transferimi i Fresanges është i shtati gjatë kësaj merkatoje.

kulturë

Një burrë nga Australia është filmuar me një peshkagë, të cilin dëshiron ta rikthente në oqean. Kjo pasi djemtë e tij e kishin zënë gabimisht, duke menduar se bëhet fjalë për ndonjë peshk, të cilin do të mund ta konsumonin në darkë. Tristan Turne tha se dy djemtë e tij e kishin zënë peshkagë, ndërsa po peshkonin në ishullin Kangaroo në jug të Australisë. E për ta nxjerrë nga rrjeta e peshkimit, Turner nuk hezitoi t'i afrohet dhe ta tërheqë nga bishti, dhe t'i largoj karremin nga goja që ishte ngulur.

Australi, një burrë rikthen peshkagë në oqean



Përgjigjet e fjalëkryqit

D	I	S	K	O		S	T	I	K	A
E		K	A	P	I	T	E	N		N
R	M		M	A	L	E	T		K	A
B	U	T		R	E	M		M	O	L
I	R	A	N		T	A	T	I	M	E
	A	L	E	T		T	E	S	I	
S	T	I	N	A	3/T		L	I	S	I
K	O	N		L	5/I	S		R	A	M
A	R		D	E	6/N	I	S		R	A
L		S	E	N	2/A	T	O	R		M
A	R	G	A	T		A	S	I	M	I

Motorola G85 arrin në edhe në Evropë

Evropianët do të mund të blejnë Motorola G85 në treg, një telefon i mençur i fuqizuar nga procesori Snapdragon 6s Gen 3 i Qualcomm, i cili gjendet edhe në modelin S50 Neo, dhe që në fakt është Snapdragon 695 i riemërtuar nga 2021. Pajisja ka një ekran pOLED 6.67 inç me rezolucion 1080x2400 pikselë, 12 GB RAM, 256 GB memorie të brendshme që mund të zgjerohet dhe mundësohet nga një bateri me kapacitet 5000 mAh me mbështetje për mbushje të shpejtë 30 W. Në pjesën e pasme është kamera kryesore 50 MP (f/1.8) me stabilizues optik të imazhit dhe shoqërohet me një kamerë ultra të gjërë 8 MP.

Fjalëkryq i shifruar

15	7	9	14	4		9	8	4	11	2
17		12	2	7	4	8	2	15		8
16	12		7	4	3	6	1		3	9
11	16	11		1	6	10		1	4	10
4	11	4	10		7	6	1	2	11	4
	6	5	4	1		1	9	7	4	
5	1	6	12	4	1/T		3	4	7	4
3	9	7		1	9/O	3		11	2	3
2	7		3	2	11/N	2	11		11	9
2		3	9	8	2/I	1	6	1		8
6	10	2	1	6		4	7	6	11	4

1			2	3		4	5			6
			7		8					
		9						10		
11	12			13				14	15	
16			17				18			
	19					20				
21					22					
23				24						25
26			27						28	
		29						30		
	31						32			
33						34				
35					36		37			38
39					40		41		42	
		43	44				45			
			46							
47							48			

HORIZONTAL

1- Vajzat, ashtu siç i thonë në veri 4- Shitje e një malli ashtu siç është pa e peshuar 7- Gjini letrare në prozë 9- Dija që shtjellon rregullat dhe parimet e të folurit bukur, pa fund 11- Një nënë nga Gjyokastri 13- Vlerëson tensionin 14- Notë në pentagram 16- Lumi i piramidave 18- Litarë çeliku 19- Këngëtarja Zdravo 20- Pagesë mbi vlerën e faturës 21- Rikardo ..., ish-futbollist brazilian 22- Njeri i mefshtë që s'para mbush 23- Tani me dialekt 24- dëshmorë i parë ...Laçi 26- notë muzikore 27- Predhë luftarake që vepron dhe në ujë 28- Disponon 29- Vend i varur administrativisht nga një tjetër që e ka mundur në luftë 30- Mikhail ..., ish-kampion rus në shah 31- Det që lag brigjet e Francës dhe Italisë 32- Një vajzë nga krahinat e jugut 33- Është brinjë në skuadër 34- Vihet te akti zyrtar 35- Çalaman 37- Renato, këngëtar italian 39- "Mbreti ..." dramë me 5 akte nga Shekspiri 40- Rita e humorit, pa fund 42- ... kafe 43- Maja më e lartë e Himalajeve 8848 m 46- Mënjano apo ... rrezikun 47- Tatime 48- Është grimcë elementare.

VERTIKAL

1- I thatë, lungë me qelb 2- tokë e mbjellë 3- Nofkë e humoristit italian Antonio Dekurti 4- Fitimi, leverdia, përfitimi 5- Vasili, gazetarë 6- Lloj vere 8- I thonë nënës në Elbasan 9- Sende të vjetra me vlerë që ruhen 10- Pikë turistike bregdetare në rrethin e Sarandës 12- Ushtar i Perandorisë Osmane 15- Vezak 17- Gjika e skenës te filmi "Vetmi" 18- Aktori amerikan ... Bedi 20- Takije prej cohe që mbajnë myzeqarët në kokë 21- Kështu quhej edhe fshati edhe lumi në Shkodër 22- Shaplllo i shkrimeve 24- Krahinat, tokat, trevat 25- i thuhet ndryshe stërçokës, femrës së gallofit 27- Është çallma e hoxhës 28- Sallë kumari 29- Këngëtarja popullore ... Rusa 30- Njeri me veti të veçanta natyrore për të përvetësuar gjithçka, aftësi të veçanta 31- Ish-shahist rus kampion Mikhail ... i shquar 32- Një fshat i Kavajës 33- Janë të një trekëndëshi apo të banesave 36- shkencëtarja franceze Kyri, me origjinë polake 38- Lumi që kalon për në Fier 40- Ajo e Arkimendit 41- Perikliu i politikës 44- Njëlloj si zakon apo huq 45- Gazeta që ke në dorë.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Dashi
21 mars - 20 prill
Kjo ditë premton të jetë e qetë për dashurinë, veçanërisht për ata që kanë në krah një person të veçantë.

Demi
21 prill - 21 maj
Sinqeriteti juaj nuk do iu pëlqejë të gjithëve. Mundohuni të jeni më të kujdesshëm, sepse disa mund t'iu bëjnë keq pa e kuptuar.

Binjakët
22 maj - 21 qershor
Sado të bëni përpjekje për të pasur një jetë sa më të mirë sot, sërish do ju duket sikur nuk do ja dilni.

Gaforrja
22 qershor - 22 korrik
Nuk do jeni më të shpërqendruar si më parë sot dhe performancat në çdo sektor do jenë më të mira.

Luani
23 korrik - 22 gusht
Sot do ecni me prioritete dhe nuk do bëni gjëra që nuk keni dëshirë. Horoskopi i ditës paralajmëron një periudhë të dobët.

Virgjëresha
22 gusht - 22 shtator
Sot do keni vullnet dhe do mundoheni t'i bëni gjërat të funksionojnë sa më mirë. Tregohuni edhe më të matur me shpenzimet.

HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI HOROSKOPI

Peshorja
23 shtator - 22 tetor
Mos i nënvlerësoni aftësitë tuaja. Në punë fati do jetë gjithë kohës me ju. Keni për të pasur gjithçka më të lehtë se më parë.

Akrepi
23 tetor - 21 nëntor
Në punën tuaj mund të keni edhe ndonjë vështirësi, por në tërësi gjërat do ecin si i kishit menduar.

Shigjetari
22 nëntor - 21 dhjetor
Sot do keni shumë energji dhe vendosmëri, ideale kjo për të nxjerrë në pah cilësitë tuaja më të mira.

Bricjapi
22 dhjetor - 21 janar
Tregohuni më të logjikshëm dhe më të matur gjatë kësaj dite, sepse përndryshe do keni probleme serioze.

Ujori
22 janar - 19 shkurt
Saturni do ju bëjë më të matur dhe më të përqendruar tek objektivat kryesore. Çdo gjë do arrini ta menaxhoni si duhet.

Peshqit
20 shkurt - 20 mars
Në punë, një organizim jo i mirë mund t'iu çojë në rrugë të gabuar. Me paratë nuk do keni shumë fat.

Gjeorgjia befasia e madhe e Europeanit, përcaktohen çiftet e 1/8 e finales, kthehen në shtëpi Ukraina dhe Çekia

Gjeorgjianët mundën Portugalinë dhe siguruan kualifikimin si vend i tretë. Turqit e patën më të lehtë me çekët. Ukrainasit nuk ia dolën edhe pse me 4 pikë

Adriatik BALLA

Dje u mbyllën përfundimisht ndeshjet në grupe në Kampionatin Evropian Gjermani-2024, ku u përcaktuan edhe 16 skuadrat që shkojnë më tej në këtë aktivitet. Mbrëmjen e djeshme ishin ndeshjet e fundit në grupin F, ndërkohë që ndeshjet e xhiros së tretë në grupin E u luajtën në orën 18. Pikërisht në këtë grup pati edhe surpriza befasuese, pasi të katër ekipet e mbyllën me katër pikë në renditje, por njëra prej tyre shkoi në shtëpi. Ishte Ukraina që doli e pafat, për shkak të golavarazhit, e cila në vend të fundit, edhe pse pati katër pikë, eliminohet. Kurse si vend i tretë shkon më tej Sllovakia. Dy vendet e para që kualifikohen direkt janë Rumania dhe Belgjika. E veçanta e djeshme e këtij grupi lidhet me rezultatet, pasi të dyja ndeshjet u mbyllën në barazim pa gola, pra 0-0, diçka që favorizoi skuadrat që mbanin më parë



NDESHJET 1/8 E FINALES

29 QERSHOR

Gjermani-Danimarkë
Itali-Zvicër

30 QERSHOR

Spanjë-Gjeorgji
Angli-Slovaki

1 KORRIK

Portugali-Sloveni
Francë-Belgjikë

2 KORRIK

Rumani-Holandë
Austri-Turqi

vendet e para në klasifikim. Theksojmë se Belgjika do të ketë një short shumë të vështirë në 1/8 e finales, pasi do të përplas me Francën, një duel thujse derbi midis dy fqinjëve, një përplasje që ngjan si finale e para-kohshme. Ndërkohë, sa i takon grupin F, Portugalia u përplas me Gjeorgjinë, kurse Turqia me Çekinë në një duel direkt për vend të

dytë e të tretë. Për turqit gjërat u bënë disi më të thjeshta pasi që në minutën e 20-të çekët mbetën me një lojtar më pak, pas daljes me karton të kuq të Barak. Pjesa e parë mbyllet 0-0. Në pjesën e dytë turqit shënuan me anë të Calhanoglu. Gjithsesi, çekët nuk u dorëzuan dhe barazuan shifrat në të 66' me anë të Suçek. Ata u përpoqën ta përmbysin

ndeshjen, por në minutën e 4-t shtesë Tosun shënoi në kundërsulm dhe bëri që Turqia të fitojë 2-1 dhe të kualifikohet. Ndërkohë, mbrëmë surprizë e madhe ishte Gjeorgjia, e cila luajti me shumë dinjitet ndaj Portugalisë dhe fitoi 2-0, duke shkuar në 4 pikë dhe kualifikohet si vend i tretë. Ndeshjet me eliminim direkt në fazën e 1/8 e finales do të nisnin më 29 qershor. Duhet theksuar se në këtë fazë të parë të Europeanit, pra atë të grupeve, surprizë ishin disa skuadra si Gjeorgjia, Austria që mori keun në grupin e saj, Sllovakia si vend i tretë në grupin e saj, ndërsa mbetën jashtë të gjitha skuadrat që ishin në një grup me Shqipërinë në eliminatorët e Europeanit. Pra mbeti jashtë Shqipëria, Polonia dhe Republika Çeke. Pas kësaj faze, skuadra që bindi më shumë ishte Spanja, që mori tri fitore në tri ndeshje dhe ishte vetmja që e mbylli grupin me 9 pikë, ndaj edhe është favorite kryesore e Europeanit.

Qëndrimi/ Bellingham merr kritika për paraqitjen në European

Xhud Bellingham fitoi Champions dhe La Ligën me Real Madridin. Por, mesfushori anglez po shfaq dobësi për Anglinë në Kampionatin Evropian. Statistikat e tij në barazimin 0:0 ndaj Sllovenisë ishin shumë negative. Anglia e ka siguruar avancimin në fazën nokaut, me një fitore e dy barazime. Bellingham e shënoi golin e fitores 1:0 ndaj Serbisë në ndeshjen e parë. "Zero gjuajtje, zero shanse të krijuara, zero ndërhyrje, zero pasime

të kompletuara në fazën e tretë, atë sulmuese", ka shkruar "ESPN" për statistikën e Bellinghamit ndaj Sllovenisë. Ai kishte edhe 16-të topa të humbur, më së shumti në skuadër, ndërsa i ka fituar vetëm 22 për qind të dueleve. Në këto dy statistika ishte më i dobëti i skuadrës. Në të tria ndeshjet e grupeve, kundër Sllovenisë, Danimarkës dhe Serbisë, Bellinghami e kishte vetëm një gjuajtje në portë dhe një shans të krijuar.



MERKATO

Leao merr ofertë nga sauditët e Al Hilal, por e refuzon



Rafael Leao mori një ofertë fitimprurëse nga Al-Hilal ditët e fundit, por e refuzoi propozimin, duke mos dashur të largohet nga Milani këtë verë. Anëtori 25-vjeçar portugez, ka vazhduar të jetë një figurë e rëndësishme për kuqezinjët, edhe pse këtë sezon ka qenë objektiv i shumë kritikave. Në sezonin e fundit në krye të Stefano Piolit, ai shënoi 15 gola dhe dha

14 asistime në 47 ndeshje. Në javët e fundit, raporte të shumta kanë detajuar interesim serioz për Leao nga shumë klube në Arabinë Saudite, të cilët me sa duket janë të gatshëm të paguajnë rreth 100 mln euro për të blerë yllin e Milanit këtë verë, duke shkaktuar shqetësime te tifozët. Corriere dello Sport detajon se si Al-Hilal i dërgoi një ofertë Antonio Leaos, babait dhe

përfaqësuesit të anësorit të Milanit, përmes një emisari, i gatshëm t'i jepte atij një kontratë me vlerë 20 mln euro neto në sezon. I kërkuar nga Jorge Jesus në klubin saudit, 25-vjeçari e refuzoi propozimin, duke mos dashur të heqë dorë nga kuqezinjët, të cilët do të ishin të gatshëm ta shesin vetëm për klauzolën e tij të lirimimit prej 175 mln euro.

NJOFTIM

Agjencia e Lajmeve



kërkon

- gazetarë webi dhe
- grafik dizajner

Kontaktoni në adresën:
gazetasot@yahoo.com
gazetasotnews@gmail.com

SULMUESI

Argjentina e shqetësuar, Mesi u dëmtua në ndeshjen me Kilin

■ Pavarësisht fitores ndaj Kilit, në Argjentinë ka një shqetësim të madh për rrugëtimin në "Copa America". Trajneri i përfaqësueses, Lionel Scaloni, është i shqetësuar për gjendjen e yllit të skuadrës së tij, Leo Mesit, i cili mori një goditje gjatë ndeshjes, që ekipi i tij e fitoi me rezultatin 0-1 falë golit të shënuar nga Lautaro Martinez. "Ndjeva siklet në kofshën e djathtë. Isha i tensionuar, por arrita ta përfundoja ndeshjen. Do



të shohim se çfarë do të ndodhë", tha Mesi pas ndeshjes. Të gjithë janë të shqetësuar për Mesin dhe po presin analizat.

SITUATA

Pas eliminimit rebelohen serbët, kërkojnë "kokën" e trajnerit

■ Më në fund shpërthen rebelimi ndaj trajnerit të Serbisë, ku katër lojtarë kyç po mendojnë të lënë kombëtaren derisa ai të largohet nga pankina. Raportohet po ashtu se kishte tensione në zhveshtore pas eliminimit, që u kthyen në përleshje fizike. Në fakt, provokimet, skandalet dhe rezultatet zhgënjyese ishin ato që e shoqëruan Serbinë në këtë Evropian, duke u përkthyer në një dështim masiv. Kujtojmë që kjo kombëtare dhe tifozët e saj shpalosën



vazhdimisht materiale provokuese dhe propaganduese ndaj Kosovës dhe pavarësisë së saj. UEFA do të marrë masa.